



Bashkëpunimi me gazetën «Shekulli» zgjati 4 vjet, nga 2010-2014. Pas gazetës Shqip është gazeta e dytë që bashkëpunimi u ndërpre për divergjenca me redaksinë, divergjenca që lidhet me qëndrimet e mia për reformën territoriale, sidomos në Bregdet (Himarë).

Në këtë gazetë botova gjithsej 34 shkrime në një hapësirë prej 85 faqe.

Tematika e analizave të mia është shumë e gjerë dhe përbën një kendvështrim të veçantë që kërkon guxim, argument dhe pjekuri të gjithanshme. Artikujt për zhvillimet e brendshme politike zbulojnë që në atë periudhë anët e errëta që do të pengojnë zhvillimin e vendit në djetëvjeçarin e ri.

Përfshihen këtu dhe shkrime shumë domëthenese për kryepeshkopin Anastas që kanë të bëjnë me raportet e tij me shtetin dhe realitetin shqiptar.

Trajtimet e marrëdhënieve shqiptarogreke fitojnë në këtë gazetë një dimension të ri që përcaktohet nga fitimi i së drejtës nga ana ime për të folur dhe për ngjarje e fakte të këtyre marrëdhënieve që për realitetin e vendit përbejnë tabu. Shkrime të tilla si “Keqkuptime që cenojnë paqen shqiptarogreke”, (përkthyer dhe greqisht) tregojnë rrugën evropiane që duhet të ndjekin vendet tona në marrëdhëniet midis tyre, duke evidentuar abuzimet flagrante dhe të qëllimshme të bibliografisë dhe mentalitetit politik e shtetëror , por edhe publik në Shqipëri.

Po ashtu, dimension të ri hap në aspektin e të drejtave të minoritetit etnik grek shkrimi “Himara nuk është Krime”, apo dhe disa shkrime për ndarjen territoriale në raport me të drejtat historike të minoriteti etnik grek.

#### **Εισαγωγή.**

Η συνεργασία με την εφημερίδα «Shekulli» διήρκησε 4 χρόνια. Μετά από την εφημερίδα «Shqip», είναι η δεύτερη με την οποία η συνεργασία διακόπτεται μετά από διαφωνίες μου με την σύνταξη της εφημερίδας, οι οποίες στην προκειμένη περίπτωση αφορούν τις θέσεις μου για την διοικητική μεταρρύθμιση, ιδιαίτερα στη Χιμάρα.

Στην συγκεκριμένη εφημερίδα δημοσίευσα 34 άρθρα που καλύπτουν 85 σελίδες.

Τα θέματα στις αναλύσεις μου καλύπτουν έναν ευρύ χώρο και αποτελούν μια ιδιαίτερη οπτική γωνία, που απαιτεί τόλμη, επιχειρηματολογία και ολόπλευρη ωριμότητα. Τα άρθρα γνώμης για τις εσωτερικές εξελίξεις προδιαγράφουν από τότε τις σκοτεινές πτυχές που θα μεσολαβήσουν και θα εμποδίσουν την ανάπτυξη της χώρας στη νέα δεκαετία.

Συμπεριλαμβάνονται και άρθρα ευρύτερης σημασίας για τον αρχιεπίσκοπο Αναστάσιο, που αφορούν το παρασκήνιο των σχέσεων του με το αλβανικό κράτος και αλβανική πραγματικότητα.

Οι προσεγγίσεις των θεμάτων σχετικά με τις ελληνοαλβανικές σχέσεις αποχτούν στην εφημερίδα μια νέα διάσταση που προσδιορίζεται από το δικαίωμα που απόχτησα να έχω λόγο να γράφω για γεγονότα και στοιχεία που για την αλβανική κοινή γνώμη στη χώρα αποτελούν ταμπού. Τέτοια άρθρα όπως «Παρανοήσεις που προσβάλλουν την ελληνοαλβανική ειρήνη» (μεταφρασμένο και ελληνικά), υποδεικνύουν την ευρωπαϊκή πορεία των σχέσεων μεταξύ των δύο χωρών, προβάλλοντας τις ωμές και σκόπιμες καταχρήσεις της αλβανικής βιβλιογραφίας, κράτους και κοινής γνώμης.

Μια νέα διάσταση διανοίγεται και για τα θέματα σεβασμού των ανθρωπίνων δικαιωμάτων του Ελληνισμού. Απόδειξη αποτελεί το άρθρο «Η Χιμάρα δεν είναι Κριμαία»

1. **Në mbrojtje të qytetarisë.**  
**Letër e hapur, në përgjigje të 40 firmëtarëve të antiqytetarisë.**  
 09.05.2010/11.05.2010 faq. 5.
2. **Kryepeshkopi Anastas në këmbim të "paqes" duhet të bekojë mosmirënjohjen**  
 11. 10. 2010/14.10.2012 faq.7.
3. **Nacionalizmi, antihelenizmi dhe antishqiptarizmi**  
 14.11.2012 faq.11.
4. **Antihelenizmi, leva ku mbështetet nacionalizmi i vjetër i politikës së re në Shqipëri.**  
 Fillim nëntori 2012 faq. 14
5. **Tmeri pa fund nga logjika e të zënit rob për të bërë presion etnik.**  
 30.01.2013 faq. 17.
6. **“Krizë nacionaliste”, dramë njerëzore**  
 08.03.2013 faq.19.
7. **Rilindja, si një kontratë me ndërgjegjen**  
 29.06.2013/ 07.07.2013 faq. 21.
8. **Kisha e Përmetit, puçi i Berishës për qeverinë e re**  
 18.08.2013/19.08.2013 faq. 23.
9. **Reagime për shkrimin**  
 19.08.13 faq. 25
10. **Berisha-Dule, aktorë të tensionit shqiptaro-grek**  
 26.08.2013 faq. 27.
11. **Demokracia dhe thika me dy presa e ekstremizmit**  
 30.09.2013 faq. 31.
12. **Batërdia e një rektori**  
 07.10.2013 faq. 33.
13. **Premisat dhe sfidat e marrëdhënieve greko-shqiptare**  
 14.10.2013 faq. 36.
14. **Një mik i Shqipërisë në Tiranë**  
 03.11.2013 faq. 39.
15. **Keqkuptimet që çënojnë paqen shqiptaro-greke**  
*(“Të përpiqemi të shkojmë atje ku nuk mundëmi”, Kazantzakis)*  
 10.11.2013 faq. 41.

- 16. Përkthimi/Μετάφραση** faq. 44.  
 «Να επιδιώξουμε να φθάσουμε εκεί που δεν μπορούμε» Καζαντζάκης
- 17. Marrëdhënie në hulli evropiane**  
 15.01.2014 faq. 48.
- 18. Kush po e pengon ringritjen e shtetit**  
 02.04.2014 faq. 51.
- 19. Reforma territoriale dhe minoritetet**  
 23.03.2014 faq. 54.
- 20. Kujt i shërben vrasja e Kumes?**  
 10.04.2014 faq. 56.
- 21. Të shpëtojmë universitetin!**  
 16.04.2014 faq. 58.
- 22. Himara s'është Krime!**  
 30.04.2014 faq. 60.
- 23. Shenim në Gjuhën Greke**  
 Σημείωση στα ελληνικά! faq. 61.
- 24. Shembja e feudalizmit në universitet**  
 09.05.2014 faq. 63.
- 25. PD-ja dhe strategjia e saj e drogëzimit**  
 15.05.2014 faq. 65.
- 26. Protestë për të provuar ekzistencën**  
 24.05.2014 faq. 67.
- 27. Ana e errët e debatit për arsimin e lartë**  
 07.06.2014 faq. 69.
- 28. Antishqiptare nuk është ortodoksia...**  
 11.06.2014 faq.71.
- 29. Z. Barka, ju rrëfej “ortodoksët” (Reagim nga Arben Llalla)**  
 12.06.2014 faq. 73.
- 30. Mitologjia s'mund të jetë histori! (përgjigje z. Llalla)**  
 13.06.2014 faq. 75.
- 31. Lazarati: 200 vjet përdorje politike**  
 20.06.2014 faq. 77.
- 32. Përse rrëmohet në kanalet e së shkuarës?!**

03.07.2014

faq. 79.

**33. Përse i trembet drejtësisë opozita?!**

17.07.2014

faq.81.

**34. Çfarë e vërtete fshihet pas reformës territoriale në bregdet?!**

25.07.2014

faq. 83.

**35. Fund.**

Faq. 85.

## **Nga Panajot Barka**

### **Në mbrojtje të qytetarisë.**

### **Letër e hapur, në përgjigje të 40 firmëtarëve te antiqytetarisë.**

09.05.2010/11.05.2010

Emri im është Panajot Barka. Jam me kombësi greke. Kjo nuk më ka penguar të ndjek me vemendje të madhe zhvillimet në vend dhe të kontribuoj më sa mundem për dinjitetin dhe përparimin e vendit nënshtetas i të cilit jam.

Në këtë kontekst nuk mund të qendroj indiferent ndaj veprimit më anti intelektual të mundshëm të rreth 40 emrave të degjuar ose jo të kulturës së vendit tonë.

Ne ditën e 9 të greves së urisë së 22 deputeteve dhe 180 qytetarëve, mes tyre dhjetra grave, dhe të protestave paqësore më masive të të gjitha kohrave të shtetit shqiptar, këta 40 emra të degjuar me një letër pjesë e arsenalit të demagogjisë populiste, i kërkojnë kryetarit të opozitës që ata të ndërpresin grevën e tyre. Kërkesa e tyre ka si shkak një arsye banale, abuzive dhe populiste. Bëhet gjoja në emër të heqjes së vizave për shqiptarët, si një akt, që sipas tyre, “na barazon me Evropën”.

Letra e tyre, fatkeqësisht tregon se talenti i tyre dhe investimi popullor e shtetëror për karrierën e tyre, nuk ka asnjë lidhje me intelektualizmin. Ata, njësoj si politikanët populist dhe abuziv me bollek në këtë vend, e shikojnë integrimin evropian të vendit në dimensionin pragmatist më vulgar të mundshëm, në të drejtën e qytetarëve shqiptarë për të lëvizur të lirë në Evropë. Një intelektual i vertetë do të ushtronte gjithë potencialin dhe kredibilitetin publik të tij për të fituar e drejta se të jesh i barabartë në Evropë duhet të instalosh një demokraci të vertetë dhe jo të ushtrosh pushtet me vota të vjedhura, dhe jo më edhe pas 20 vjetesh “demokraci” dhe në zemër të Evropës të mos kesh arritur nivelin e Afganistanit në konceptin e votës si themelin e demokracisë.

Nëse këta 40 emra do të pershkoheshin nga një fije intelektualizmi, do të kishin vendin tek ata grevist urie për të shprehur solidaritetin e tyre kauzës së grevisteve të urisë e cila ka në thelb një kërkesë që popujt e tjerë evropianë e kanë kapërxyer me dhjetra vjet më parë, lirinë e votës, si themel të demokracisë, transparencën mbi votën si parimin bazë të demokracisë.

Nëse këta 40 emra do ta quanin vetën sado pak intelektual do të rreshtoheshin jashtë derës së kryeministrit, presidencës ose parlamentit dhe për t’u kërkuar autoriteteve të larta të vendit, që të ndalnin këtë grevë urie duke plotësuar kërkesën e tyre për transparencën e zgjedhjeve, që edhe politika zyrtare duhet ta shoh si një akt civil dhe intelektual.

Nëse këta 40 emra do ta quanin vetën sado pak intelektual minimalisht do të heshtnin. Pavarësisht se edhe kështu bëhen indirekt pjesë krimi në dem të demokracisë. Por, ata u bënë pjesë e mekanizmit pushtetar që e quan normale qeverisjen me vota të vjedhura, qeverisjen korruptive, qeverisjen që hesht para një greve urie nga më masivet dhe me të gjata në botë.

Nëse këta 40 emra do ta quanin sado pak vetën intelektual, do të kishin sy e vesh për të parë se ç’po ndodh tek bulevardi “Deshmoret e Kombit”. Ata në mos do të bashkoheshin me ata dhjetra mijra demonstruesish, në mos nuk do të solidarizoheshin e do t’u jipnin kurajo dhjetrat e grevisteve të urisë, në mos do të hipnin në podjumin për të mbajtur një fjalim në emër të lirisë e të demokracisë, apo të mirrinin edhe ata rrugën e “Çadrës së Lirisë dhe Demokracisë” në asnjë mënyrë nuk u lejohet t’i quanin ata një grusht njerëzish që pengon integrimin evropian e vendit. Aq më keq për ta kur në atë çadër janë deputetë, artistë, inxhinierë, ushtarakë, studentë....

Vepra intelektuale e tyre u shumëzua me zero nga akti sublim i ELSA LILËS.

Është vertetë turp që më 2010 një popull i terë të harxhojë energjitë e veta në greva urie dhe demonstrata masive dhjetra ditore dhe perse, për gjera elementare por themelore. Elementare se në ndergjegjen e popujve të tjerë bëjnë pjesë në arsenalin e reflekseve biologjike janë pjesë e natyrës njerëzore, ndersa tek ne pjesë e makuterisë së pushtetit që provokon akoma dhe rreagimin e natyrës, pjesë e bajraktarizmit mesjetar. Është themelore se vota e lirë është mekanizmi i ekulibrit demokratik të një populli.

E pra këta 40 emra do të ishin sadopak intelektual do të dinin të orientoheshin. Do t'u kundërviheshin atyre faktorëve që detyrojnë këta njerëz në veprime sublimë për të arritur gjera aq të thjeshta për natyrën njerëzore dhe demokracinë.

Jo, ata 40 emra nuk mund të quhen intelektual. Ata u bënë pjesë e mekanizmit që kërkon të gjunjëzojë një popull. Ata u bënë pjesë e mekanizmit që e do një popull turmë të manipulueshme. Ata u bënë pjesë e mekanizmit që nuk do një popull të frikësuar dhe trembet kur shikon se ai e vret frikën.

Akti i tyre është një ogur i keq. Tregon se Haxhiqamilismi nuk ka vdekur. Ai shfaqet çdo herë, me kullaro apo pa kullaro, kur pragmatizmi vulgar ballafaqohet me vlera dhe aspirata. Me atë letër ata barazuan intelektualizmin e tyre me “dum bab-zmin” haxhiqamilian.

E mira është që uragani i protestës popullore t'i lerë mënjane si kallamishtet në një shtrat lumi dhe zëri i Elsës t'u shandazhojë ndergjegjen e brejtur nga pragmatizmi vulgar i një të vedksmi të rendomtë. Shpirti i Elsës dhe akti i saj të vrasë përfundimisht frikën e çdo shqiptari të thjeshtë dhe të mbeshtjellë e të prekë frymën humane e intelektuale të vertetë të shoqërisë shqiptare.

Ju faleminderit

Gjirokastër 09.05.2010

Doc.Dr. Panajot Barka U botua tek shekulli dhe tek Albania te marten me date 11/05/2010 dhe u komentua tek top story te enjten 13.05.2010. eshte shkrimi qe ka bere me shume pershtypje se te gjitha shkrimet e tjera

**Nga Dr. Panajot Barka**

<http://himarablog.blogspot.com/2010/10/per-polemiken-e-re-ndaj-kreut-te-koash.html>

(Artikulli (esse) është hequr nga site elektronik i gazetës Shekulli)

Për polemikën e re ndaj kreut të KOASH-it <http://www.orthodoxalbania.org>

## **Kryepeshkopi Anastas në këmbim të "paqes" duhet të bekojë mosmirënjohjen**

11.10.2012/14.10.2012

Ditët e fundit në disa gazeta qendrore po rihapet edhe një herë polemika rreth kreut të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Fortlumturisë së tij, Anastasios Janullatos. Kësaj here polemikën e kryeson Profesori i Historisë zoti Kristo Frashëri. Për herë të parë vihet në këtë rol një personalitet me origjinë ortodokse pavarësisht se tregon se pak e interesojnë punët e fesë. Jam i detyruar të vë në dukje këtë detaj, pasi në përgjithësi dhe në të gjitha nivelet Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare "është marrë në mbrojtje" nga shqiptarë jo ortodoksë. E keqja është se të gjithë "mbrojtësit" e KOASH-it i mbyllin sytë e veshët para faktit se edhe tek komunitete të tjera fetare, "ligjin" e bëjnë të tjerë, gjuha e përdorur në ceremonitë e tyre nuk është shqipja dhe shpesh penetrojnë në to elementë që shqetësojnë mbarë botën. Veçoria e dytë qëndron tek fakti se polemika nuk lidhet me veprën e Kryepeshkopit në krye të kësaj Kise për më se 20 vjet, por me legjitimitetin e ardhjes së tij në krye të KOASH-it, para dy dekadash. (!) Argumenti i përdorur ka të bëjë me origjinën greke të Kryepeshkopit. Që të bëhet bindes i mëshohet lëmshit të zakonshëm të revokimit të momenteve të errëta, ose me saktë qëllimisht të errësuara në marrëdhëniet midis dy vendeve. Në rrugën 20-vjeçare të Kryepeshkopit qëmtohen disa momente që "çojnë ujë" në të njëjtën hulli historike, pavarësisht se atë e ka lenë pas koha e matur animë me shekuj dhe realitetet e sotme Evropiane që përjetojnë të dy vendet. Realiteti riciklues i formulës së vjetër, e cila në memorien kolektive shqiptare rruhet si aksiomë konstante se "Greqia nuk heq dorë nga qëllimet aneksioniste ndaj Shqipërisë", përvijon në thelb një deficit të konsiderueshëm të klasës intelektuale në Shqipëri. Në arsenalin e vet për vetorientimin etnik kolektiv shqiptar ruhet arsenali ideologjik i sistemit komunist të trashëguar nga fundi i shek. XIX fillimi i shek. XX e që lidhen me ballafaqimin me Greqinë. Përfshirja në këtë spirale ricikluese të figurës së Kryepeshkopit Anastas nuk synon thjesht ta mbajë gjallë klimën antihelene. Lidhet me së shumti me fatin e emrit të tij në perspektivën historike të KOASH-it(!). Deri tani midis rreshtave lexohej qëllimi që KOASH-i të kishte një rol dytësor në komunitetin e besimtarëve shqiptarë dhe jo rolin e vërtetë të saj. Kjo u pa tek fakti që shumë nga njerëzit që e rrethuan KOASH-in dhe Kryepeshkopin ishin të porositur "në devotshmërinë e treguar". Vërtetohet gjithashtu nga fushatat e herëpashershme ndaj Kryepeshkopit me objekt të vetëm antigreqizmin. Në rastin e Prof. Frashërit, me gjithë respektin që kam, me vjen keq që abuzon me emrin e tij të nderuar, ose lejon të tjerët që të abuzojnë me të. Dikujt i duhet që fjalët e tij prej historiani të përdoren si fakte historike nga që i tha ai, por jo se janë të tilla. Bie shumë erë propagande të taktikës hoxhiste. Aq me keq, kur kujtohesh të vesh në dyshim momentin e parë, aktin e fronëzimit të Kryepeshkopit, kur për 20 vjet e ke njohur zyrtarisht, publikisht e ndërkombëtarisht. Personalisht kam qenë i pranishëm në ceremoninë e fronëzimit të Kryepeshkopit Anastas më 02.08.1992. Ceremonia fetare e fronëzimit u krye në katedralen e Kryeqytetit. Është e vërtetë se gjatë zhvillimit të ceremonisë, një grup njerëzish që s'kishin asnjë lidhje me ortodoksinë, hynë në kishë. Filluan të bërtasin, të këndojnë edhe këngë patriotike. U përballen vetëm nga kori i fuqishëm i besimtarëve që u kërkonin atyre të largoheshin nga kisha. Thirrjeve të tyre,

iu përgjigjen me thirrje në favor të Kryepeshkopit të ri "Aksios!! I denjë!!" Për çudinë e të gjithëve ata pas pak u larguan dhe ceremonia fetare e fronëzimit përfundoi me sukses. Në Hotel Tirana u dha një drekë civile urimi, por në raste të tilla këto dreka fillojnë me bekimin fetar. Këtë fakt e ngatërron me ceremoninë zyrtare të fronëzimit edhe profesor Frashëri. Po ashtu si dëshmitar i dorës së parë mund të them se marrëdhëniet e Kryepeshkopit Anastas me Dhespotin e Konicës Sevastiano, ishin tejet të acarta, saqë çdo dokument i përdorur për të provuar të kundërtën është thjeshtë një abuzim. Nuk dua të flas për rastet e tjera të përmendura në polemikën e vetë prof. Frashërit, apo edhe të tjerëve. Por, nuk mund të mos them se është gënjeshtër të thuhet se Kryepeshkopi Anastas bëri trisai mbi eshtrat e skandalit të Kosinës -Permet 2006. (!!!) Se nuk u bë kurrë një e tillë as nga ndonjë prift i rangut të ulët. Nga ana e vet Kryepeshkopi Anastas ka hyrë në polemikë nga një pozicion i moderuar mbrojtës. Përpiqet të demonstrojë veprën e tij, e cila, në funksion të KOASH-it, por edhe në aspektin shoqëror (arsimor-shëndetësor-kulturor) është shumë e madhe dhe me vlera historike. Në promovimin e kësaj vepre nga ana e Kryepeshkopit me shumë u evidentua nevoja dhe dëshira e tij për ta bërë publike atë dhe për të pritur mirënjohjen e këtij publiku. Dhe kjo nuk bëhet për shkak të moshës së shkuar porse për shkak të heshtjes dhe indiferentizmit të qëllimshëm për këtë vepër. Këtu, pra qëndron edhe thelbi i polemikës së re. Prof. K. Frashëri përfaqëson tendencën "e zyrtarizuar të opinionit publik", e cila është e interesuar për veprën e Kryepeshkopit në krye të KOASH-it si të tillë, por jo për emrin e tij. Kërkohet pra, që emri i Kryepeshkopit dhe aq me tepër faktori grek që ai përfaqëson, të përfshihet në mekanizmin e zhvlerësimit, të zhbërjes dhe harresës. Nga ana e vet dhe për motive, mendoj thjeshtë të brendshme, Kryepeshkopi kërkon të lidh fort këtë vepër me përjetësimin dhe pavdekësinë e emrit të tij. Ku konsiston vepra e Kryepeshkopit që justifikon mirënjohjen shqiptare, (jo vetëm të ortodoksëve). Kryepeshkopi Anastas e ringriti nga hiçi infrastrukturën e KOASH-it në të gjitha drejtimet dhe nivelet. Vendin kryesor e zënë objektet e reja të kultit. Në këtë përpjekje gjigante Kryepeshkopi Anastas, në bashkëpunim me instancat kulturore të shtetit shqiptar "harroi" të merrej me të njëjtin përkushtim dhe me objektet e kultit që mbartin mbi supë shekuj historie, tradite e kulture. Këto monumente, sidomos në jugun e vendit, që vërtet mbajnë erë Greqie, po kthehen në pronë të harresës, ose në objekte studimi për shoqata restauruese e mirëmbajtëse italiane (!!!). Nuk mund të themi me saktësi se kjo u bë se Kryepeshkopi, sipas mentalitetit shqiptar, donte të thoshte se historia e Kishës Ortodokse Shqiptare fillon me të. Apo, kjo ishte pjesë e kompromiseve me strukturat shtetërore të cilave (për shkak se në to bie erë Greqie) kjo harresë u interesonte. Por mund të themi me saktësi se Greqia me shumë dhe minoriteti etnik grek në Shqipëri nuk kanë asnjë përfitim nga kjo histori. Përkundrazi! Duke u nisur nga kjo logjikë, bëj publikisht një pyetje. Në katedralen e re ortodokse të Tiranës, ashtu si në atë të Korçës, Durrësit, Shkodrës, Fierit, Gjirokastrës etj., ka para të madhe me origjinë greke. Po ç'përfitim mund të ketë Greqia nga kjo katedrale, apo edhe të tjerat, kur as ato para nuk bëhen asnjëherë publike. Asnjë përfitim. (Ashtu siç nuk ka Italia që ndërtoi qendrën e Tiranës, apo vende të tjera që ndërtojnë kisha, xhami, shkolla, spitale etj.) Veçse Tirana do të ketë në qendrën e vet një kryevepër arkitektonike me vlera të papërsëritshme kulturore. Vepra të kësaj natyre çdo popull i ngre me sakrificën dhe mundin e vet, se në fund të fundit përbejnë esencën e kulturës dhe të pasurisë së tyre. Në rastin tonë dhe Kryepeshkopi Anastas nuk është hera e parë, përpiqemi të harrojmë krijuesin e tyre, ose ta kujtojmë sipas rastit. Ose ta denigrojmë duke e akuzuar padrejtësisht se u shërben "armiqve gjenetik të kombit"! Ndërkohë që ai bën të kundërtën. Por, perse kjo stuhi e re n daj Kryepeshkopit të KOASH-it dhe pse tani!? Me 1998 në një takim personal me Kryepeshkopin Anastas më kërkoi të dinte



opinionin tim mbi faktin e ndryshimit në të kundërt të qëndrimit ndaj tij të faktorit shqiptar. Iu përgjigja shkurt duke i sjell tre argumente. Së pari, po ngre nga hiçi dhe ndërton Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Faktori shqiptar nuk bën për këtë asnjë sakrificë. Së dyti, ke marrë përsipër një veprimtari humanitare që zëvendëson praktikisht buxhetin shtetëror për këtë qëllim. Së treti, po i siguron shtetit shqiptar një mbështetje pozitive ndërkombëtare. Kur ky mision, i thashë, do të përfundojë edhe ti do të jesh i tepërt dhe i parëndësishëm. Dhe nuk jeni i pari. Vlerat e qëndrueshme këtu janë pragmatizmi i ditës. Takimin e fundit me Kryepeshkopin Ansatas e bëra kur po bëheshin përgatitjet për fronëzimin e tre dhespotëve. Kundër tij ishte ngritur stuhia e radhës. Më pyeti perse dhe duke buzëqeshur i thashë: "Kanë frikë se nuk ke menduar drejt për pasardhësin ...". Frika ishte se mos Janullatos mënjante nga timoni i Kishës në Korçë, dhespotin aktual. Po tani, pse. Jeta biologjike e Kryepeshkopit po kufizohet nga mosha. Vet Kryepeshkopi është i ndërgjegjshëm se edhe ai është i vdekshëm. Mirëpo, thamë se, me veprën e vet ai synon pavdekësinë e emrit të tij. Është pikërisht kjo vlerë që duhet çmontuar, duhet zhbërë. Kjo gjithashtu presupozon prerjen e çdo ruge të mundshme për ardhjen në krye të KOASH-it të ndonjë pasardhësi po grek, pavarësisht se pasardhësi Janullatos është i dukshëm dhe i prekshëm. Në pallatin e Hirësisë së tij Anastas duket se ka paqe. Gjatë gjithë këtyre viteve ai bënte sikur nuk e shikonte se si përreth tij thurte rrjetën e vet ajo strukturë e rreptë vëzhguese dhe kontrolluese, që vetëm me punët e zotit nuk kishte lidhje. Ishte një betejë e gjatë të cilën Kryepeshkopi Anastas besonte se do ta fitonte me veprën e tij fetare, humane dhe akademike. Po vërtetohet se ishte një kompromis sfillitës dhe i lodhshëm. Tani në çdo moment Fortlumtura e tij, nëse nuk do t'u bindet vullneteve jashtë tij, mund të ndodhet nën peshën e sulmeve të egra. Brenda oborrit të kishës disa skandale janë në zhvillim. Disa të tjera mund të plasim... Derisa shija e fundit që mund t'i mbetet Kryepeshkopit të jetë mosmirënjohja. Por, ç'rendësi ka nëse edhe Krishti nuk e fali mosmirënjohësin...

### **Disa reagime**

(Gazeta Shekulli) Posted by Έvτι Κοπίτσης at 10:16 AM

Labels: Albanian-greek relations, Religion 5 comments:

Anonymous said... Artikuj si ky i Z. Barka janë të rralla në nderim të një figure të spikatur në mbare botën ortodokse si hiresia e tij Janullatos. Megjithatë ngelet një vlerësim mjaft i moderuar, për hiresinë e tij Janullatos duhen volume të tera për nxjerje në pah personalitetin e tij. Kurse nga ana tjetër kemi artikullimin e përdorur nga z. K. Frasheri të mase vulgar dhe ofendues për të krishterët ortodokse. Konteksti në të cilin e sheh religjionin ortodoks z. Frasheri nuk dallohet shumë nga ajo që predikohet nga partia e punës. Formalisht një ish akademik ka detyrim të përdorë një gjuhë që do perkonte me nivelin e tij. Kurse bedia e sulmit të Frasherit ndaj Hiresisë Janullatos shpreh luftën e civilizimeve në Shqipëri. 1. Infrastruktura kishtarë 2. veprat bamirese 3. institucionet arsimore janë vepra më të mëdha që mund të mohohet nga njeri. Stefanos

3:03 PM Kyritsis said... Gazeta Shekulli mendon të japë balancën "e duhur" nacionaliste duke e botuar këtë shkrim pararelisht me një "fleterrufe" të sharlatani Nikolla Marku. Sharlatani ose gazeta Shekulli vete, e paraqet këtë shkrim me një titull që ska lidhje fare me përmbajtjen po edhe vete paragrafet e përmbajtjes nuk kanë lidhje me njeri tjetrin. Duket si refren i disa kengeve të mara se bashku dhe të keqlidhura me shpresën që të nxjerrin në pah talentin "muzikor" të sharlatanit Marku.

4:26 PM Anonymous said... Cuditerisht artikulli i Panajot Barkes në gazetën Shekulli ishte zhdukur nga siti- elektronik. Kjo tregon se gazetat shqiptare janë të mase

nacionaliste. Edhe kur ndokush i kundervihet kesaj tendence, behet bllokimi i zerit te tyre. Domosdo, nuk mund te presesh me shume nga ish sekretaret e e pare te rinive...

xheli 11:48 AM Anonymous said... Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi Anastas, Kryetar i Kishes Orthodhokse Autoqefale te Shqiperise, do te qendroje ne postin e Tij derisa Perendia ta ftoje ne Parajse. Dhe te gjithë luten qe ajo dite te vije sa me vone, sic u shpreh nje here Presbiteri trim, At Jani Trebicka. (His Beatitude, Archbishop Anastasios, Head of the Orthodox Autocephalous Church of Albania, will stay to His post for as long as God summons Him to Paradise. And we all wish that, that day, may come as late as possible, as brave Presbyter, Father Jani Trebicka, once put it) 4:44 AM

Anonymous said... Bravo, z.Barka! Vetem dua te skjaroj se Fortlumturia e Tij Anastas, nuk e ushtron aktivitetin madheshtor per lavdi, per t'u bere i perjetshem. Jo. Aktiviteti i tij buron vetem nga dashuria kristiane. Sa per pasrdhesin e Tij, ky s'ka se si te dihet qe tani, sic thoni ju. Pasardhesin e zgjedh Sinodhi i Shenjte. Por, sic thashe edhe me siper, bashkohem me trimin Presbiter At Trebicken,qe ajo dite mos ardhte kurre, ose ardhte shume e shume vone, domethene kur Perendia ta therrse Kryepiskopin tone te shenjte ne Parajse. 4:51 AM

## **Prof. Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/8313/>

### **Nacionalizmi, antihelenizmi dhe antishqiptarizmi**

14.11.2012

Duket qartë se kriza globale dhe veçanërisht ajo në Evropë, risjell në skenë rregullin e vjetër të rizgjimit dhe nxitjes së nacionalizmave, veçanërisht në ato vende me ekonomi të dobët e problematike, me demokraci të pastabilizuar dhe për pasojë me probleme të karakterit identitar shoqëror, kulturor e etnik. Kohët e fundit kjo duket se po përfshin keqas Shqipërinë dhe Greqinë, me tendencë për t'i futur në zgrip marrëdhëniet midis tyre. Kjo më së shumti ka të bëjë me atë se nacionalizmi ekstrem shqiptar ka bërë ushqim permanent antihelenizmin, duke kujtuar kështu fillimet e shekullit të kaluar. Nga ana tjetër, kriza e Greqisë, si pasojë e keqmenaxhimit të situatës së brendshme ekonomike e amplifikuar nga kriza e Eurozonës, po kthehet në një krizë sociale. Në traditën historike të Greqisë, kriza dhe situata të kësaj natyre janë kapërcyer me ide të fuqishme, të karakterit patriotik (aspak nationalist), që frymëzonin popullin për sakrificë sublime. Kësaj here nuk ndodh kështu. Kemi masa ekonomike që rendojnë popullin e thjeshtë dhe politikanë që kërkojnë të fshehin përgjegjësitë me ndërmarrjen e rolit të shpëtimtarit. Boshllëku i ideve të mëdha patriotike për shpëtimin e Greqisë nga recesioni ekonomik me pasoja shoqërore, po zihet nga forca të tilla si SIRIZA, që ngriti flamurin populist kundra masave ekonomike antikrizë të imponuara nga Evropa, dhe Agimi i Artë me një nacionalizëm po populist, të papërcaktuar dhe shpesh me një spontanitet që përmbledhet me zgjidhjen e problemeve imediate të përditshme të njerëzve. Ndër dy probleme kryesore, pas të cilave u kap Agimit i Artë, në aspektin e brendshëm janë emigrantët e paligjshëm dhe ai i minoritetit etnik grek (Vorio Epirit) i parë po si problem i brendshëm. Do ta quaja të mirëpritur interesimin për minoritetin etnik grek ngado që të vinte. Por kur ky interesim të kishte ide, perspektiva e qëllime të qarta të cilat t'u përgjigjen realiteteve aktuale, të kenë të gërshetuar arritjet historike të këtij minoriteti me zhvillimet e sotme evropiane, por mbi të gjitha të kenë parasysh vullnetin politik të vet këtij minoriteti. Importimi si interesim i një fryme nacionaliste, e cila përmbledhet në zgjidhje të së kaluarës e të kapërcyera, apo me parulla boshe, apo si një nacionalizëm të rritur në Greqi për minoritetin grek që banon në Shqipëri, nuk përbën zgjidhje. Më së shumti është një qëndrim që kthehet në ushqim për nacionalizmin shqiptar, korrente e të cilit janë shtuar së fundmi.

Kështu minoriteti grek, i cili në mënyrë aktive, apo thjesht si realitet natyral historik ka luajtur rol konstruktiv si sa i përket ekuilibrave të brendshme në jug të Shqipërisë, por edhe në marrëdhëniet Greqi-Shqipëri, mund të kthehet në lëndë midis mokrave të nacionalizmave të dyanshme. Për më keq kur historia e fundit 20 vjeçare ka provuar se përplasjet midis dy vendeve e ka kthyer këtë minoritetin në viktimë të nacionalizmit shqiptar, pasi minoriteti gjithmonë konsiderohet si përfaqësues i Greqisë dhe si mjet më efektiv në duart e nacionalizmit të sëmurë (e aspak të popullit shqiptar e të strukturave të shëndosha politike, mediatike e shtetërore shqiptare) ose për t'i bërë presion Greqisë, ose për të shfryrë dufin e vet në pamundësi për të arritur Greqinë. Kjo bëhet më rrezikshme po të kemi parasysh se rrymat nacionaliste shqiptare, të cilat kohët e fundit kanë mbërthyer edhe parti të koalicionit qeverisës, ushqehen fort nga një antihelenizëm i skajshëm dhe për çdo gjë. Qëmtohet në Greqi edhe detaji më i rëndomtë dhe më i parëndësishëm që të paraqitet si antishqiptarizëm, për të rritur në ekstrem antihelenizmin. Po ju marr një shembull të thjeshtë. Më 11 nëntor në një ceremoni të thjeshtë, por zyrtarisht në nivel shumë të lartë, u përkujtuam të rënë anglezë në tokën

shqiptare. Më 28 tetor u përkujtuam, si tash 20 vjet, të rënët grekë në të njëjtën luftë dhe kundër të njëjtëve armiq. Për të dytët, jo vetëm që s'kishte prani zyrtarësh shqiptarë, por kishte incidente të rënda antigreke (!!). Në marrëdhëniet e veta ky nacionalizëm shqiptar po i imponon Shqipërisë në qëndrimet ndaj Greqisë mentalitetin e njohur të tipit 'pranoj që mbetem edhe unë pa bukë, po qe se vuan edhe Greqia'. Kështu ka ndodhur me Korridorin tetë, kështu po ndodh edhe tani me marrëveshjen e detit. Po ashtu, mënyra e konfliktualitetit politik po përdoret edhe për të zgjidhur problemet e emigrantëve, apo problemet pronësore të shqiptarëve në Greqi. Në një moment që të gjitha këto duhet të ishin instrumentet e një fqinjësie të mirë dhe përfitimi të përbashkët. Lë të mos harrojmë se edhe në Greqi ka segmente të cilët e duan këtë ushqim nationalist. Rastet e ditëve të fundit në kalimet kufitare, flasin qartë për këtë. Ashtu siç flet qartë presioni që po i bëhet qeverisë greke nga këta faktorë që ta derivojë në Bashkimin Evropian si qëndrim e një fqinjësie jo korrekte të Shqipërisë ndaj Greqisë, rritjen e nacionalizmit shqiptar. Një gjë e tillë do të ishte me pasoja tepër të rënda për marrëdhëniet midis dy vendeve dhe për aspiratën e Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Evropian. Së fundmi duket se nacionalizmi do të bëhet boshti kryesor i fushatës së ardhme elektorale në vend, sidomos për parti politike jashtë boshtit kryesor të qeverisë aktuale. Por ky nacionalizëm i shfaqur si përshkallëzim i antihelenizmit mund të sjellë pasoja nga më të paparashikuarat, po të kemi parasysh se edhe stabiliteti politik e shoqëror në Greqi nuk kanë garancinë e dikurshme. Dhe dihet në raste të tilla valvula e shkarkimit bëhet nacionalizmi, fara e të cilit është hedhur edhe në Greqi, fatmirësisht deri tani jo si antishqiptarizëm.

## Reagime

### Opinion /Plarent Shehu

–Partia neonaziste greke 'Agimi i Artë' ka akuzuar drejtpërdrejtë Ministrinë e Jashtme të Greqisë dhe veçanërisht ministrin Dhimitris Abramopullos se po bashkëpunon me Shërbimet Sekrete të Shqipërisë për të ndjekur eksponentët e deputetët e kësaj partie. Sipas njoftimit të bërë në faqen zyrtare të 'Agimit të Artë', bëhet me dije se ministri Abramopullos ka bërë pakt me homologun e tij në Tiranë për të mos lejuar hyrjen e eksponentëve të partisë neonaziste greke në Shqipëri. Sipas deputetit, me origjinë nga Suli, Kristos Papas, Ministria e Jashtme e Greqisë në bashkëpunim me shërbimet inteligjente të Shqipërisë dhe homologët e tyre në Tiranë po ndjekin dhe përgjojnë çdo lëvizje të 'Agimit të Artë' në Greqi dhe Shqipëri. Partia neonaziste greke dhe deputeti Papas kanë provokuar me anë të një deklaratë për median greke se, nuk do të tërhiqen nga lufta e tyre për "Vorioepirin" dhe se do të vijë përsëri në Shqipëri dhe askush s'ka për t'i ndalur edhe pse ju është hequr e drejta e kalimit të kufirit. Sipas deklaratës së bërë nga deputeti i 'Agimit të Artë', Kristos Papas, i cili ka akuzuar drejtpërdrejt Ministrinë e Jashtme greke duke thënë se, "kush ka qenë shkelja dhe veprimi i jashtëligjshëm që kanë bërë grekët e 'Agimit të Artë'? Sepse kërkojmë një gjë që është e qartë, zbatimin e 'Protokollit të Korfuzit' i cili siguron të drejtat e minoritetit etnik grek të 'Epirit të Veriut', në Shqipëri. Ne i themi 'jo' humbjeve të trojeve tona dhe atdheut tonë, i themi 'jo' një 'Qiproje' të re në veri të Greqisë", tha deputeti ekstremist Papas. Ditë më parë partia neonaziste greke dhe deputetët e saj janë sulmuar nga të gjitha ueb-faqet e agjencive të lajmeve dhe rrjeteve sociale në internet duke i fshirë profilet dhe adresat e tyre.

Minoriteti

Kundër politikës ekstremiste të ‘Agimit të Artë’ kanë dalë disa intelektualë të komunitetit minoritar grek në Shqipëri, të cilët i janë drejtuar eksponentëve të kësaj partie duke thënë se, laicizmat dhe demagogjitë për nacionalizma dhe ‘atdhetarë’ nuk i shërbejnë çështjes së minoritetit grek. Sipas tyre politika greke duhet t’i drejtohet, përfaqësuesve politikë të minoritetit grek si, OMONIA dhe PBDNJ, të cilët prej vitesh nuk bëjnë asgjë në të mirën e komunitetit që përfaqësojnë. Një prej tyre, profesor Panajot Barka, gjatë një shkrimi, koment, dhënë për disa media greke, shkruan se, “mendoj që si ‘Agimi i Artë’ dhe Athina zyrtare, por edhe politikanët e forcave të tjera në Greqi, do të duhet që pikë së pari të merren dhe bisedojnë me drejtuesit politikë të minoritetit grek në Shqipëri për çështjet dhe të drejtat e minoritetit. Ndarja dhe përçarja e tyre ka bërë që minoriteti grek të mos gëzojë të drejtat që i takojnë”, shkruan Barka në opinionin e titulluar ‘Agimi i Artë dhe “Vorioepiri”.

Flamuri shqiptar pushon edukatoren greke

Eduktorja e një kopshti fëmijësh në fshatin Nudri të Lefkadës në Greqi, është pezulluar nga puna, pas një denoncimi që bënë ekstremistët e ‘Agimit të Artë’. Arsyet e pezullimit kanë qenë vizatimi nga disa prej fëmijëve shqiptarë, të emigrantëve në Greqi, të flamurit kombëtar shqiptar dhe flamurit italian, ditën e festës kombëtare Greke më 28 tetor. Pas ndihmës së kërkuar, të disa prej prindërve të fëmijëve grekë në këtë kopsht, nga ‘Agim i Artë’, këta të fundit kanë depozituar kërkesë padinë pranë prokurorisë dhe drejtorisë arsimore të qytetit të Lefkadës, ku është marrë dhe vendimi i pezullimit nga puna të edukatores greke.

Ngjarja

Në kopshtin numër 1 të Nidrios, të qytetit të Lefkadës në Greqi, edukatorja greke e cila ka në grup 20 fëmijë, ku 12 prej tyre janë të kombësisë dhe shtetësisë greke dhe 8 fëmijë janë të kombësisë shqiptare. Sipas edukatores, ditën e enjte të 18 tetorit, ka filluar të zhvillojë mësimin normalisht dhe të përgatitet për festën kombëtare greke të 28 tetorit. Pas përfundimit të përgatitjeve, edukatorja ka vendosur fëmijët të vizatojnë duke ndërtuar flamuj, kur në grupin e saj kishte fëmijë grekë dhe shqiptarë, disa prej fëmijëve sipas saj kanë dashur të vizatojnë flamujt e të dyja vendeve. Pas këtij veprimi, fëmijët grekë kanë shkuar në shtëpi dhe kanë informuar prindërit e tyre për këtë veprim të edukatores. Prindërit pas përfundimit të festave i janë drejtuar eksponentëve të partisë neonaziste greke ‘Agimi i Artë’ për të bërë të mundur largimin e edukatores nga kopshti. Një veprim që ndodhi pas akt-padisë së partisë neonaziste në qytetin e Lefkadës.

## **Nga Panajot Barka**

### **Antihelenizmi, leva ku mbështetet nacionalizmi i vjetër i politikës së re në Shqipëri.**

Fillim nëntori 2012

Reagimet e skajshme të strukturave nacionaliste në vend me status të legjitimuar, për të dencuar “skandalin” e Ministrisë të Punëve, Spiro Ksera, në lidhje me takimin e tij “antishqiptar” me deputetin e Agimit të Artë K. Papa në Bularat me 28 tetor, është një bufonatë dhe pak me pak se një stuhi në gotë. Mëgjithatë, një fakti i tillë provon më së miri se këto struktura e ushqejnë nacionalizmin e tyre me antihelenizëm. Që pasuesit e këtij lloji nacionalizmi të kenë ushqim antihelen sa më të bollshëm, ideatorët e tij manipulojnë, strembërojnë dhe falsifikojnë çdo gjë që ka lidhje me Greqinë si antishqiptare. Tregon se synon hapur dhe në mënyrë provokative përkeqësimin e marrëdhënieve me Greqinë dhe krijimin e një situatë paniku nacionalist tek minoriteti etnik grek në Shqipëri. Synon të shkaktojë presion ndaj qeverisë në Tiranë, për të lëshuar terren frymës nacionaliste në përgjithësi e asaj antigreke në veçanti, në politikën e saj zyrtare të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me Athinën, që përbën edhe garancinë më të mirë për rrugën e Shqipërisë drejt Evropës.

#### **Cila është e vërteta e takimit të Deputetit dhe Ministrisë Spiro Ksera me deputetin K. Papa të Agimit të Artë.**

Takimi që rastësor dhe mëse i zakonshëm në një ceremoni perkujtimore. U provua se të dy faktorët nuk e njihnin njeri tjetrin. Sapo mori vesh me kë bisedonte, deputeti grek u hodh në sulm duke i thenë z. Ksera, se je anëtar i një qeverie që nuk respekton të drejtat e “Vorioepirotëve”. Dhe zoti Ksera iu përgjigj. “Unë jam këtu, jetoj dhe punoj këtu me familjen time dhe marr pjesë në qeveri për të mbrojtur të drejtat e minoritetit etnik grek. Nuk jetoj në Greqi dhe as vij këtu të hedh ndonjë shashkë e të kthehem prap në Greqi” Kjo ishte e tera, madje e pranuar në site-n e vet dhe nga Agimi i Artë. Pyetja shtrohet : -A ka qëndrim më dinjitoz se ky nga një përfaqësues i minoritetit grek, pjesëtar në parlament dhe në kabinetin qeverisës?!

Merita e politikanit të sotëm është të di t’i përgjigjet kujtdo me monedhën e tij dhe jo t’i kthej krahët, se kështu do partia “Kuq e zi”. Diversioni i antihelenistëve nacionalistë shqiptarë, ngritur mbi gënjështërën, abuzimin dhe manipulimin sipas parimit të të bërit qimen tra, kthehet në shqetësim se amplifikohet me densitet kaq të madh sa që i ngjan dialogut final para një dyluftimi tragjik. Pjesëmarrja në këtë diversion antihelen e një pjese të sistemit medjatik, bashkë me mbeturinat e indokrinimit antihelen komunist, po e kthejnë atë në një pushtet informal, që mbyl çdo zë të arsyeshëm, mendjeftohtë, të civilizuar e me frymë Evropiane.

Problemi bëhet më i mbrehtë, po të kemi parasysh se në përgjithësi Ballkani rreshqet në kurthin e nacionalizmit, i cili jo rallë identifikohet me faktorin shqiptar.

Po, ashtu nuk duhet harruar se situata e recesionit të zgjatur në Greqi e bën më të lehtë rrugëdaljen nacionaliste. Zgjedhjet e fundit politike në Greqi u dhanë akses zedhenësve të këtyre tendencave, pa ditur kush se si mund të administrohen në të ardhmën. Fakt është se, pas “arritjeve” të fundit të antihelenizmit të nacionalizmit shqiptar qeveria greke është nën presion për ta shtruar çështjen e nacionalizmit shqiptar në Bashkimin Evropian, e për të theksuar që Shqipëria, kandidatja për në BE, nuk respekton parimin bazë për familjen Evropiane, atë të fqinjësisë së mirë. (!!!). Por qeveria greke duket se nuk ka ndërmend t’u dorëzohet këtyre sirenavë dhe po këtë shëmbull duket se po ndjek edhe qeveria e vendit tonë.

#### **Për nacionalizmin antihelen shqiptar a është kjo strehë e fundit, apo dalje nga kjo strehë e fundit?!**

Mendoj se kemi të bëjmë fatkeqësisht me rastin e dytë. Madje, shihet qartë se zgjedhjet e ardhshme parlamentare do të kenë “patrioto-nacionalizmin” si sfondi kryesor me ushqim të përcaktuar, - antihelenizmin. Po ravijëzohen edhe konturet e forcave përbërëse të këtij “poli”. Ai fillon me parti brenda koalicionit qeverisës dhe perfundon te kreu i opozitës. Kuptohet se formë të plotë ky pol ka për të marrë andej nga pranvera e vitit të ardhshëm, kur do të duket se cila nga partitë e mëdha do të ketë shansin për t’i fituar zgjedhjet e ardhshme. Kuptohet se implementimi në këto momente i një projekti të tillë, veçanërisht nga parti në koalicionin qeverisës, do të kërkonte largimin e tyre nga qeveria, që do të thotë se këto parti do të humbasin përdorimin e pushtetit për zgjerimin e elektoratit. Ideja e përfaqësuesve të këtij “poli” mbështetet tek fakti se populli është lodhur me politikën e deritashme “të demokracisë Evropiane dhe i ka kthyer asaj krahet. Oferta nacionaliste, ose politika patriotike, - mendojnë, - mund të ketë akses më të mirë tek votuesit e partisë më e madhe elektorale në që janë bojkotuesit e votimeve. Tri forca “AK-ja”, PDIU-ja dhe LSI-ja kanë dalë në plan të parë të polit në strukturim. E pëlqyer duket kjo taktikë elektorale edhe për PS-në apo edhe ndonjë forcë tjetër politike, të re apo të vjetër, të vogël apo të madhe. (Lideri i PS-së mezi përmbahet kur i kërkohet të ulë tonet antihelene)

Qëndrimet e fundit të ministrit të Jashtëm Edmond Panariti në raport me Greqinë, tregojnë se, më shumë se përpjekje për kompromentim të koalicionit qeverisës, apo provokim të tij, është një kërkesë për të evidentuar më mirë rolin e liderit në këtë ndërmarrje, si forcë politike me e konsoliduar dhe me reputacion më bindës brenda dhe jashtë vendit. (Zoti Panariti, pas vizitës në Greqi, i ndihmuar edhe nga zoti Meta, i amplifikoi deri në dhjetëfish qëndrimet e veta “në mbrojtje të shqiptarizmit” në vizitën e tij zyrtare në Athinë. Deklaratës në tone të bute të Ministrisë së Jashtme Greke pas identitetit në Kelcyrë, shkaktuar nga pasues të “AK-së” dhe “PDIU-së”, iu përgjigj nga posti zyrtar me deklaratë në mbrojtje të tyre, madje me të njëjtin fjalor. Pak ditë më vonë, në një emision televiziv foli për “Çeshtjen çame” me një terminologji që vuri në pozitë edhe kryetarin e partisë së çamëve. Me aktivistë të “AK-së” organizon seminare kualifikuese në strukturat e ministrisë së Jashtme – E mëgjithatë Ministri i Jashtëm Grek e merr në telefon zotin Panariti dhe i konfirmon pjesëmarrjen e tij në festime e 28 Nentorit në Tiranë).

Ajo që përbën një shqetësim tjetër është fakti se strukturat e këtyre forcave politike kanë në prapavijë një mbështetje ekonomike jashtë parametrave të çdo logjike. Burimi i tyre nuk dihet. Urojmë që të mos jenë, si zakonisht në raste të tilla, nga kanalet e parave të pista që aq zhurmshëm dëgjohen vite me radhë në Jug të vendit, e as nga shtete me interesa të caktuara në vendin tonë, e të shprehura ditë e ditë në shtypin e shkruar.

### **Po qeveria?**

Është tepër e vështirë që të besohet se qeveria dhe kryeministri nuk injohin dhe nuk i ndjekin këto zhvillime. Deri në një farë mase është e kuptueshme heshtja. Por, kryeministri, i cili i ka nderur motorët e zgjedhjeve, por pa hapur letrat e tij, i ka kthyer sytë nga faktori ndërkombëtar. Ai e di shumë mirë dhe kushdo e kupton se nacionalizmi, aq me tepër ndaj vendit të vetëm fqinj në BE, është një nocion dhe aksion i papërkrahshëm nga Perëndimi. Po ashtu, mosdevijimi nga parimet që rregullojnë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me Greqinë, (pavarësisht nga qëndrimet e Ministrit të Jashtëm, Panariti), i krijojnë kryeministrit mundësi reale që në zgjedhjet e ardhshme, të ketë totalisht me vete faktorin ndërkombëtar. **FUND**

## **Nga Panajot Barka**

### **Tmeri pa fund nga logjika e të zënit rob për të bërë presion etnik.**

30.01.2013

Kapitulli i parë i fazës së dytë të emisionit “360<sup>0</sup>” i Artur Zhejnë “NEWS-24” do ta cilesoja se përbën një rreth të mbyllur përpjekjesh për imazhe lufte të ftohtë dhe aspak një periskop, apo radar për të parë në 360<sup>0</sup> hapësirë, aq me pak për të parë të ardhmën. Vet titulli i këtij kapitulli “Marrëdhëniet Shqipëri-Greqi, “Një paqe e armatosur”, imazhet optikë dhe akustikë, tregonin të paktën predispozicionin e mikut tim analistit të njohur Artur Zhej. E vërtet se siguroi një shikueshmeria tepër të lartë, madje në të dy vendet. Por, nuk besoj se i dhanë autorit kënaqësinë e menduar. Vet predikimi i Zhej në finale se na duhet paqe, bashkëpunim, miqësi, frymë evropiane, tregojnë se mbyllja e këtij kapitulli emisionesh, nuk është se shterroi tematikën e kësaj logjike përplasjesh virtuale e medjatike me Greqinë, të risjellë herë pas here në opinionin publik shqiptar. Më shumë të jep përshtypjen se emisioni krijoi një ngërç, një stepje, që ndoshta lidhet me predikimin e analistit në fund të emisionit. Ndoshta se kjo frymë i kundërvihet realiteteve evropiane që aspirojmë. Ndoshta se ekstremitetet e sjella në emision treguan se bëjnë më shumë keq, se sa mirë dhe prej tyre më shumë se marrëdhëniet midis dy popujve, preken në mënyrë më të drejtpërdrejtë, minoriteti etnik grek në Shqipëri, (i mësuar tashmë nga shfaqjet të tilla) dhe mijrat e emigrantëve shqiptarë në Greqi. (Vetëm logjika e të zënit rob për të bërë presion, është e tmershme)

Nga ana tjetër, ky kapitull emisionesh erdhi në ekranin e vogël, si për t’i dhënë vijimësi apo qytetari, asaj fryme antihelene që përshkoi si matric vlerësimi nacionalizmin populist i të gjithë spektrit politik në kuadrin e 100-vjetorit të Pavarësisë.

Por erdhi edhe pas reagimit të faktorit perendimor për uljen e tonëve nacionaliste, (në kuptimin negativ të termit) dhe njëkohësisht me disa shkrime në shtypin perendimor për egzistencën e planeve amerikane për bërjen e Shqipërisë së Madhe.

Duke qenë një ndjekës i kujdesshëm i zhvillimeve të dekadave të fundit në Shqipëri e rajon, mendoj se struktura e emisionit të Zhej i kishte të gjitha elementët e ftuara kohë pas kohe për të prodhuar përplasje, tensione dhe kriza, siç janë minoriteti etnik grek, faktori Greqi, apo faktorë në Greqi, Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare etj. Si pasoj, mund ta identifikojmë edhe si një argument paraprirës ngjarjesh që mund të priten.

Theksoj se në të gjitha zhvillimet që sollën ndryshime cilesore në Shqipëri, minoriteti etnik grek, (në emër të peshës së vet historike dhe reale) u thirr, nga faktorë brenda dhe jashtë Shqipërisë (edhe Greqisë) të luajë rol transformues. (E vërtetë është gjithashtu se u thirr në pozita ballafaqese). Kujtojmë ngjarjet para rrëzimit të komunizmit (viti 90), me vëllëzërit Prasso, vrasjet minoritarësh në kufi, vizita e Ministrisë të Jashtëm Grek, provokimi etnik i dy fshatrave minoritarësh grek me dy kompani rezervistësh të ushtrisë shqiptare etj. Gjithçka e inicuar nga faktori ndërkombëtar, me dijeninë e palës greke dhe patjetër nën instrumentimin dhe kontrollin e R. Alisë, i cili e pranoi më sa duket rëzimin e pushtetit të tij me variantin rumun të 1989-es. Historia vazhdoi me hapjen e një kapitulli të ri që filloi me 1991 dhe u kulmua me 1994-95, ku provokimi etnik, alternohej me provokimin e marrëdhënieve ndërfetare. Këto zhvillime edhe pse pa lidhje reale të drejtpërdrejtë kanë ndikimin e tyre në ngjarjet e 96-97 në Shqipëri. Për të ardhur tek deklarata e Presidentit Klinton, pak para se NATO të fillonte veprimin ushtarak në Kosovë, me 1999. Mëgjithatë theksojmë, se elementët veprues nga minoriteti etnik grek në këto zhvillime nuk përbënin produkt të ndërjegjës kolektive të minoritetit. Ngjarjet e mëvonshme



vërtetuan se zhvillimet dhe individet protagonist nga minoriteti të atyre zhvillimeve njiheshin dhe kontrolloheshin nga të gjitha palët. Fitonte ai që e kontrollonte më mirë situatën. Po ashtu është e vërtetë se qeveria zyrtare greke ishte vazhdimisht e distancuar (me përjashtim të rastit të 6 pikave të Micotaqisit-93).

Vet minoriteti, në raport me këto role (të misionuara), nuk tregoi ndërgjegjësime dhe angazhim. Nuk funksionoi as edhe pesha primare në ruajtjen e ekuilibrave dhe koherencave sociale, fetare e etnike në rajonin jugor të vendit, pasi për minoritetin bashkëjetesa me popullin shqiptar ishte primare në sjelljen e tij kolektive. Para këtij fakti, nuk ka rëndësi analiza e faktorëve të tjerë, pavarësisht nga rëndësia e tyre. Definicioni ishte që ky minoritet në zhvillimet e brendshme politike dhe në rajon të shndërrohej në faktor periferik dhe të mos arrinte të përfitonte nga këto zhvillime (kuptohet në kuptimin pozitiv), por të vuante pasojat.

Faktet tregojnë se pavarësisht nga amplitudat këto situata riktheheshin në vend për gjithfarë arsyes. Herë për konvencione siç është rasti i abuzimit me termin e Vorio Epirit. (Jam shumë i bindur se po të përdoret në shqip termi si “Veriu i Epirit”, nuk ngjall asnjë reagim pasi, perderisa është fakt që Epiri tradicional është ndarë me kufi politik në dy pjesë, atëherë, ai ka një pjesë Veriore në Shqipëri dhe një pjesë Jugore në Greqi). Herë për çeshtjen hapje shkollash, herë për statusin etnik të krahinave, (siç është Himara), herë për deklarata tej normave të lejuara, herë për kërkesa për përkujtimin e ngjarjeve historike, në lidhje me këtë minoritet etj.

Po ashtu, është venë re se individë apo struktura brenda vendit nga minoriteti etnik grek, për të marrë përsipër role të tilla “ballafaquese” dalëngadalë po shtërrnin, se ose ishin të paaftë, ose nuk gëzonin asnjë lloj reputacioni, ose faktori minoritar që donte karrierë politike në Shqipëri, e kuptoi se këtë karrierë mund ta siguronte duke iu përshtatur faktorit shqiptar dhe jo duke u ballafaquar me të. (Rasti më i fundit, shndërrimi pa takt në të kundërtën e vet të deklaruar vite me parë ose në ambjente greke të Vasil Bollanos para kamerës së Zhejt)

### **Pjesa në vijim nuk u përfshi në shkrim**

Në vitin '90 kur ishte shtruar për zgjidhje problemi i rrezimit të diktaturës në Shqipëri, u duk qartë se në dijeninë, drejtimin dhe kontrollin e Ramiz Alisë, u lajt edhe varianti rumun për “rëzimin” e tij. Arrëstimi i vëllezerve Prasos në kufi, torturimi i tyre dhe ndërkombehtarizimi i çeshtjës, ishte inskenimi i parë i përdorimit të minoritetit kundër diktaturës komuniste. Vrasjet në kufi, pas abrogimit nga Kuvendi i atëhershëm Popullor të ligjit që kalimi i kufirit nuk përbënte më tradhëti kombëtare por shkelje administrative, në shumicën e rastëve i përkasin këtij minoriteti. (Kulmi u arrit më 12 dhjetor 1990 kur u vranë mizorisht në kufi katër djem nga Aliko e Jerma që provokoi edhe demonstratën e parë të vërtetë në vend me karakter të hapur antikomunist e entik). Vizita e Ministrit të Jashtëm të Greqisë Andonis Samaras, (sot kryeministër) në Tiranë me 25 tetor 1990 dhe provokimi i rendit protokollar gjatë vizitës në Dropull, ishte sinjali i radhës që minoriteti grek duhej të kthehej në faktor i rrezimit të diktaturës. (Atje Samaras njoftoi largimin e Kadaresë nga Shqipëria, largim i cili do të ndodhte në fakt pas tri dietesh, pra ishte i parapërgatitur dhe i ditur. Atje porositi minoritarët se priteshin zhvillime në Shqipëri, që kërkonin prej tyre kujdes, të ishin të përgatitur dhe të mos largoheshin nga trojet e tyre). Provokimi etnik, (në fundin e nëntorit 1990, me urdhër personal të Ramiz Alisë, dy kompani rezervistësh të ushtrisë shqiptare rrethuan dy fshatra minoritare grek, të njohura për ekspresivitetin e tyre nacional), përbën faktin më domethënës që minoritetit i kërkohej rol në përmbysjen e diktaturës.

Ngjarjet që pasuan vërtetuan se e injektuar nga jasht dhe me dijeninë, po të Ramiz Alisë dhe të faktorit ndërkombëtar, të paktën atij Amerikan, ishte edhe gjasëm deklarata në fundin e viti 1991 të një eksponenti të OMONIA-s, (në fakt të kompromentuar nga Sigurimi shumë kohë më parë), se kjo organizatë lufton për bashkimin e Vorio Epirit me Greqinë. U duk se deklarata do të përdorej si gurrë prove për të hequr nga drejtimi i OMONIA-s udhëheqjen e saj të natyrshme, për ta zëvendësuar atë me njerëz të besuar të Athinës. (Në fakt ndodhi ky zëvendësim por pasi ishin infiltruar si njerëz të besuar të Athinës, persona të lidhur me shërbime sekrete të Shqipërisë).

**Nga Panajot Barka/Pedagog, Gjirokastrë**

<http://shekulli.com.al/18203/>

**“Krizë nacionaliste”, dramë njerëzore**

08.03.2013

Po kalojnë muaj që të gjithë ata nënshtetas shqiptarë me vendlindje në Greqi dhe që në pasaportat e tyre shqiptare nuk kanë të shënuar toponimin e vendlindjes sipas normave të shtetit Helen e që si të akredituara në OKB, nuk mund të kalojnë pikat kufitare me Greqinë. Problemi është shumë shqetësues pasi bëhet fjalë për mijëra raste të kësaj natyre. Pas disa tolerimesh shteti grek tregohet i vendosur në qëndrimin e vet, pasi në një rast të tillë nuk ka toleruar as qytetarët shqiptarë me kombësi greke. Në aspektin normativ ligjor ndërkombëtar, shteti grek ka të drejtën me vete, pasi çdo shtet anëtar i OKB-së, në rastin konkret Shqipëria, është i detyruar që në dokumentacionin e vet zyrtar të respektojë toponimet e një vendi tjetër, sipas përcaktimeve për këto toponime të akredituara nga ky shtet. Në rastin konkret Greqia, anëtare në këtë Organizatë. Ashtu si Greqia bën në dokumentacionin e vet zyrtar me toponimet analoge shqiptare. Fakt është se bëhet fjalë për rastin e parë në marrëdhëniet midis dy vendeve që preken aq drejtpërdrejt qytetarët e thjeshtë, sidomos fëmijët e të rinjtë. Problemi është komentuar shpesh si një “tekë” e Greqisë për gjëra formale. Dhe më keq akoma kur thuhet se këto “teka” Greqia kërkon t’i zgjidhë duke përdorur si mjet presioni ndaj Tiranës këta mijëra qytetarë të pafajshëm. Ky argument duket i pavend pasi si në aspektin politik, shoqëror edhe kombëtar, Greqisë nuk i leverdisë të kultivojë tek mijërat e shqiptarëve një ndjenjë antigreke. Politika zyrtare e Greqisë ka treguar të kundërtën, bile duke paguar shpesh një kosto të brendshme politike shumë të lartë. Ajo, në vlerësim të marrëdhënieve njerëzore midis Shqipërisë e Greqisë, ka adoptuar me kohë faktorin e emigrantëve shqiptarë në Greqi si argument të rëndësishëm në kultivimin e tyre midis dy vendeve. Në këtë kuptim nga pala greke janë bërë përpjekje të shumta për një zgjidhje të problemit të krijuar. Tolerimin e kërkuar nga pala shqiptare Athina e ka kondicionuar minimalisht me angazhime konkrete të Tiranës për një zgjidhje të problemit qoftë edhe në një thellësi kohe. (Kuptohet se në radhë të parë ka kosto të lartë për vetë qytetarët, të cilët nuk kanë asnjë faj.) Kështu duhet kuptuar shtyrja e disa hershme e zbatimit të moratoriumit në lidhje me këtë pikë nga ana e Greqisë. Tirana zyrtare (konkretisht Ministria e Jashtme) duket se kërkon tolerime pa kushte dhe pa angazhime konkrete për respektimin e kësaj të drejte ndërkombëtare të Greqisë. Madje, nga zyrtarë të lartë politikë të kësaj Ministrie, bëhen edhe deklaratat, ndoshta për konsum të brendshëm, se “ne nuk do të ndryshojmë gjuhën tonë shqipe”. Duket gjithashtu se politika e jashtme zyrtare e vendit tonë, duke e paraqitur problemin si një pretendim formal të Greqisë, kërkon ta derivojë problemin në kuadër të frymës më të gjerë nacionaliste antigreke. Në këtë sens i vjen doresh fakti i të ushqyerit të antigreqizmit midis emigrantëve shqiptarë në Greqi, shtresë e cila në të gjitha rastet e përkeqësimit të marrëdhënieve të Shqipërisë me Greqinë ka treguar se ka shërbyer si amortizator i shkëlqyer për kapërcimin e situatave të padëshirueshme, shpesh duke paguar për vetë kosto jo të pakta. Po ku qëndron problemi dhe pse pikërisht tani u kujtua Greqia, për një problem që ka të paktën dy dekada? Do të mjaftonte kjo pyetje për të mënjanuar argumentin formal. Megjithatë duke e gjykuar problemin në aspektin formal do të na rezultonte se fajin e kanë përkthyesit nga greqishtja në shqip, të cilët “u lejuan” që toponimet greke të përktheheshin siç shqiptohen në shqip dhe jo si janë akredituar nga Greqia në OKB për përdorim ndërkombëtar. Po të qe kështu, besoj se problemi do të që vërtet formal dhe thjeshtësisht i kapërcyeshëm. Aq më tepër se popujt e të dy vendeve nuk kishin paragjykimet për toponimet e tyre, madje ato ishin shumë të përbashkëta. Fakt është se

problemi filloi kur në një masë të madhe pasaportash shqiptare biometrike po përdreshin toponime inekzistente në Greqi, të cilat në Shqipëri shërbenin për të mbështetur e mbajtur gjallë retorikën nacionaliste. Logjika e do që nëse Greqia do të pranonte këtë toponomastikë lindjeje në pasaportat e shtetasve shqiptarë, kjo, në një moment të caktuar, mund të përdorej si argument të pranimit de facto nga ana e Greqisë të atyre pretendimeve që shfaqeshin në mediat shqiptare; sa herë që pala greke kthente në kufi qytetarë shqiptarë, pasaportat e të cilëve përmbanin toponime me vendlindje të kësaj natyre. Si përfundim do të thosha që situata e krijuar është e vërtetë e dhimbshme, antihumane deri edhe e palejueshme, madhe me një kosto shumë më të madhe për Greqinë. Në një rast të tillë Greqia po humbet një investim ndër vite për të fituar admirimin dhe mirënjohjen e mijëra emigrantëve shqiptarë. Por përderisa Athina e ndërmerret këtë hap, bile duke mos përjashtuar as homogjenët e vet, kjo do të thotë se për atë nuk është një kapriço formale, por një problem serioz. Këtë e vërteton edhe fakti se Ministria jonë e Jashtme duket e vendosur të mos lëshojë pe në argumentin e vet të mos “cenimit” të gjuhës shqipe. Dua të jem i gabuar, por duket se uria nacionaliste po krijon dramën e saj të parë të rëndë e që lidhet me peripecitë e mijëra emigrantëve shqiptarë që kanë një toponim grek lindjeje të shqiptarizuar.

**Nga Panajot Barka/Publicist**

<http://shekulli.com.al/26688/>

**Rilindja, si një kontratë me ndërgjegjen**

29.06.2013/07.07.2013

Normaliteti i procesit paszgjedhor, duhet vlerësuar seriozisht si hap i parë për t'i dhënë fund procesit të stërzgatur të tranzicionit. Sigurisht që meritën kryesore e ka vota e popullit, i cili këto 20 vjet ka dërguar deri në sfilatje të njëjtat mesazhe të qarta. Ishin politikanët ata që i rrëzonin popullit gurin e Sizifit nga maja e malit dhe e ftonin ta ngjiste sërish. Këtë herë populli foli më qartë. Si lumë i heshtur dhe në kufijtë e një zemërate ia arriti të çmitizojë edhe mitin e Berishës. Kësaj here politika duket se ndoqi mesazhin popullor. Hodhi armët nga përfitonte edhe fuqinë politike, edhe fshehjen e zullumeve. U fut në shina civile e mirëkuptimi. Krijoi një klimë të shtensionuar e paqeje. Fjala e Edi Ramës, i pari si kryeministër, 2 ditë pas zgjedhjeve, ishte katalizatori. Bëri më të domosdoshme, por edhe me të lehtë aktin tjetër, atë të dorëheqjes së Sali Berishës. Në fakt, situata duhet vlerësuar si fillim i një momenti kalimtar. Sipas Ramës, “nuk është mbërritja, por vetëm nisja jonë”. Në aspektin filozofik e praktik, momentet kalimtare nuk janë vetëm delikate.

Në rastin e vendit tonë, me një stërzgjatje në zgrip të proceseve demokratike e civilizuese, përveç se delikat mbart edhe rreziqe. Kalimi i suksesshëm i këtij momenti, kërkon mohimin e së kaluarës së rëndë dhe afirmimin e së ardhmes, nëpërmjet ngritjes së sistemit dhe jo vullnetit të politikës. Si pikë referimi për instalimin e sistemit transformues duhet marrë fjala e Edi Ramës më 25 qershor 2013. Unë besoj se ajo fjalë nuk ishte emocion. Emocioni i skajshëm tregoi se 50-vjeçari Edi Rama u ndërgjegjësua më shumë për përgjegjësinë që populli i besoi. Tregoi se Ai kuptoi në ekstrem se ëndrrën e tij për të rilindur vërtet vendin, nuk mund ta arrijë i vetëm. Nuk mund ta arrijë as vetëm me partnerët strategjikë e jo strategjikë. Nuk mund ta realizojë as vetëm me votuesit fitues.

Rëndësi ka që vizioni i tij për sistemin që do të realizojë, “Rilindjen”, është i qartë: “Një demokraci të rivendosur në themelin e bashkëjetesës mes nesh si shqiptarë, pavarësisht përkatësive partiake e krahinore”. Dhe më tutje “Pa harruar në asnjë hap se duhet të jetë gjithë-përfshirja, jo përjashtimi i pakicës, virtyti i dialogut me tjetrin, jo vesi i monologut kundër tjetrit, shpirti i kompromisit, jo tradita e vetëpëlqimit...”. Edi Rama kërkon me ngulm realizimin e kësaj ëndrre nga ne të gjithë, duke na krijuar bindjen se duhet punuar e sakrifikuar fort për të arritur këtë objektiv-ëndërr, duke premtuar solemnisht, ose duke bërë një kontratë shoqërore publike se Ai për vete, do të jetë kryeministri dhe kryeshërbëtori i secilit shqiptar, ku detyra e drejtimit do të jetë e Tij, ndërsa pushteti do të jetë i secilit nga ne... Kjo do të thotë se “Kontrata shoqërore për Rilindje e Demokraci”, e Edi Ramës është e detyrueshme të bëhet pronë e çdo shqiptari. Në radhë të parë, të bëhet pjesë kryesore e angazhimeve të elitës intelektuale shqiptare. Madje do të ishte mirë që para se t'i lexohej anonimatit të ardhur rishtazi nga beteja elektorale, (dhe s'kishte asnjë dëshirë për të menduar gjë tjetër veçse fitores), të proklamohet para kësaj elite si ftesë ndaj shtresës civile të vendit për bashkëpërgjegjësi. Kjo, klasa e intelektualëve, duhet të përbëjë bazat e konstruksionit të sistemit që propozon Edi Rama, që nesër as vetë ai, Edi Rama, të mos mund ta deformojë edhe sikur të dojë. Intelektualin e karakterizon virtyti i përkushtimit deri në sakrificë sublime të asaj që aspiron. Dhe në krye të çdo gjëje është dashuria për Atdheun e tij. Në rastin konkret duhet çliruar ky virtyt nga ngarkesa e mentalitetit se intelektualizmi barazohet me aftësinë për të përfituar nga pushteti sa më shumë për vete e për familje. Është

domosdoshmëri për të gjithë, madje më shumë për ata që nuk kanë besim tek Rama, apo e konsiderojnë veten kundërshtarë të tij, të angazhohen maksimalisht për projektin e Tij. Ta bëjmë pjesë të ndërgjegjes e të angazhimeve tona, me qëllim që të fitojë, jo Rama, por sistemi dhe platforma që ai propozon, të fitojë, jo Ai personalisht, por të gjithë ne. Por ditët që po kalojnë, vërtetojnë se në vendin tonë, ky projekt, sistemi i vlerave që ai gjeneron si dhe nevoja për implementimin e tij po “harrohet”. Madje, po kalon si pa u vënë re. Në vend të diskursit për këtë projekt dëgjon rëndom si “like” ndaj Ramës se “Ai është kokëshkretë dhe do t’i bëjë ato që thotë”. Harrohet se filozofia e Niçes për Mbinjeriun, në rastin më të mirë shpreh një mënyrë për të shprehur vullnetin e shumicës nga njëshi, kur kjo shumicë është ngjizur deri në mosdukje me njëshin.

Kjo e bën më të domosdoshme shndërrimin e tezave të Ramës nga strukturat civile të shoqërisë, në platformë reale dhe funksionale. Por, në vend që këto teza të ishin shndërruar në një debat masiv dhe konstruktiv, po lihen mënjanë dhe harrohen. Qëllimisht?! Ndoshta! Kjo do të thotë se “Kontrata shoqërore, “Për Rilindje e Demokraci”, e Edi Ramës do të lejohet që maksimalisht të kthehet në sfidë personale të tij. Që do të thotë dramë personale për një udhëheqës politik dhe tragjedi për një shoqëri, që aspiro, por nuk sakrifikon. Shenjat janë pesimiste kur përfaqësues të kampit fitues, po ngjeshin radhët e me durim e këmbëngulje po pretendojnë për vete një copë sa më të madhe pushteti. Motoja e devotshmërisë së tyre të re është ndjenja e hakmarrjes ndaj “të mundurve”. Këtë klimë do ta rëndojnë në të ardhmen e afërt fakti se të vegjlit e shumë, në aleancën fituese do të kërkojnë shumicën e pushtetit. Në konsideratë duhet marrë fakti se një pjesë e madhe e votuesve për aleancën e Rilindjes zgjodhën atë parti që deri dje ishte pjesë e qeverisjes së mohuar prej tyre.

E keqja është se kjo interpretohet si politikë pragmatiste. Në thelb përbën një hap më shumë në konsolidimin e marrëdhënieve klienteliste të politikës me zgjedhësit dhe që përbën një fund të parathënie për rrënimin total të shtetit. Klasa intelektuale, në vend të inspirimit të debateve publike, është venë në pritje duke i lënë fushë të lirë veprimi klanit të opinionistëve, të cilët ose presin të katapultohen në makinën e pushtetit, ose të ruajnë fort monopolin e pushtetit të medias. Ndaj dhe ata nuk duan të hapin debate të qenësishme publike në frymën e zhvillimeve që imponojnë zgjedhësit e politika, dhe merren me mënyrën se si do të ndahet pushteti, me numra, kalkulime, emra, poste, thashetheme të rëndomta. Klimën e rëndon më shumë fakti që korrupsionistët në të gjitha hallkat e shtetit, të ngritura në sistem nga toleranca e popullit dhe të kthyer në vlerë e meritë për përfaqësuesin e shtetit, krimi i organizuar, kanalet e parave të pista po llobojnë fort, si për të sofistikuar veprimtarinë e tyre, ashtu edhe për të gjetur nëpërmjet korrupsionit, linja kontakti me pushtetin e ri.

E rëndon më shumë toka e djegur e lënë pas nga qeverisja e mëparshme e shprehur më shumë në arkën bosh të shtetit... E rëndon akoma... mungesa e opozitës. Dhe në këtë klimë të rrisht duarkryq e të presësh Ramën, ngjason me sehixhiun që pret kryqëzimin e tij, pa kuptuar se me parë vjen vetëeliminimi. E konsideroj padrejtësinë time pjesë të atij sistemi që duhet zëvendësuar dhe një përvojë të vyer për të parë llumin e zi ku përfunduan vlerat njerëzore e humane, të shumëzuara me zero nga vlera e parasë. Personalisht nuk pres të më thërrasë Edi Rama, apo ndonjë përfaqësues i tij për të lidhur ndonjë kontratë. Çdo njeri lidh, po të dojë kontratë me ndërgjegjen e tij me sistem referimi “Kontrata shoqërore për Rilindje e Demokraci” të ofruar nga Rama.

**Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/28955/>

**Kisha e Përmetit, puçi i Berishës për qeverinë e re**

18.08.2013/19.08.2013

Në hapësirën kohore midis qeverisë në ikje dhe asaj në pritje, ndjesia e hapësirës bosh po zëvendësohet nga përpjekja për zgjerim e thellim të boshllëkut ekzistues, që, sido që të jetë, është i madh e shumëdimensional. Mund të dallohen dy kategori problemesh: së pari vihet re përpjekja e opozitës për të maksimalizuar opozicionin me qëllimin e vetëm për të fituar statusin e paprekshmërisë, përballë këmbënguljes së qeverisë në pritje për reforma të thella. Kategoria e dytë ka të bëjë me nxitjen dhe agravimin e problematikave qeverisëse, nëpërmjet abuzimit me statusin kalimtar qeverisëse. Kemi parasysh rendin (ka nxitje të përplasjes së strukturave të rendit me vatra të tensionuara, të njohura shumë mirë deri dje, por të lëna në heshtje, siç është rasti i Lazaratit), prishjen e ekuilibrave ekonomikë, sidomos të atyre që lidhen me arkën e shtetit, riciklimin e problematikës që ngërthen kohezionin shoqëror, religjioz etj. Kreun e këtyre përpjekjeve e zuri së fundmi ngjarja e Përmetit e datës 16 gusht 2013.

Struktura zyrtare Perëndimore, të informuara rishtazi, e konsiderojnë ngjarjen shumë të rendë dhe me ndikim shumë negativ e të drejtpërdrejtë mbi rrethin e aspiratave për marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE. Dëmi iu bë Shqipërisë, por me synimin e mbrapshtë që t'i faturohet qeverisë në mbërritje... Ngjarja në Përmet, ku një "përmbarrim" privat me ndihmën e një policie private (dhe jo të shtetit) "zbatoi një vendim gjyqësor" për të zhbërë një kishë në emër të bërjes së një "shtëpie kulture" (në paralelën e kundërt të Tiranës ku kemi zhbërjen e një shtëpie kulture për të bërë një zyrë partie), risolli në vëmendje një problematikë marrëdhëniesh të ndërlikuara, mprehtësia e të cilave është vërtet shqetësuese. Pretendimi për "zbatimin e ligjit" në antinominë e një padrejtësie totale në vend, nuk mund të justifikojë cenimin e asaj simbolike, që konsiston në të drejtat fundamentale të një shoqërie civile, siç është respektimi i institucioneve të besimit fetar, aq më tepër, që për vendin tonë lidhet me cenimin e bashkëjetesës fetare, vlerë për të cilën krenohemi se përbëjmë shembull botëror. Incidenti në dëm të komunitetit ortodoks në Përmet tregoi se fondamenti komunist (ateizmi shtetëror 40-vjeçar), mund të përdoret si instrument për cenimin e fondamentit bazal shoqëror, e një besimi të caktuar, atij ortodoks. Në historinë e "konfliktit", vihet re se sistemi komunist prishi më 1962 kishën e vjetër të Shën Mërisë së Përmetit dhe mbi të, si dhe në një pjesë të truallit të kishës, ndërtoi një shtëpi kulture që i dha emrin e poetit rilindës Naim Frashëri.

Kisha ortodokse, sipas konceptit komunist, i bënte karshillëk mjedisit të kongresit të parë politik me vlerë shtetformuese të komunistëve shqiptarë, atij të 24 majit 1944. Që do të thotë se "simboli" politik komunist duhet të bëhej absolut dhe i pakonkurrueshëm nga një objekt kulti, pavarësisht se ai përfaqëson një fundament shekullor identitar shoqëror. Më 1996-97, Kisha Ortodokse, në emër të së drejtës së këtij fondamenti dhe duke patur përkrahje herë legale e herë jo të politikës, e shndërroi shtëpinë e kulturës komuniste në tempull të besimit fetar. Fatkeqësisht, struktura shtetërore dhe civile jashtë komunitetit ortodoks, u kapën pas konvencionit të "ligjit" për të mbajtur në këmbë "fondamentin" komunist, (shtëpinë e kulturës) kësaj here në emër të mbrojtjes së identitetit kombëtar. (Trajtim që përjashton de fakto edhe një herë Kishën Ortodokse nga të qenit pjesë e konstitucionit shqiptar) Pra, u vu ballë për ballë e drejta universale e besimit fetar, me të drejtën juridike të nëpërkëmbur dhe të anatemuar si hallka më e korruptuar e shtetit. Dhe "fitoi" e dyta... Veprimet që e bëjnë këtë ngjarje tepër të rendë,

nuk janë aq skenat e nëpërkëmbjes së priftërinjve ortodoksë dhe besimtarëve të tjerë, që bënë xhiron e botës. As ngarkimi i sendeve të kishës në një mjet ngarkese të rëndomtë që të kujtojnë shekuj të kaluar. Në simbolikën e veprimeve që e bëjnë këtë ngjarje tepër të rëndë tërheq vëmendjen fakti që u hoq kryqi dhe u vendos flamuri kombëtar. U hoq emri i Shën Mërisë dhe u vendos emri i poetit të Rilindjes...(!!!)

Pra, janë këto veprime (të trajtuara si triumfale) që rrëzojnë me potere inflacionin e deklaratave për respektimin e të drejtave dhe tolerancës fetare nga strukturat e shtetit e të komunitetit... për të provuar se kjo tolerancë duhet kuptuar sipas raporteve të imponuara marrëdhëniesh mbi komunitetet fetare, (në rastin konkret atij ortodoks) nga “relatorë”, të cilët pretendojnë monopolin e përfaqësimit të identitetit kombëtar shqiptar. Këto lloj marrëdhëniesh bëhen më evidente po të kemi parasysht se ortodoksia në Shqipëri është venë në pozita inferiore. Inferioriteti buron prej pretendimit absurd të identifikimit të kësaj kishe me helenizmin. (E kundërta e të cilit, antihelenizmi, është rikthyer së fundmi në skenë si një dogmë efektive e vetë-përcaktimit etnik shqiptar). Flet për këtë fakti që autoritetet e larta të Kishës Ortodokse nuk guxojnë të denoncojnë në emër të autoritetit që përfaqësojnë ngjarjet të shumta denigruese të ortodoksisë, por, ashtu si në rastin e Përmetit, përdorin mënyra masovike të denoncimit anonim të tipit “klerikët e Mitropolisë”, ose komuniteti i besimtarëve. Këtë pozitë inferiore e ka diktuar origjina e tyre”, të qenit grekë... (ndodh sikundër në komunitete të tjera fetare në Shqipëri ku veprojnë klerikë nga vende të tjera të huaja, bile në ndonjë rast me precedent të rrezikshëm).

Për këto autoritete, shfaqja denoncuese publike, është e barasvlefshme me ndërsimin e mësymjeve të paskrupullta në emër të antihelenizmit. (Madje, midis të tjerash, mbi këtë bazë është arritur pakti i heshtjes zyrtare të autoriteteve të Kishës Ortodokse, të etiketuar si “shërbyese të Helenizmit”, edhe për rastin e shkatërrimit të monumenteve të kulturës së traditës së lashtë ortodokse në vend, edhe pse ato mbartin kulturën greke). Nga ana tjetër, një ushtri e tërë, deputetesh, ministrash, intelektualësh dhe kuadrosh të përkatësisë fetare ortodokse, të rangjeve dhe niveleve nga me të ndryshme, nuk kanë marrë guximin për të mbrojtur asnjëherë besimin e tyre fetar. E konsiderojnë atë problem jashtë vetes së tyre. (Përjashtim të rrallë bën qëndrimi i intelektualëve korçarë në rastin e një drame, apo edhe i para dy ditëve për Përmetin). Në të njëjtën kohë, Kishën Ortodokse e marrin “nën mbrojtje” individë të përkatësive të tjera fetare, “partenalizëm” që në fakt “e fitojnë” me deklarin e nacionalizmit me dimension të vetëm, antihelenizmin. Theksuam se pas incidentit të Përmetit janë strukturat e shtetit, të fshehura pas veprimit të faktorit të privatësisë në zbatim të ligjit. Të njëjtin qëndrim tregoi shteti edhe kur në censusin e 2011, ortodoksët në Shqipëri u rrudhën si asnjëherë në histori, në masën rreth 6% të popullsisë, kur në konceptimin publik ortodoksët shqiptarë e kalojnë masën 20-25 %, dhe prapë askush nuk u ndie. Por rasti i kishës së Përmetit duhet parë si një tregues inskenimesh që mund të provokojnë dhe ndërveprime zinxhir.

(Deklarata e Mitropolisë së Korçës dy ditë pas incidentit, flet hapur për këtë). Synimi është që duke dëmtuar imazhin e Shqipërisë në mjedisin ndërkombëtar, në fushën e ndjeshme të respektimit të të drejtave religjioze, kërkohet t’i lihet një faturë e rëndë qeverisë në ardhje, nga e cila të përfitojë në luftën e brendshme politike opozita e re. Nga ana tjetër, loja për deheroizmin e eshtrave të ushtarëve grekë të luftës italo-greke, gjatë zhvarrimeve më 2006-ën, po në Përmet, Kosinë, futi në qerthull marrëdhëniet Shqipëri Greqi për një kohë të gjatë. Kësaj here problemi është më i gjerë. Ka të bëjë me marrëdhëniet e Shqipërisë me Komunitetin Evropian në lidhje me aspiratën për të fituar statusin e vendit kandidat për në BE, por që në muajt e ardhshëm do të kalojë nëpërmjet Greqisë, pasi ajo merr drejtimin e radhës së BE-së. Dhe struktura të caktuara



që fshihen pas ngjarjes së kishës së Përmetit, të cilat e njohin mirë peshën e Greqisë në BE, kërkojnë t'i rëndojnë këto marrëdhënie me probleme të reja dhe me delikate, që do t'i vuajë qeveria e re.

## **Reagime**

### **Historiani Xhufi: Qeveria shqiptare të reagojë ndaj ndërhyrjeve të Greqisë**

Reagimi i Ministrisë së Jashtme greke për çështjen e Kishës së Përmetit, në analizën e historianit Pëllumb Xhufi është një veprim i përsëritur dhe pjesë e një strategjie për të krijuar incidente mes dy shteteve tona. Duke mbështetur veprimin e përmbarimit për t'i rikthyer qytetin Pallatin e Kulturës, Xhufi deklaroi dje për "Vizion Plus" se qëndrimi i shtetit fqinj ngjan me politikën e ndjekura nga grekët në fund të shekullit të 19, ndërkohë që sot është një realitet tjetër dhe Shqipëria ka kishën e saj autoqefale, e cila nuk pranon ndërhyrje nga asnjë vend apo asnjë shtet. Sipas Xhufit, ndërhyrjet e Greqisë në çështje si Kisha e Përmetit, inkurajohen nga mungesa e reagimit të shtetit shqiptar. Dy ditë më parë, Ministria e Jashtme e Greqisë e cilësoi të papranueshme nxjerrjen jashtë të Kishës në Përmet, pavarësisht vendimeve gjyqësore.

### **Përmet, meshë në rrugë, reagojnë klerikët në Korçë dhe Berat**

Dje rreth orës 8:00 ka filluar mbajtja e Liturgjisë së Shenjtë, si çdo të dielë, në kishën e Shën Marisë së Pazarit, në qytetin e Përmetit, nën drejtimin e ikonomëve Athanas Qerimi e Vasil Thomollari. Mesha, këtë radhë u mbajt në shëtitoren përballë Shtëpisë së Kulturës, e cila sot ishte rrethuar me forca të shumta policie, private dhe nga komisaritet Përmet e Gjirokastrë. Në meshë merrnin pjesë pak besimtarë, jo si të dielat e zakonshme, kur pjesëmarrja ka qenë më e lartë dhe mesha zhvillohej në ambientet e brendshme të ndërtesës. Pas riteve fetare dhe ndarjes së bukës së bekuar, ikonom Athanas Qerimi mbajti një deklaratë në fund të meshës, ku bëri me dije se kisha s'do heqë dorë nga prona e saj në asnjë mënyrë. Ai iu drejtua, në emër të kishës, të gjithë atyre që vunë dorë mbi kishën, duke thënë se kanë fëmijë për të rritur dhe të shikojnë familjet e tyre, ndërsa u kërkoi besimtarëve të mblidhen çdo ditë në shëtitore, për të kryer ritet fetare, duke filluar nga dita e nesërme.

Prishja e Kishës së Shën Marisë, në qytetin e Përmetit, ka sjellë edhe reagimin e Mitropolisë së Korçës dhe komunitetit ortodoks të këtij qyteti. Përmes një deklaratë, Mitropolia ka shprehur indignatën, për atë që e ka cilësuar si të barabartë me sulmet e qeverisë komuniste mbi besimet fetare dhe vendet e shenjta, dhe apeloj që organet shtetërore të jenë të ndjeshme dhe të drejta ndaj komunitetit ortodoks. "Në emër të të gjithë komunitetit ortodoks të dioqezës sonë, shprehim indignatën tonë të thellë ndaj këtij agresioni kundër kishës ortodokse, që në ngjarjen e kishës në Përmet mori një përshkallëzim të rrezikshëm, duke lënduar ortodoksët e Shqipërisë dhe duke dëmtuar imazhin e vendit tonë", tha Ksenofon Ilia Kotnani. Mitropolia i është drejtuar me disa kërkesa autoriteteve shtetërore, duke thënë se do të vazhdojë të kërkojë të mbështesë kishën e Shën Mërisë në Përmet. "Këto veprime, nëse nuk ndalen, mund të kenë pasoja të rënda për harmoninë dhe kohezionin e shoqërisë sonë. Kërkojmë që ngjarja të pasqyrohet me drejtësi dhe vërtetësi. Nuk është kisha, ajo që ka zaptuar Pallatin e Kulturës, por e kundërta, sepse ai pallat u ndërtua mbi kishën dhe pronën e saj. Kërkojmë që organet shtetërore të jenë të ndjeshme dhe të drejtë ndaj komunitetit ortodoks. Nuk mund të tjetërsohen vendet e shenjta, me makinacione ligjore, duke krijuar ligje që janë në kundërshtim me të drejtat ndërkombëtare", shtoi Ksenofon Ilia Kotnani.

Pak ditë më parë, ekzekutimi i vendimit të gjykatës, për rikthimin ndaj Bashkisë të ndërtesës së Pallatit të Kulturës, brenda së cilës ishte ndërtuar kisha, shkaktoi një përplasje mes priftërinjve dhe policisë, që mbështeti zyrën e Përmbarimit në

ekzekutimin e vendimit. Një deklaratë për çështjen e kishës së Shën Mërisë në Përmet është bërë edhe nga klerikët dhe një grup besimtarësh ortodoksë në qytetin e Beratit. “Na bën përshtypje të pakëndshme fakti se, prej më shumë se 16 viteve, është bërë një ballafaqim serioz midis besimtarëve përmetarë dhe përfaqësuesve të pushtetit vendor, që kjo godinë t’i kthehet kishës së ngritur prej shekujsh, me emrin “Shën Maria e Pazarit”. Deri më sot, nuk është zgjidhur plotësisht kjo kërkesë e klerikëve dhe të krishterëve përmetarë. Për më tepër, tani veprohet me dhunë për ta marrë këtë tempull të shenjtë, ku njerëzit gjejnë paqe shpirtërore. Nuk pajtohemi kategorikisht me këto veprime anti-fetare dhe kërkojmë me të drejtë, që qeveria të ndërhyjë fuqimisht për t’i dhënë zgjidhje përfundimtare këtij problemi kaq delikat, duke plotësuar këtë kërkesë të ligjshme”.

## **Nga Panajot Barka/publicist**

<http://shekulli.com.al/29406/>

### **Berisha-Dule, aktorë të tensionit shqiptaro-grek**

26.08.2013

-Aksioma e gjithëkohshme në lidhje me marrëdhëniet dypalëshe ka dy anë. E para provon se kur ato priren nga parimet e mirëkuptimit, bashkëpunimit, respektit në bazë të reciprocitetit pozitiv, atëherë ato japin rezultate pozitive, përfitime reciproke dhe zhvillim të dyanshëm. E dyta ka provuar të kundërtën. Rruga e mesme mbjell mosbesim, rezerva dhe ekuilibra të brishtë që më së shumti janë frenuese. Mbizotërimi sot i instrumenteve të tilla si BE-ja, NATO, KiE-ja, OSEBE-ja etj, imponon pa ekuivok variantin e marrëdhënieve të bashkëpunimit e të mirëkuptimit. Po marrëdhëniet midis Greqisë dhe Shqipërisë cilat parime ndjekin? Rasti i fundit, ai i Përmetit, në serinë e rasteve analoge në këtë periudhë tranzicioni, tregojnë se momentet e së kaluarës, të pakta në numër dhe që nuk përbëjnë thelbin e historisë midis popujve, të filtruara përmes dogmave “etnike” përpunojnë një kujtesë konfliktuale të paqenë. Fatkeqësisht ajo vihet në shërbim të interesave të çastit, të politikave të brendshme deri në interesa grupit.

**Greqia-** Në asetet historike, që nga lashtësia, grekët tregojnë se janë ndoshta populli i vetëm në botë që ekzistencën dhe identitetin e vet i ka mbështetur tek hapja dhe integrimi, tek aftësia që arrijtjet e tij t’i trajtojë si pronë e gjithsecilit me të drejtën që arrijtjet e gjithsecilit t’i konsiderojë si të vetat. Edhe themelet e ndërgjegjes së re kombëtare greke, që zënë fill tek epika e “Dhijenis Akritas” kanë këtë brum, ashtu si edhe ideologjia dhe realiteti i revolucionit grek i shek XIX. Në ditët e sotme Greqia është një shtet Evropian në të gjitha parametrat, që (edhe sot në ditët e krizës) përbën një fuqi politike, ekonomike dhe kulturore me vulën e vet e të BE-së. Në raport me Shqipërinë, politika permanente e fqinjësisë së mirë dhe e marrëdhënieve të mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe përfitimit reciprok, të përfaqësuar nga shtetit grek, është e vërtetë se ndesh në segmente politikëbërëse jo zyrtare apo me interferenca në politikën zyrtare. (Shpesh, në mënyrë të qëllimshme mediat dhe bibliografia shqiptare, por edhe Tirana Zyrtare, ngatërrojnë politikën zyrtare greke me qëndrimet e këtyre qarqeve). Këto segmente, në momente të caktuara mund të arrijnë t’i imponohen përkohësisht politikës zyrtare. (Rasti i Përmetit mund të përdoret si fakt). Shkaku kryesor i aksionit të tyre mbetet minoriteti etnik grek në Shqipëri. Shpesh ata abuzojnë me sensibilitetin e skajshëm grek për të drejtat e minoriteti grek, pa lejuar të bëhen kalkulimet e duhura, (për mosdije, qëllimisht apo edhe për interesa personale e të grupit) midis historisë dhe realitetit të sotëm të këtij minoriteti.

**Shqipëria-** Nën vëzhgimin e historianëve shqiptarë e të huaj, me në krye gjuhëtarin Çabej, ruajtja e vlerave të veta kulturore dhe identitare lidhen me izolimin. Po këta shkencëtarë na thonë se Perandoria Otomane çoi në ekstrem shtrirjen gjeografike të shqiptarëve. Madje, po sipas Çabejit, edhe këngët epike të shqiptarëve, që ashtu si tek popujt e tjerë evropianë, u ndikuan nga “Dhijenis Akritas”, kanë heronj epikë muhamedanë që mbrojnë trojet e tyre nga të krishterët. (krejt ndryshe nga epika te popujt evropianë apo të paktën tek shqiptarët –arbëreshët e Italisë). Ky status duket se ka përcaktuar si nevojë për vetëpërcaktimin identitar kolektiv, ballafaqimin e përhershëm me të huajt, në radhë të parë me fqinjët. (Nuk ndodh as me komunitetet shqiptare jashtë truallit të shtetit shqiptar). Kjo veçori u kthye në fundament ideologjik nga regjimi komunist ku uniteti i brendshëm social-nacionalist sigurohej sipas dogmës absolute se “të gjithë e kanë halë në sy Shqipërinë”. Është kjo arsyeja që këto produkte

ideologjike të izolimit, për shkak të ksenofobisë, siç thotë Oliver Jens Schmitt, vepronë akoma në Shqipëri. Sipas tij, elitat e vjetra komuniste që ruajtën kontrollin mbi interpretimin e historisë, nuk lejojnë asnjë ballafaqim me shkencën perëndimore mbi këto çështje, as çmitizimin e kësaj lloj historie.

Thelbi i gjithë kësaj lidhet me përpjekjen e mundimshme të këtyre kastave në shërbim të politikës, pse jo dhe zyrtare, për të ruajtur kontrollin mbi njerëzit e thjeshtë dhe “për t’i ndërsyer” ata kundër kujtdo që u kundërvihet interesave të kastave politike apo të grupit. Në këtë rrafsh, antihelenizmi u bë aksioni bazë për vetëpërcaktimin etnik shqiptar që arriti kulmin në festimit e 100-vjetorit të pavarësisë. Pra, në të dy vendet ekzistojnë struktura të caktuara vepruese jashtë politikës zyrtare. Në Greqi, politika zyrtare, është përballë këtyre strukturave, kur veprimi i tyre politik bie ndesh me politikën kombëtare zyrtare. Në Shqipëri, për të justifikuar qëndrimet e veta politike si “shprehje” të vullnetit popullor, politika zyrtare shpesh imponohet me dashje nga veprimi i këtyre strukturave. E përsëritur kjo pothuajse në të gjitha rastet e incidenteve shqiptaro-greke, tanimë është kthyer në risi. (Rasti i Përmetit është i pari në të cilin nuk kemi veprimin e drejtpërdrejtë të strukturave shtetërore, por atyre private). Kjo risi presupozon ekzistencën e një arkivi fiks mediatik dhe njerëz konkretë që përsërisin në monolog, pa ballafaqim dhe në mënyrë bezdisëse të njëjtat gjëra. Rikthim një shekull e ca para, për të kthyer në gogol të shqiptarëve dhe në ankth e frikë të minoritarëve grekë tabunë për ta, atë të Vorio Epirit. Pas kësaj shfaqet shteti i sotëm shqiptar. Në palën greke, strukturat që thamë, abuzojnë në ekstrem e deri në konfuzion me mbrojtjen e të drejtave të minoritetit etnik grek.

### **Mekanizmi i veprimit**

Marrim rastin më të freskët, atë të Përmetit. Pak ditë para incidentit të shëmtuar dhe ekstremisht të dënueshëm të policisë private ndaj objektit të kultit ortodoks, kryetari i PBDNJ-së komentoi mospërfshirjen e partisë së tij në qeverinë “Rama”. Në lidhje me këtë fakt ai njoftoi se në ditët në vijim do kishim zhvillime të reja(!!!) Nuk e di nëse ishte koincidence, por fakti që mediat pranë tij, në ditët që pasuan, mbajtën fort anën e linjës së përkeqësimit të marrëdhënieve midis dy vendeve, (ashtu si edhe deklaratat e tij në lidhje me këtë incident) lë shumë hapësirë për të dyshuar se ekzistonte informacioni paraprak për ngjarjet në Përmet. Në Greqi, linjat jo zyrtare, të mbështetura në skenat e frikshme të policisë private në Përmet dhe në emër të mbrojtjes së të drejtave fetare (të minoritetit(!)) imponuan Ministrinë e Jashtme greke në ato deklarata evazive. Kjo donte të thoshte se situata duhej balancuar. Dhe orkestruesit e balancuan me “sulmin” e besimtarëve për të rimarrë kishën. (Që kishte orkestrim flasin faktet: Policia “e hekurt” private, që shkëlmonte priftërinjtë si lecka dhe rrëzonte kambanoren me forcën e frymës, u mund si prej letre para “sulmit” të besimtarëve. Besimtarët, pasi “e morën” kishën, pas disa orësh e braktisën dhe... policia “rivendosi” kontrollin. Të nesërmen e gjithë policia “shkoi për kafe” dhe besimtarët përfituan për të arritur deri tek muret e kishës me dritare të mbyllura me mur...(!!!) Në Shqipëri politika zyrtare heshte, duke lejuar mediat për të nxitur, “në papërgjegjshmërinë” e tyre përkeqësimin e situatës. “Asi” në këtë lojë u bë bllokimi i mijëra shqiptarëve në kufi, nga një urdhër që nuk kishte tagrin e politikës së jashtme zyrtare të Athinës. Linja e politikës jo zyrtare greke ishte futur në lojë. Por nuk qe dakord trupi diplomatik i Greqisë në Shqipëri. Nga veprimi i saj u arrit që të neutralizohej urdhri bllokues i shqiptarëve në kufi dhe situata të normalizohej. Në këto momente u shfaq me profil qëndrimi të ashpër Tirana zyrtare. Por kur pa se në asnjë rast nuk do të kishte një përgjigje analoge nga pala greke, u tërhoq duke u kujdesur të shfaqej fitimtare në “këtë betejë”. Kumtoi se detyroi Greqinë të tërhiqej, me masa reciprociteti negativ(!!!)

Greqia nga ana e vet kumtoi se si shtet evropian, nuk mund të lejojë politikën e saj të jashtme të bjerë pre e incidenteve të pakuptimta dhe e interesave okulte që nuk lidhen me interesat shtetërore e kombëtare të saj. Si shtet evropian, kërkon që peshën e vet ta përdorë në shërbim të popullit të vet dhe të popujve të tjerë në Ballkan. Po përse incidentin e Përmetit mund ta quajmë të dyshimtë? Sepse, njëra palë u kujtua pas 12 vjetësh, për implementimin e një vendimi gjyqësor, ndërsa pala tjetër, Kisha Ortodokse, pas vendimit gjyqësor, nuk ndoqi rrugën mirëkuptimit dhe as rrugën e drejtësisë evropiane të të drejtave të njeriut, por atë të faktit të kryer me mjete jo legale.

### **Por cili ishte qëllimi i përfitimit nga ky incident?**

Prishja e imazhit të Shqipërisë në prag të fitimit të statusit të vendit kandidat për në BE, kthyer në faturë të rendë për qeverinë e ardhshme. Dhe po në këtë kuadër, prishja e marrëdhënieve me Greqinë që ka një rol parësor në këtë drejtim. Detyrimet e vjetra të lidhshimit të minoritetit etnik grek ndaj strukturave që operojnë me këtë logjikë në Tiranë dhe mendësia e shantazhit si hakmarrje për mospërfshirjen në qeverinë e re me poste ministri, (që do të thotë dobësim politik të tij) e bëjnë të pranueshme logjikën e bashkëveprimit të tij në këtë incident. Me dobësimin politik të këtij lidhshimit të minoritetit dhe në Shqipëri nuk bien dakord as strukturat që përkrahën linjën e ashpër në Greqi.

Po përse Përmeti është vazhde e incidenteve që çuan shpesh në zgrip marrëdhëniet Shqipëri-Greqi? Mediat shqiptare zbuluan pa dashje disa protagonistë në këto incidente që “veprojnë kundër interesave kombëtare shqiptare” dhe i quajti të pandëshkueshëm (!!!) Vërtet, u derdh lum gazi lotsjellës dhe u ushtrua dhunë e policisë private në Përmet kundër besimtarëve, madje edhe kundër gazetarëve. Këtyre “heronjve antishqiptarë” dhe njëkohësisht kaq pranë institucioneve përfaqësuese politike dhe jo politike të minoritetit etnik grek, nuk iu prek asnjë fije floku (!!!?). Mediat zbuluan gjithashtu se ata janë në përgjithësi me të kaluar të dyshimtë. Pra, të gjitha gjasat tregojnë se këta “heronj të helenizmit”, mund të jenë provokatorë të pranuar në struktura greke, pra me rol të dyfishtë. Përvoja ka vërtetuar se kudo ku shfaqen “aspiratat” helene të këtyre “antishqiptarëve”, shfaqet babëzia për përfitime personale apo të grupit, në emër të shqiptarizmit. Shembull tronditës përbën Himara. Pas shpalljes së saj si objektiv helenik prej dyshes Bollano-Dule, (2003) falanga uzurpatoresh me flamurin kombëtar shqiptar e kthyen perlën e bregdetin në një kaos të pafund, ku mes tyre humbi dhe çdo pretendim helen. E njëjta skenë përsëritet që nga 1991-92. I pamë si zgjidheshin për të përfaqësuar OMONIA-n, i pamë më 1994 me incidentin e Peshkëpisë, i pamë më 2003-in dhe në vijim në Himarë. I pamë në Kosinë më 2006-ën. I shohim edhe në Përmet...Ata janë njerëz që pavarësisht “antishqiptarizmit”, të tyre kanë në Shqipëri, shumë pasuri, privilegje dhe akses në çdo nivel dhe formë në mjedisin shqiptar.

### **Por nuk duhet t'i shohim më...!!!**

Kush humbet dhe kush fiton nga këto incidente? Në radhë të parë humbasin marrëdhëniet e mira midis dy vendeve dhe dy popujve. I humburi tjetër shumë i madh është minoriteti etnik grek në Shqipëri. Pasojë të sa më sipër, ky minoritet humbi përfaqësimin e denjë politik, mbrojtjen e të drejtave të tij, demografike, ekonomike, arsimore, kulturore. Humbi kohezionin e brendshëm komunitar që e zëvendësoi me një përçarje të pariparueshme. Të humbur janë edhe mijërat e emigrantëve shqiptarë që çdo trazim marrëdhëniesh e vuajnë me një mënyrë ose në tjetrën në kurrizin e tyre. E humbur është edhe Shqipëria. Demagogjia disavjeçare për gjasme sabotim të Greqisë për korridorin tetë (kur në Greqi ky korridor kishte marrë fund) çoi në abandonim përfitimin e investimeve për aksin Jug-Veri që e la Shqipërinë jashtë integritetit si me korridorin tetë ashtu dhe lidhjen me Evropën Qendrore. Nacionalizmi për konsum të brendshëm sipas parimeve të shekullit të kaluar, krijon siklet të vazhdueshëm në

Perëndim, për ta integruar në struktura euroatlantike. Shqipëria mund të mbetet me dylbitë e Kreshnik Spahiut në dorë, nëse mirëkuptimi i ofruar për zgjidhjen e marrëveshjes së kufirit detar, e cila do të hapë rrugën e përfitimit reciprok ekonomik, do të zëvendësohet me arbitraritetin e ligjshmërisë ndërkombëtare, ose të njëanshmërisë. Dhe në fund të fundit, përse dhe në emër të kujt operohet në politikën kombëtare me mjete të fillim shekullit të kaluar? Shqipërisë dhe popullit shqiptar, ashtu si atij grek, nuk i shërbejnë komplekset e fajit, frikës, dyshimit, kur jetojnë në zemër të Evropës dhe popujt e tjerë i kalojnë kufijtë midis tyre me shpejtësinë e erës.

**Nga Panajot Barka/publicist**

<http://shekulli.com.al/31543/>

## **Demokracia dhe thika me dy presa e ekstremizmit**

30.09.2013

Mbështetur te parimi sublim për mbrojtjen e demokracisë civile dhe politike, si dhe te deklarata e kryeministrit Antonis Samaras, se “dënojmë veprimet e tyre në emër të ligjit e të kushtetutës dhe jo bindjet e tyre”, Greqia ndërmori një aksion historik për arrestimin e një numri të madh eksponentësh të Agimit të Artë, midis tyre edhe kryetarin dhe nënkryetarin e këtij grupimi si dhe një numër të madh deputetesh të tij. Pas vitit 1967 ky është rasti i dytë i një ngjarjeje me përmasa të tilla politike në Greqi. Ka megjithatë një dallim thelbësor. Ato ngjarje të 1967-s bëheshin në emër të vendosjes së diktaturës së kolonelëve. Arrestimet e shtatorit 2013, po bëhen në emër të ruajtjes së demokracisë. Goditja e grupimit të Agimit të Artë, me akuza të një organizate kriminale, tregon se në Greqi, pavarësisht se kriza ka goditur rëndë, shteti është i fortë dhe vepron efektivisht, kur është fjala për të ruajtur rendin kushtetues dhe demokratik.

Tregoi qartë se Greqia e ka pjekurinë e duhur politike dhe demokratike për mirëkuptimin, bashkëveprimin e bashkëpunimin e të gjithë spektrit politik, kur është fjala për të ndërmarrë veprime në emër të interesave të larta të vendit, për t'i marrë ato shumë shpejt, ndonëse mund të jenë shumë radikale, shumë të guximshme, të tilla që dhe shtetet e tjera perëndimore mund dhe po hezitojnë. Aksioni i ndërmarrë kundër Agimit të Artë pati mbështetjen morale dhe energjike të faktorit të brendshëm dhe mediave, si edhe të institucioneve perëndimore dhe ky ishte një inkurajim për Greqinë në hapat konkrete të mëtejshme. Megjithatë kjo do të thotë se, me dashje ose pa dashje, pas këtij hapi, Greqia hyri në një fazë tepër të rëndësishme të politikës së saj të brendshme dhe që hap një sipar të ri në politikën ndërkombëtare. Nga ana tjetër, ky gong që ra është me risqe të shumta për jetën e saj politike e

Agimi i Artë është një forcë politike që në një hark kohor të shkurtër, fitoi 7% të votave të elektoratit grek. Kjo i dedikohet faktit se, politika ekzistuese greke e 30-35 viteve të fundit, e çoi në ekstrem vijën politike të marrjes dhe mbajtjes së pushtetit me metoda klienteliste e korruptive, që me siguri një ditë do të sillte, ashtu siç edhe sollën, krizën e kolapsin. Klasa politike tradicionale, mbështetur në këta faktorë, tregoi një rezistencë të paimagjinueshme dhe mbeti sërish në lojë, edhe pas goditjeve të fundit, ku vota e popullit ktheu në minorancë absolute parti deri dje në pushtet. Rrënimi i qytetarëve grekë vuri, ashtu siç që e logjikshme, më në pah, probleme sociale, por edhe kombëtare shumë të qenësishme që janë njëkohësisht tepër të mprehta. Në këtë boshllëk gjeti terrenin e vet Agimi i Artë. Dhe është pikërisht ky terren që i bën risqet e goditjes së këtij grupimi shumë të mprehta. Para vendosmërisë së organeve të drejtësisë greke, të qeverisë dhe të forcave politike, para mbështetjes absolute të mediave dhe të opinionit publik, spikati shqetësimi, nëse do të çohet deri në fund aksioni i ndërmarrë. Në Greqi ka patur probleme tepër të rënda me korrupsionin, shpërdorimin e detyrës nga qeveritarët, me ryshfete e të tjera, që kërcënonin rendin demokratik.

Në këtë kuadër, edhe drejtësia tregoi ngathtësi në goditjen e tyre. Ndërkohë që shpejtësia me të cilën veproi me rastin e Agimit të Artë, është sfiduese për atë vet, pra Drejtësinë, por edhe për situatën në vend. Jemi në kushtet të gati pamundësisë për të menduar se aksioni kundër Agimit të Artë, nuk mund të ndodhë për përfitime politike të brendshme, aq sa edhe të idesë se Greqisë iu dha flamuri për të eksperimentuar mundësitë e frenimit të ekstremizmit të djathtë në rritje galopante në Europë(!) Në Greqi po goditet Agimi i Artë, por problemet mbi të cilat ky grupim ngriti mbështetjen

e vet mbeten të pazgjidhura. Të gjitha këto dhe problematika të tjera, siç është ai i mundësisë së reagimit të strukturave të Agimit të Artë, bëjnë që Greqia të futet në një proces shumë përshpejtues të veprimeve të veta politike, qeverisëse, menaxhuese të situatave shoqërore dhe kombëtare. Në radhë të parë, ajo jo vetëm ka rastin, por ka detyrimin të fitojë besimin dhe përkrahjen e qytetarëve grekë dhe të partnerëve ndërkombëtarë. Por rasti i Greqisë, përbën gjithashtu një rast shumë të mirë për civilizimin e politikës dhe shkundjen institucionale të drejtësisë shqiptare. Një rast i mirë që shteti shqiptar nga konsumues dhe shpërdorues i vlerave të krijuara nga nënshtetasit e vet (faktikisht të përvetësuara nga përfaqësuesit e partive politike në shtet) të kthehet në një instrument menaxhues, në favor të shoqërisë dhe ta kthejë shtetin nga armik të qytetarëve të vet, në mbrojtës të tyre.



## **Panajot Barka/publicist**

<http://shekulli.com.al/31953/>

### **Batërdia e një rektori**

07.10.2013

-Në këtë fillim viti akademik, Universiteti i Gjirokastrës që mban emrin e profesorit të shquar Eqrem Çabej, vjen me një ngërç dramatik. Auditi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, realizuar në fund të vitit 2012, gjeti shkelje të rënda të ligjit në 12 drejtime kryesore dhe dëmi financiar shkaktuar shtetit nga këto shkelje, arrin masën e mbi 33 milionë lekëve (të reja). Sipas raportit të KLSH-së, shkeljet ishin të tilla që autoriteti i këtij Universiteti duhej të kallëzohej në prokurori. KLSH-ja, pas ndërhyrjeve politike të PD-së, e shmangu këtë përgjegjësi nga vetja dhe ia rekomandoi për zbatim Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Kjo ministri, ashtu si edhe për shumë çështje të tjera në lidhje me shkeljen e ligjit nga autoriteti i këtij Universiteti, bëri rolin e shurdhit. Pas kësaj, që të mbyllej totalisht kapitulli i shkeljeve të ligjit dhe shpërdorimit të detyrës të vëna re nga auditi i KLSH-së, duhej edhe një vendim gjykate.

Ky vendim duhet të thotë se, përfituesit nga shkeljet kanë të drejtë dhe auditi i KLSH-së ia futi kot. Ose në rastin më të keq, shlyerjen e dëmit ta bënin masivisht pedagogë dhe punonjës të tjerë të Universitetit, pavarësisht nga fajtori dhe përfituesi. Për këtë arsye, në mars të 2013-s, autoriteti i Universitetit me firmën e rektorit Gëzim Sala, paditi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Gjirokastrës rreth 70 pedagogë dhe punonjës të tjerë të Universitetit, për përfitime të paligjshme(!) Në krye të listës së përfituesve të paligjshëm, sipas padisë, qëndron vetë rektori Gëzim Sala me rreth një milionë e shtatëqind mijë lekë të reja. Për t'i shërbyer qëllimit të rektorit procesi gjyqësor hyn në disa paradokse. Së pari: Në raportin e KLSH-së nënvizohet qartë se, dëmi u shkaktua për shkak të shkeljes së ligjit nga ana e autoritetit të Universitetit. Që do të thotë se ky autoritet mban përgjegjësinë minimale penale, atë të shpërdorimit të detyrës. Por autoriteti i Universitetit me anë të kësaj padie kërkoi ta transferonte përgjegjësinë nga vetja tek masa e pedagogëve dhe punonjësve të tjerë. Dhe nga një çështje penale në ngarkim të tij ta kthejë në një çështje civile formale.

Kjo për arsyen e thjeshtë se pedagogët e paditur, në rastin më të keq u urdhëruan nga ky autoritet për punën e kryer dhe u paguan, pasi ky autoritet ligjëroi me firmë e me vulë pagesën e tyre. Aq më tepër që shumica prej tyre i kanë përfituar ato para në mënyrë mëse të ligjshme. Së dyti: Gjykimi i çështjes, edhe pas 7 muajsh, është ende në proces, madje në fillimet e tij. Gjyqtari i tanishëm i çështjes shpreh habinë se si asnjë prej të paditurve nuk paraqitet në sallën e gjyqit për të mbrojtur veten e tij. (Në mbi 15 seanca të zhvilluara u paraqitën në raste të rralla minimalisht disa prej tyre). Paradoksi më i madh qëndron tek fakti se, në këtë proces kemi rektorin që padit veten në gjykatë dhe nuk paraqitet në procesin e gjykimit për të mbrojtur vetveten. Fakti vërteton bindjen e tij se gjyqi është i fituar në tavolinë, jo nga institucioni i Universitetit që përfaqëson rektori, (paditësi), por nga individi përfitues që identifikohet me rektorin (i padituri Gëzim Sala). (Nuk dihet sa të lehtë do ta ketë gjyqtari t'u japë të drejtë të paditurve, që nuk shkojnë në procesin gjyqësor për të mbrojtur veten e tyre. Ne deklarojmë se kurrsesi nuk duam t'u besojmë thashethemeve, se rektori u mblodhi lekë pedagogëve për të paguar trupin gjykues "për ta fituar" ata gjyqin. Por, kur sapo gjatë procesit gjyqësor është vërtetuar me fakte se rektori brenda të njëjtës ditë që ishte me shërbim jashtë universitetit, ishte dhe në Universitet për të bërë mësim, apo për punë tjetër administrative, pra është vërtetuar mashtrimi i rektorit për përfitim material, gjykata vendosi ta ndajë çështjen në mënyrë të tillë, që këto fakte të mos mund të ballafaqohen

brenda të njëjtit proces. Kjo tregon se Gjykata është e gatshme për të shkelur ligjin vetëm e vetëm që të mbrojtë shkelësin e ligjit).

Së treti: Paradoksi i radhës lidhet me qëndrimin e juristit të KLSH-së në procesin gjyqësor. Ai nuk mbron konkluzionet e raportit të auditit të KLSH-së, por pretendimet e rektorit. Madje juristi i Universitetit iu referua vendimit të kolegut të tij në KLSH, për të përjashtuar nga gjykimi 8 veta, dëshmitarë të vjedhjes së arkës së Universitetit nëpërmjet mashtrimit dhe falsifikimit të dokumenteve(!). Paradoksi i katërt ka të bëjë me faktin se autoriteti i Universitetit, në kundërshtim me ligjin, këmbëngul që të mos u dorëzojë të paditurve provat dhe dokumentet ku mbështetet padia e tij dhe trupi gjykues (i deritanishëm) është pajtuar me këtë këmbëngulje dhe refuzim të detyrimit ligjor të paditësit. Elementi i pestë paradoksal në këtë proces lidhet me faktin se pala paditëse, autoriteti i Universitetit, “i merr në mbrojtje” pedagogët dhe punonjësit e tjerë të Universitetit të paditur prej tij dhe tregon hapur se, është i interesuar që të mos jenë të pranishëm në procesin e gjyqimit. (Përfaqësuesi i palës paditëse, Universitetit, në këtë proces merr përsipër njoftimin e të paditurve, ka dosje të përbashkët me ndonjë përfaqësues të tyre, rakordojnë qëndrimet, ose kërkon që t’i lodhë ata që guxojnë dhe shkojnë për të mbrojtur vetveten etj.) Por e vërteta për këtë interesim të autoritetit të Universitetit, që pedagogët të mos jenë të pranishëm në proces, qëndron gjetkë. Autoriteti i Universitetit nuk do që vartësit e tij të dinë se ai, rektori Gëzim Sala, kërkon të shpëtojë veten nga shkeljet e rënda ligjore nëpërmjet të drejtës së tyre, duke u bërë pjesë e grupit të tyre.

Ashtu si nuk do që ata të marrin vesh se drejtohen nga një njeri me makutëri ekstreme për përfitime të paligjshme... Nga audit i KLSH-së rezulton se, brenda një viti akademik ai kryen mesatarisht nga 5-7 norma vjetore mësimore(!!!). Rektori nuk do që të merret vesh se si kaldajat dhe gjeneratorët në Universitet nuk kanë punuar asnjë ditë (se ishin të prishura) dhe ata, pedagogët, ishin të detyruar të zhvillonin mësim në të ftohtë, ose ishin të detyruar të ndërprisnin mësimin për shkak të mungesës së energjisë elektrike. Mirëpo, në financat e Universitetit rezultojnë se kaldajat dhe gjeneratorët kanë punuar rregullisht dhe në letra kanë “konsumuar”, karburantin e parashikuar në buxhetin e Universitetit(!!!) Por, përse gjithë kjo eufori e rektorit në marrëdhëniet me drejtësinë dhe organet e tjera të ruajtjes dhe respektimit të ligjit...!? Se ai, rektori, ka shpërdoruar postin dhe ka krijuar interesa okulte me këto organe. Po tregoj dy shembuj: Në nëntorin e vitit 2012, audit i Ministrisë së Arsimit ushtroi kontroll rutinë edhe në Universitetin e Gjirokastrës për zbatueshmërinë e ligjit në rekrutimin e stafit të ri akademik. Menjëherë pas largimit të këtij audit, u shpërthye me dhunë zyra e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore(!) dhe u vodhën plot 26 dosje pedagogësh. Logjika më e thjeshtë shkak – pasojë, thotë se vjedhja e dosjeve të pedagogëve u bë për arsye se në to mund të kishte dokumente të falsifikuara dhe se rekrutimi i tyre si pedagog, i bërë në këto kushte, përbën vepër penale. Prokuroria e Gjirokastrës nisi procedim penal për këtë çështje në dhjetor të vitit të kaluar. Logjika e thjeshtë thotë se prokurorisë i duhej të ballafaqonte dokumentacionin e marrë për verifikim nga audit i ministrisë, me librin e protokollit dhe procesverbaleve të pranimit të pedagogëve dhe me dokumentet e tyre reale të tërhequra nga prokuroria drejtpërdrejtë nga institucionet që i lëshuan ato. Por, prej një viti kjo nuk ndodh dhe të gjitha gjasat tregojnë se çështja do të mbyllet... Po ashtu, në korrik të këtij viti, në Prokurorinë e Përgjithshme është depozituar një kallëzim penal për shpërdorim detyre në ngarkim të rektorit Gëzim Sala. Kallëzimi penal iu dërgua për vlerësim Prokurorisë së Gjirokastrës.

Në fillim të shtatorit këtij kallëzimi iu shtuan fakte dhe argumente të tjera të shpërdorimit të detyrës nga ana e rektorit, kryesisht në linjën e auditit të KLSH-së. Por kalojnë javë dhe prokuroria nuk kthen asnjë përgjigje nëse do të procedojë ose jo...

Dhe këtu nuk u morëm me anën më të errët të procesit akademik. E megjithatë pyetja shtrohet: Ç'po ndodh me këtë institucion dhe a do të vihet dorë, jo thjesht për të zbatuar ligjin, por për ta shpëtuar atë?! Apo është vendosur që degradimi i tij të jetë pjesë e qëllimeve të errëta për mbylljen e tij?!

**Nga Panajot Barka/Publicist**

<http://shekulli.com.al/32436/>

## **Premisat dhe sfidat e marrëdhënieve greko-shqiptare**

14.10.2013

Me vizitën e sotme të Evangjellos Venizellos, nënkryetar i qeverisë greke dhe njëkohësisht ministër i saj i Jashtëm, mbyllet cikli i vizitave zyrtare të diplomacisë së lartë të tre fqinjëve, partnerë strategjikë të Shqipërisë. Nën këndvështrimin e Realpolitikës së vjetër ballkanase turi i tre kryediplomatëve mund të vlerësohet sipas skemave të vjetra të rivalitetit gjeopolitik. Por, e parë në gjykimin e politikës gjithëpërfshirëse evropiane, ky gjykim zhvlerësohet. Duke marrë në konsideratë faktin historik se është hera e parë që kemi një tur të tillë vizitash, në një kohë kur qeveria e re nuk ishte ulur akoma në karrigen qeverisëse, konkludohet se këto vizita edhe një herë promovojnë në nivel praktik fqinjësor, interesin ndërkombëtar për Shqipërinë në raport me qeverinë e saj të re. Interes që e ka burimin tek gatishmëria e saj për të hapur një faqe të re në historinë e Shqipërisë. Referimi lidhet me synimin evropian të qeverisë Rama e që ka të bëjë: Në aspektin e brendshëm me ndryshimin e mentalitetit qytetar, politik, qeverisë, vendosjen e shtetit ligjor. Në aspektin e jashtëm, me krijimin e një partneriteti dypalësh apo shumëpalësh mbi standardet e akteve ndërkombëtare. Qëllimi është që Shqipëria të bëhet pjesë reale e Evropës, për meritë dhe jo thjesht për koniunkturë ndërkombëtare si në rastin e anëtarësimit në NATO. Nga ana tjetër, profili evropian i deklaruar në Tiranë për marrëdhënie partneriteti dypalësh, i japin mundësi qeverisë që të shfrytëzojë në favor të Shqipërisë, por edhe në favor të marrëdhënieve pozitive e të qëndrueshme bilaterale e multilaterale, çdo lloj rivaliteti të mundshëm midis fqinjëve të saj strategjikë. Pra, të mos përdoret, si rëndom deri sot, në favor të rivalitetit rajonal apo dypalësh midis fqinjëve dhe në dem të interesave të veta. Në këtë kontekst pozitiv u zhvilluan dy vizitat e para. Ahmet Davutoglu tregoi në Tiranë se ndjehej si në shtëpinë e vet, pra një partneritet miqësor që tejkalonte disi edhe nivelin ballkanik të të demonstruarit afinitet diplomatik e politik. Emma Bonino, me stilin e njohur të diplomacisë italiane, pas impresionit të pafshehur për gjatësinë e Kryeministrit tonë dhe performancës së re të rezidencës qeveritare, tregoi se Italia është e interesuar për përparimin e Shqipërisë dhe se do t'i jetë pranë qeverisë së re në ndërmarrjen e saj të vështirë për të bërë shtet evropian. Po Evangjellos Venizellos! Vizita e numrit dy të qeverisë greke zhvillohet në kushtet e objektivave të politikës së Jashtme të qeverisë të shpallur nga Kryeministri Rama që thotë “zero probleme me fqinjët” dhe deklaratave të ministrit të Jashtëm Ditmir Bushati, se në marrëdhëniet me Greqinë do të lihet pas kapitulli i menaxhimit të krizave dhe do të hapet kapitulli i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë mbështetur në vullnetin politik të qeverisë dhe normat ndërkombëtare. Në përgjigje të tyre Venizellos vjen me një paketë mbështetëse për qeverinë e Tiranës në synimin e saj për të zvogëluar distancën midis aspiratës dhe realitetit evropian të Shqipërisë. Sot marrëdhëniet Shqipëri-Greqi, kanë në aspektin juridik një dokument, ndoshta jo të partneritetit strategjik, që mundëson fqinjësi të mirë, bashkëpunim për përfitim reciprok dhe përparim të shpejtë e të qëndrueshëm marrëdhëniesh. Bëhet fjalë për Traktatin e Miqësisë dhe Bashkëpunimit midis dy vendeve, i vitit 1996. Sipas praktikës juridike ndërkombëtare, ky akt nulizon për të dyja palët të gjitha aktet e mëparshme që bien ndesh me dispozitat veç e veç dhe frymën në tërësi të tij. Pra, përbën një dysheme të fortë për një start të ri në marrëdhëniet midis dy vendeve në frymën e Evropës së Bashkuar, e cila në emër të së ardhmes kapërceu probleme shumë më të rënda se sa ato që mbahen gjallë në Shqipëri apo Greqi. Kjo do

të thotë se vetëm mungesa e vullnetit politik, që vitet e fundit ka ndodhur shpesh, mund të çojë në anashkalimin e këtij Traktati dhe të pengohet qoftë edhe për pak përparimi i marrëdhënieve midis dy vendeve. Një analizë pak më e kujdesshme tregon se, as marrëdhëniet midis popujve, (njerëzore, shoqërore kulturore apo edhe ekonomike), as politika zyrtare në përgjithësi e as marrëdhëniet historike nuk janë bërë penguese në marrëdhëniet e Shqipërisë dhe Greqisë. Në fakt ekziston një kategori tjetër, e identifikuar me qarqet nacionaliste që rimbartin në aktualitetin e ditës vetëm disa anë negative të së kaluarës në marrëdhëniet midis dy vendeve, sidomos ato të fundit të shekullit XIX dhe fillim shekullit të XX. Kjo vlen për të dy vendet. Në periudhën e Shqipërisë komuniste uniteti i brendshëm rreth partisë dhe udhëheqësit, kishte si parim etnocentrizmin shqiptar në ballafaqim me armiqtë e jashtëm. Kjo teori e praktikë u mbart sot nga këto qarqe, të cilat mundohen të mbajnë pozitat e tyre në shoqëri duke e shitur atë si atdhetarizëm, shqiptarizëm, nacionalizëm etj.. Mirëpo ajo që përbën fatkeqësi për marrëdhëniet midis dy vendeve është se zinxhiri “i armiqtë” të djeshëm të Shqipërisë komuniste, mbeti sot me një hallkë të vetme që është Greqia, (të gjitha fuqitë e mëdha imperialiste, SHBA-ja, Anglia, Gjermania, Italia, Rusia etj., janë kthyer në miq normalë të Shqipërisë, ndërsa Serbia në konceptin e tyre u mund). Fatkeqësisht, këto qarqe, në raport me Greqinë mundohen të aktualizojnë armiqtë etnike, të cilat u ushqyen nga interesat e Fuqive të Mëdha dhe sidomos nga Perandoria Otomane gjatë formimit të shtetit shqiptar, armiqtë të cilat i kishte ngritur në sistem regjimi komunist. Fatkeqësisht për popullin shqiptar, këto qarqe, në të cilat bëjnë pjesë dhe intelektualë, media apo dhe politikanë, i fshehin atij një të vërtetë të madhe: Që historia u ka rezervuar dy popujve një bashkëjetesë paqësore, mirëkuptim dhe integrim të ndërsjellë. Profesor Çabej na thotë se Perandoria Otomane çoi në ekstrem shtrirjen gjeografike të shqiptarëve, sidomos në kontaktet me popullin grek. Por në këto lëvizje centrifugale, sipas Çabejt; vihet re se ajo që ndodhi midis Greqisë dhe Romës në lashtësi, ndodhi me grekët e shqiptarët në periudhat e mësipërme. Kadareja thotë se ia dedikon afinitetit dhe bashkëjetesës me Greqinë madhështinë e artit të tij. Libri i fundit i Mustafa Nanos nuk evidenton ndarjen midis Veriut dhe Jugut të Shqipërisë, siç mund ta akuzojnë, por pa dashje vë në dukje ndikimin e madh të Greqisë në mentalitetin dhe strukturën shoqërore të shqiptarëve të Jugut. Të gjithë bëjnë sikur harrojnë që për shkak të këtyre lidhjeve të ngushta midis shqiptarëve dhe grekëve, duke filluar nga mesi i shekullit të XIX e deri në fillimet e shekullit të XX, shqiptarët më të shquar në lëvizjen kombëtare, përfshirë edhe Ismail Qemalin, ishin fillimisht pro krijimit të një shteti konfederativ midis grekëve e shqiptarëve. Në Greqi nuk harrohen mijërat e shqiptarëve që kontribuuan për lirinë e popullit grek se e konsideronin edhe liri të tyre. Natalie Clayer nënvizon se nacionalizmi shqiptar u formësua, “në lidhje të ngushtë me zhvillimin e helenizmit duke u bashkuar me të ose si reagim ndaj tij”. Kjo ndodhte për shkak se dy popujt tanë jetonin që atëherë sipas parimeve që Evropa i zbuloi dhe i zbatoi të paktën një shekull më vonë. Pra në këtë realitet të gjatë, të gjallë historik e kaq pozitiv në marrëdhëniet midis dy popujve tanë, qarqet e caktuara dhe për interesa të caktuara, nuk kanë vend. Realiteti i tanishëm evropian i ka përjashtuar me kohë. Ata duhet të harrojnë se është tjetër gjë historia objektive dhe tjetër gjë abuzimi historik, ashtu siç është tjetër gjë realiteti historik dhe tjetër gjë realiteti aktual dhe perspektiva. Aq më keq nuk kanë vend “agjentët” e vegjël të dyanshëm që kërkojnë rol pengues në marrëdhëniet midis dy vendeve dhe në realitetin aspirues të Shqipërisë drejt Evropës. Nga ana tjetër, Greqia edhe pse në shifra është e dyta në rolin e saj në Shqipëri, në fakt, po të nisemi nga volumi dhe esenca e marrëdhënieve njerëzore, është, ashtu si në histori, e para. Realiteti i 700 mijë shqiptarëve në Greqi imponon marrëdhënie të mira dhe shumë të mira mes dy vendeve. Ashtu si të drejtat e minoritetit etnik grek në Shqipëri respektohen edhe

zbatohen më mirë në një kuadër marrëdhëniesh shumë të mira. Është kjo arsyeja që vet ky minoritet, por edhe nën ndikimin e Greqisë, ka investuar kaq shumë që Shqipëria të integrohet në BE dhe në organizma të tjerë Evropian. Praktikisht qarqe nacionaliste në Shqipëri i kanë bërë dëm të madh praktik vendit. P.sh në emër gjoja të fitimit të korridorit 8, d.m.th, Lindje-Perëndim, që për ta, Greqia ia kishte rrëmbyer Shqipërisë, penguan investimin evropian të korridorit 10 (kur bëhej në Shqipëri kjo propagandë, Greqia e kishte mbaruar korridorin 8) Shqipëria dhe Greqia në marrëdhëniet midis tyre nuk kanë pse të pengojnë vetveten. Bashkëpunimi rajonal në lidhje me TAP, tregon se nacionalizmi i sëmurë dhe i vjetruar nuk ndihmon askënd. Në këtë kuptim, një përfitim akoma më i madh reciprok, në aspektin ekonomik dhe zhvillimor, siguron zbatimi i marrëveshjes detare në detin Jon, apo dhe marrëveshjeve të tjera të një rëndësie strategjike. Pra, kjo do të thotë se historia dhe realiteti në marrëdhëniet midis dy vendeve, kuadri ligjor dhe perspektiva e përbashkët evropiane i imponojnë politikës dhe qeverive marrëdhënie fqinjësore miqësore e të qëndrueshme dhe bashkëpunim në interes reciprok. Vullneti politik duhet t'i imponohet paragjyqimit të qarqeve nacionaliste dhe jo të kthehet në peng i vullnetit të tyre anakronik e antihistorik dhe në thelb antikombëtar.

## **Nga Panajot Barka/publicist**

<http://shekulli.com.al/33869/>

<https://telegrafi.com/nje-mik-i-shqiperise-ne-tirane/>

### **Një mik i Shqipërisë në Tiranë**

03.11.2013

Karolos Papulias, në një akoma vizitë zyrtare në Shqipëri, në vizitën e dytë në postin e lartë të Presidentit të Republikës së Greqisë. Ajo që duhet thënë që në fillim është se Karolos Papulias do të shënohet në historinë e marrëdhënieve midis dy vendeve si arkitekt i tyre në gjysmë shekullin e fundit, pavarësisht nga fakti se kush është në krye të qeverive në Tiranë apo në Athinë. Papulias është politikani grek, i cili jo vetëm theu klishetë e një politike të mbërthyer në recetat e nacionalizmit të vjetër grek dhe bunkerizimit komunist shqiptar, por edhe politikani që hartoi një strategji të re për këto marrëdhënie, strategji e cila mbarnte realitetin e marrëdhënieve midis dy popujve tanë, si dhe frymën e perspektivës evropiane. Në këtë ndërmarrje prej me se 30 vjeçare Papuliasin e ndihmoi ndoshta origjina e tij epirotase, që e lejonte të njihte pozitivisht realitetin dhe aspiratën e të dy popujve, por edhe kultura e tij perëndimore. Papulias ishte i pari politikan grek që në mesin e viteve '80 e kuptoi nevojën imediate të Tiranës komuniste për hapje drejt perëndimit pas izolimit total dhe varfërisë së skajshme të popullit shqiptar dhe më 1985, nga posti i ministrit të Jashtëm grek në qeverinë e Andrea Papandreu, hapi dyert e ndryshkura të Kakavijës, për të realizuar takimin e parë të lirë midis dy popujve pas Luftës së Dytë Botërore. Ishte po ky politikan, i cili pati guximin të shkelte mbi reaksionin e skajshëm të ekstremit nacionalist grek dhe më 1987, kur po si ministër i Jashtëm, ka meritën në firmën e Kryeministrit grek A.Papandreu në abrogimin e Ligjit të Luftës, si aktin e fundit juridik nga pala greke që i jepte fund një realiteti inekzistent midis dy vendeve. Këtij politikani i takon në fakt merita e hartimit dhe përpunimit të kolonave të marrëdhënieve politike midis dy vendeve, sidomos në realitetet e reja të krijuara pas viteve 90', me mijërat e emigrantëve shqiptarë në Greqi, marrëdhëniet e Tiranës me Athinën në raport me minoritetin etnik grek në Shqipëri, marrëdhëniet e Shqipërisë me fqinjët e organizmat ndërkombëtare dhe roli i Greqisë, ku spikati këmbëngulja e tij që Greqia të ishte përkrahësi permanent i Shqipërisë në integrimin e saj në strukturat Evropiane duke filluar me OSBE-në, Këshillin e Evropës etj.. Po ashtu, misionet e Karolos Papulias në Shqipëri u përkasin gjithmonë momenteve kur marrëdhëniet midis vendeve hynin në zgrip e krizë të thellë dhe ai si arkitekt i prosperitetit të tyre vinte për t'i nxjerrë ato nga bataku. Kujtojmë se ai ishte në Tiranë në nëntorin 1993, kur Shqipëria dhe Greqia kishin kaluar një verë nga më të nxehtat në historinë e tyre dhe hoqi, qoftë edhe përkohësisht, ato re të zeza (dëbimi nga Gjirokastra i arkimandritit Krisostom, mbyllja me dhunë e shkollave greke në Sarandë Gjirokastër e Delvinë, gjashtë kushtet e Micotaqisit etj.). Papulias nuk u tërhoq nga këmbëngulja e tij për të mënjanuar pasojat e krizës 94-96 midis dy vendeve. (Ngjarja e Peshkëpisë, arrestimi dhe gjyqi i të pestëve të OMONIA-s, të drejtat e minoritetit etnik grek në arsim dhe në marrëdhëniet në përgjithësi me shtetin shqiptar). Kësaj here ai ishte frymëzuesi i strategjinë së re në marrëdhëniet me Shqipërinë të sanksionuara në Traktatin e Miqësisë dhe Bashkëpunimit midis dy vendeve nënshkruar në Tiranë më 1996 midis dy presidenteve të atëhershme të Republikës. Presidenti grek Karolos Papulias vizitoi Shqipërinë edhe më 2005. Kësaj herë bëhet fjalë për një vizitë në Jug të Shqipërisë. Kjo vizitë ishte më së shumti një tregues i nevojës për çlirimin e marrëdhënieve midis dy vendeve nga zyrtarizmat e tepruara dhe zhvillimin e tyre në një frymë të thjeshtuar e pa protokoll, ashtu siç e kërkon realiteti i fqinjësisë së mirë.

Por, kjo vizitë dhe me këtë mesazh, fatkeqësisht u shndërrua në një incident diplomatik. Papulias, ky politikan i butë dhe mik i popullit shqiptar, tregoi se nuk mund të komportonte incidente provokuese jashtë qëllimeve të fqinjësisë së mirë dhe se mirësia e tij nuk mund të përdorej nga askush. Tani është serish në Tiranë. Në një vizitë që deri para ardhjes së tij kaloi çuditërisht pa zhurmë nga mediat në Shqipëri. Ndoshta mendohet se Papulias bën një vizitë me shumë kortezie dhe nostalgjie në Shqipëri se sa një vizitë të një politikani të lartë të vendit fqinj. Por vizita e Pauliasit e ka sërish të njëjtin sens si deri më sot. Ai vjen në Shqipëri kur Tirana zyrtare ka adresuar drejt Athinës rreth shtatë çështje të historisë dhe të realitetit në marrëdhëniet midis dy vendeve, të parapara si kushte ndaj Athinës. Pra, vizita realizohet kur ndjesia e Tiranës në marrëdhëniet me Greqinë mbetet e mbërthyer në konceptin e menaxhimit të krizave, kur përherë e me shumë po artikulohe në publik nevoja e rishikimit të historisë, kur në këtë valle po hyn se fundi edhe Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Presidenti i Republikës Greke Karolos Papulias, vjen në Tiranë me të njëjtin koncept strategjik për marrëdhëniet me Shqipërinë, atë të fqinjësisë së mirë, të bashkëpunimit e të mirëkuptimit në kuadrin e rrugës evropiane të Shqipërisë. Kjo do të thotë se nuk do të jetë aspak një vizitë honorifike e bërë nga një figurë honorifike. Do të flasë si mik i mirë e i provuar në një kohë të gjatë historike. Vizita e tij, është mesazhi i Athinës, në nivel presidencial, për këtë lloj marrëdhëniesh midis dy vendeve që Athina aspiron dhe që i duhet edhe Shqipërisë.



**Nga Dr. Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/34350/>

## **Keqkuptimet që cënojnë paqen shqiptaro-greke**

**10.11.2013**

Postvizita e Presidentit grek në Shqipëri bën të prekshme ndjesinë e boshllëkut, si për Athinë, ashtu edhe për Tiranë. Për të dyja palët kjo lidhet me personalitetin dhe figurën e Karolos Paulias. Në Athinë nuk e fshehin se shpresa e para vizitës për hapjen e një kapitulli të ri për marrëdhëniet shumë të mira me Shqipërinë nuk u justifikua.

Athina dhe vetë Papulias, si autoriteti politik grek më i besuar në Shqipëri, i sanksionuar si mik i shqiptarëve, synuan demonstrimin e këmbënguljes së palës greke për marrëdhënie të mira me Shqipërinë. Në projektin e Presidentit grek, ky synim piketohej në katër pika: -Minoriteti etnik grek në Shqipëri, emigrantët shqiptarë në Greqi, bashkëpunimi ekonomik shumëplanësh në nivel bilateral e rajonal dhe mbështetja e Shqipërisë në rrugën e saj drejt BE-së. Për palën shqiptare vizita pati një përthyerje midis asaj që përfaqëson Papulias për shqiptarët e për marrëdhëniet midis dy vendeve dhe artikullimit “të kushteve” ndaj Athinës. E tregoi këtë edhe dyplanëshi i vizitës së Papulias në Tiranë e Gjirokastrë. Në Gjirokastrë, marrëdhëniet midis dy vendeve reflektuan sinjifikativën e linjës, nga unaza e nënës së Papulias fëmijë në këmbim të misrit në Gjirokastrën e para luftës, me titullin “Qytetar Nderi” i qytetit të ngurtë sot. Në Tiranë u bë sundues ngërçi që shkaktuan 7-8 problemet e artikuluar nga politika zyrtare e jo zyrtare e Shqipërisë, e që tingëlluan si kushte ndaj Athinës.

Mbi problemet e njohura si “Ligji i Luftës”, “Problemi Çam” “Çështja e varrezave të ushtarëve grekë të rënë në Luftën italo-greke”, u shtuan të reja si “Shkollat dhe sigurimet për emigrantët shqiptarë në Greqi”, “Marrëveshja e kufirit detar”, “kufiri tokësor” “Toponimet”, “Njohja e Kosovës” etj.. Mënyra se si e nga u shtruan ato, pavarësisht nga sa të drejta apo jo janë, në përgjithësi krijuan ndjesinë sikur po zënë ndën vete dëshirën dhe vullnetin e deklaruar për marrëdhënie të mira midis dy vendeve fqinje. Treguan se faktorët politikëbërës në Shqipëri nuk janë fort të qartë në qëllimet e tyre. Nisen nga perspektiva evropiane e marrëdhënieve midis dy vendeve, apo nga ajo për të kënaqur e mbajtur gjallë një nacionalizëm të tejshkuar!? Në këtë shkrim po bëj një përpjekje për t’i lexuar ndryshe, në favor të mirëkuptimit e mirëbesimit reciprok faktet historike të disa prej këtyre problemeve-kushte.

Pretendimi i mbajtjes në fuqi të Ligjit të Luftës nga pala greke Analiza dhe ballafaqimi me gjakftohtësi i fakteve, tregon se, në aspektin juridik, është pala shqiptare që nuk ka abroguar ligjin e saj të Luftës të 15 qershorit 1940, të aprovuar nga organi i vet legjislativ i asaj kohe, pavarësisht se funksiononte si pjesë e Mbretërisë së Bashkuar me Italinë. Referimet se këtë akt e ka abroguar sistemi komunist nëpërmjet Kongresit të Përmetit më 1944, apo me një “ligj” të vitit 1945, nuk kanë vlerë juridike se ato ishin organe politike dhe jo legjislative. Nga ana tjetër, këto vendime politike komuniste janë abroguar me dekrete presidenciale të aprovuara në parlamentin shqiptar të 1992-shit.

**Në palën greke:** Dekreti mbretëror nr. 2623, dt. 10 nëntor 1940, ishte akti juridik që ligjëronte gjendjen e luftës që Greqisë ia kishte imponuar Mbretëria e Bashkuar italo-shqiptare. Dekreti, në kushtet e mosfunksionimit të parlamentit grek, mbante firmat e mbretit dhe të kryeministrit dhe nuk u aprovua kurrë nga parlamenti grek. Po me dekret dhe jo me ligj parlamentar, ky “ligj”, u risoll në fuqi më 1944, pas abrogimit që i kishte bërë qeveria kuislinge e Tsollakoglu-s më 1941. Në kushtet e ndryshimit politik të Greqisë, ku institucioni i mbretit u mënjanua, firma e kryeministrit grek më 1987 është e mjaftueshme për ta konsideruar Ligjin e Luftës të pavlefshëm. Nga ana tjetër, ky dekret kishte si objekt “gjendje lufte” Mbretërinë e Bashkuar italo-shqiptare. Ky realitet

politik, qoftë edhe si i imponuar popullit shqiptar, u shpërbë me kapitullimin e Italisë Fashiste më 1943. Kjo do të thotë se objekti faktik, të cilit i adresohet dekreti mbretëror i Greqisë për Gjendjen e Luftës nuk ekziston që më 1943. Pra që nga ky moment është i pavlefshëm.

Me të njëjtin argumentim bie edhe fuqia e ligjit të Luftës së legjislativit fashist shqiptar të 15/06/1940. Po ashtu, me dekretin 432/22-10-1947, Greqia ratifikoi Traktatin e Paqes me Italinë. Ky dokument përbën bazën juridike praktike që midis Italisë dhe Greqisë, kapitulli i Luftës së Dytë Botërore të quhet i mbyllur njëherë e mirë dhe të dy shtetet të jenë aleatë në një sërë strukturash, si ato euroatlantike. Për analogji, sipas logjikës shqiptare, që e trajton si në fuqi Ligjin e Luftës të palës greke, duhet që edhe Italia të mbajë të njëjtin qëndrim, pasi ligji grek i Luftës i adresohet njëkohësisht Mbretërisë së Bashkuar italo-shqiptare, gjë që tingëllon absurde. Kjo do të thotë se Shqipëria mund ta kishte këtë pretendim maksimalisht deri më 1996-ën, kur edhe ajo nënshkroi me Greqinë Traktatin e Miqësisë. Fakti që ky Traktat, si akt juridik suprem në marrëdhëniet midis dy vendeve nulizon e shfuqizon automatikisht të gjitha aktet e mëparshme që bien ndesh me të, e bën krejt pa sens deklarin e Presidentit Nishani, se ““Ligji i Luftës i Greqisë” bie ndesh me këtë Traktat dhe për këtë duhet abroguar”.

Atëherë i bie që edhe Greqia të ketë pretendime të njëjta ndaj Shqipërisë dhe Italisë dhe Italia ndaj Greqisë (!!!) Do të ishte pa vlerë që t'i referoheshim këtu anëtarësimin të përbashkët në NATO, realitetit diplomatik dhe bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve, në kuadër të të cilave Greqia është partneri i dytë i Shqipërisë, apo edhe ekzistenca në Greqi e më shumë se gjysmë milioni shqiptarësh, për të thënë se sa i paqenë është pretendimi i mbajtur kaq gjatë në këmbë për gjendjen e luftës midis dy vendeve dhe sa dëm u sjell ky lajm i rremë e propagandistik marrëdhënies midis dy vendeve.

Propagandistik dhe i dëmshëm mbetet dhe abuzimi i lidhjes së këtij “ligji” (inexzistent) me sekuestron mbi pronat e çamëve. Në Greqi, në bazë të këtij ligji, u ndërmorën akte të tjera juridike që vendosnin sekuestro konservative mbi pronat e qytetarëve të vendeve armike të Greqisë. Çamët në atë periudhë, ishin nënshjetas grekë. Pra, nga ana juridike dhe logjike, nuk kanë asnjë lidhje me njëra-tjetrën. Është tjetër gjë, nëse në Greqi ka vendime gjyqësore për penaltete lufte ose jo, në bazë të të cilave janë sekuestruar prona qytetarësh grekë. Kjo do të thotë se adresimi politik zyrtar i problemit të pasurive të ish-nënshjetasve grekë në Shqipëri (pas 1955-s shteti shqiptar ua hoqi këtë cilësi), si kusht për marrëdhëniet të mira midis dy vendeve, përbën një handikap, një pengesë pa argument juridik, një përpjekje për përfitime të tjera dhe mënyrën më të keqe për qytetarët e kësaj kategorie që nuk kanë asnjë pengesë ligjore apo gjyqësore për të fituar të drejtat e tyre pasurore në Greqi.

#### **Përse Luftën italo-greke nuk e shohim si një provë farkëtimi të miqësisë?**

Në aspektin historiko-politikoushtarak, sipas Mëkëmbësit të Mbretit Italian në Shqipëri, Jacomonit, sulmi ndaj Greqisë më 28.10.1940, filloi me pretekstin se Greqia kishte krijuar lehtësi tokësore e detare për ushtritë britanike, kishte vazhduar politikën provokuese kundër popullsisë së Çamërisë, si dhe kishte shkaktuar pështjellime në kufirin e saj me Mbretërinë italo-shqiptare. Në aspektin e brendshëm shqiptar, lufta, sipas premtimeve italiane dhe kryeministrit kuisling Vërlaci, bëhej për zgjerimin e kufijve të Mbretërisë me aneksimin e Çamërisë dhe të Epirit Jugor. Kjo ishte arsyeja që sipas Jacomonit (“Politika”, fq 276,280-281) të rreshtohen përkrah ushtrisë italiane dhe 19.039 trupa shqiptare, nga të cilët 3114 dezertuan që në momentin e parë të ballafaqimit luftarak. Sipas akteve zyrtare shqiptare të kohës (Fletorja Zyrtare 28 tetor 1940), në të gjitha prefekturat e Jugut të Shqipërisë duke filluar me Tiranën, u deklarua gjendja e luftës. Mirëpo, fitorja e Greqisë mbi Italinë, ishte fitorja e parë e popujve mbi

makinën më të egër luftarake të kohës, që jo vetëm ngjalli shpresën e popujve të shtypur, por edhe krijoi premisa që aleatët, sidomos ish Bashkimi Sovjetik, të fitonin kohë në përgatitjet luftarake ndaj Gjermanisë naziste.

E gjithë arena e luftimeve fitimtare të ushtrisë së popullit grek mbi Italinë fashiste, pra i fitores së parë të popujve të botës mbi fashizmin, u zhvilluan në territorin e Shqipërisë së Jugut. Faktori ‘popull shqiptar’ u bë realisht faktori i parë ndihmës për këtë fitore. I dha ushtrisë greke ndihmë ushqimore e mjekësore, veshmbathje, strehë, mbështetje transportuese, rikonjiciuese etj., dhe krijoi me strukturat e ushtrisë greke një marrëdhënie shumë miqësore e vëllazërore që ruhet gjallë ende edhe sot. (Kjo nuk ndodhi me ushtrinë italiane). Po përse atëherë në literaturën shqiptare, në qëndrime të pashprehura hapur politikisht, ushtria greke në këtë luftë fitimtare të popujve konsiderohet pushtuese dhe jo çlirimtare nga pushtuesit fashistë? Nëse do të pranohet koncepti “i pushtuesit” për grekët, atëherë kjo jo vetëm bie ndesh me realitetin dhe vullnetin e popullit shqiptar, por çon në mënyrë të drejtpërdrejtë ujë, në favor të argumentit se Shqipëria i shpalli luftë Greqisë.

Përse, pra të mos e kthejmë në politikë zyrtare vendimin e popullit shqiptar të asaj kohe, që është aq domethënës për marrëdhëniet e mira midis dy popujve dhe të mbetemi peng i qëndrimeve kuislinge të luftës italo-greke!?

#### **Paqja e heshtur e eshtrave të ushtarëve grekë**

Sipas arkivave të Shtabit të Luftës të Ushtrisë Italiane, kjo ushtri, në respekt të rregullave të luftës, pas tërheqjes së ushtrisë greke nga fronti italo-grek në Shqipëri, grumbulloi dhe sistemoi pranë të vvarëve të ushtrisë italiane 6 300 trupa greke, duke shënuar mbi to “Armiq lufte në jetë, në paqe në vdekje”. Populli shqiptar ruajti me fanatizëm varret e ushtarëve grekë edhe pas tërheqjes së atyre italianë, sa që më 1981, qeveria shqiptare i transmetonte qeverisë greke se kishte identifikuar rreth 5 900 varre ushtarësh grekë. Sot, sipas konventës së Hagës, për ushtarët e rënë në luftë në toka të huaja, Greqia me marrëveshje me shtetin shqiptar, nuk ka preferuar t’i tërheqë në tokën e vet siç ka bërë, ta zëmë Italia, por kërkon të ndërtojë në kujtim të tyre dy varreza ushtarake, ashtu siç kanë bërë edhe shumë vende të tjera (Britania, Gjermania, Franca); dhe me procedura rigorozë ushtarake dypalëshe, të rigjejë varet e tyre dhe t’i sistemojë që të prehen në paqe. Në Shqipëri varret e ushtrive të tjera të huaja nderohen shpesh dhe nga autoritetet me të larta shtetërore. Dhe shumë mirë bëjnë. Por përse gjithë kjo armiqësi ndaj paqes së ushtarëve grekë të rënë në një luftë që nderon edhe popullin shqiptar?!

Kësaj paqeje i shkaktohen plagë me reciprocitete të paqena. Për konsum të brendshëm dhe në mënyrë amatoreske, shpesh kërkohen reciprokisht varreza shqiptarësh në Greqi. Ajo që duhet thënë është se në këtë luftë nuk ka asnjë ushtar shqiptar të vvarë në tokën greke. (për ironi të fatit ka vetëm një të plagosur) Por përse atëherë bëhet gjithë kjo potere në Shqipëri në kërkim të një reciprociteti të paqenë!?! Duke nisur nga parimi se historia asnjëherë nuk kthehet prapa, por shkon përpara, duke marrë për bazë se si popujt e tjerë evropianë ngritën marrëdhënie shtetërore pa kufij, duke gjetur edhe në armiqësitë shekullore midis tyre gjërat që i bashkojnë, ne nuk kemi pse të harxhojmë kaq shumë energji për t’u krijuar vështirësi oportuniteteve evropiane që kemi përpara dhe që na imponojnë marrëdhëniet shekullore midis dy popujve. Ne duhet t’i shërbejmë vullnetit të popujve dhe jo strukturave që nuk interesohen për ta. Sipas Kazantzakis, “të përpiqemi të shkojmë atje ku nuk mundemi” dhe jo të shkatërrojmë dhe ato që kanë mundur t’i arrijnë paraardhësit tanë.

Απάντηση σε όρους που τα Τίρανα βάζουν σε Αθήνα για ανάπτυξη καλών σχέσεων

Η περίοδος μετά την επίσκεψη του Έλληνα Προέδρου στην Αλβανία δίνει ανάγλυφο το αίσθημα του κενού, τόσο για την Αθήνα όσο και για τα Τίρανα. Στην Αθήνα δεν κρύβουν ότι οι ελπίδες πριν από την επίσκεψη για το άνοιγμα νέου κεφαλαίου για πολύ καλές σχέσεις με την Αλβανία, δεν δικαιολογήθηκαν. Η Αθήνα και ο ίδιος ο Παπούλιας, επιδίωξαν την εκδήλωση επιμονής για καλές σχέσεις με την Αλβανία. Στην ατζέντα του Έλληνα Προέδρου η συγκεκριμένη επιδίωξη διατυπώνονταν σε τέσσερα σημεία:- Η εθνική ελληνική μειονότητα στην Αλβανία, η Αλβανοί μετανάστες στην Ελλάδα, η πολύπλευρή οικονομική συνεργασία σε διμερές και στην ευρύτερη περιοχή επίπεδο και στήριξη της Αλβανίας στην πορεία της προς την Ευρωπαϊκή Ένωση.

Στα Τίρανα έγινε κυρίαρχη η εκούσια σύσπαση που προκάλεσαν τα 7-8 θέματα αρθρωμένα από την επίσημη και ανεπίσημη πολιτική της Αλβανίας και που απήχησαν ως όροι προς Αθήνα. Στα γνωστά θέματα όπως «Το εμπόλεμο», «Το τσάμικο», «Τα νεκροταφεία των ελλήνων στρατιωτών στον Ελληνο-Ιταλικό Πόλεμο», προστέθηκαν νέα όπως, «Τα σχολεία και τα ασφαλιστικά των Αλβανών μεταναστών στην Ελλάδα», «Η ΑΟΖ», «Τα χερσαία σύνορα», «Τα τοπωνύμια», «Η αναγνώριση του Κοσσυφοπεδίου» κλπ. Ο τρόπος πώς και από ποιους τέθηκαν, ανεξαρτήτως πόσο δίκαια ή άδικα είναι, προκάλεσε γενικώς την αίσθηση ότι καταπλακώνουν την δηλωμένη επιθυμία και βούληση για καλές σχέσεις μεταξύ των δύο γειτονικών χωρών. Έδειξαν ότι οι παράγοντες που παράγουν πολιτική στην Αλβανία δεν είναι αρκετά ξεκάθαροι στους στόχους τους. Ξεκινούν από την ευρωπαϊκή προοπτική των σχέσεων μεταξύ των δύο χωρών, ή για να ικανοποιήσουν και να κρατήσουν ζωντανό έναν ξεπερασμένο εθνικισμό.....!??

Στο παρόν άρθρο κάνω μια προσπάθεια για να αναγνωστούν διαφορετικά, σε όφελος της αμοιβαίας κατανόησης και εμπιστοσύνης, τα ιστορικά γεγονότα σε μερικά από προαναφερόμενα θέματα-όρους.

**Ο ισχυρισμός του εμπόλεμου από ελληνικής πλευράς.** Η ανάλυση και η αντιπαραβολή με ψυχραιμία των γεγονότων αποδεικνύει ότι, εκ'νομικής όψεως, είναι η Αλβανική πλευρά που δεν έχει καταργήσει τον νόμο της εμπόλεμου της 15<sup>ης</sup> Ιουνίου 1940, ψηφισμένο από το τότε δικό της νομοθετικό όργανο, ανεξαρτήτως αν λειτουργούσε ως τμήμα του Ενωμένου Ιταλικού Βασιλείου. Οι αναφορές ότι τον νόμο αυτό έχει καταργήσει το κομμουνιστικό καθεστώς μέσω του Συνεδρίου της Πρεμετής το 1944, η με ένα «νόμο» του 1945 δεν έχουν νομική ισχύ διότι πρόκειται για πολιτικά και όχι νομοθετικά όργανα.

Από την άλλη πλευρά οι κομμουνιστικές αυτές πολιτικές αποφάσεις καταργήθηκαν με προεδρικά διατάγματα ψηφισμένα από την αλβανική βουλή του 1992.

**Στην ελληνική πλευρά.** Το βασιλικό διάταγμα αρ. 2623, ημερ. 10 Νοεμβρίου 1940, αποτελούσε νομική πράξη που κατοχύρωνε την εμπόλεμη κατάσταση που είχε επιβληθεί στην Ελλάδα από το Ενωμένο Ιταλο-Αλβανικό Βασίλειο. Το διάταγμα, στις καταστάσεις μη λειτουργίας της Ελληνικής Βουλής, έφερνε τις υπογραφές του Βασιλιά και του Πρωθυπουργού και δεν ψηφίστηκε ποτέ από την Ελληνική Βουλή. Με διάταγμα επίσης και όχι με κοινοβουλευτική πράξη, ο συγκεκριμένος «νόμος» επανήλθε σε ισχύ στην Ελλάδα το 1944 μετά την κατάργηση από την κυβέρνηση δοσίλογων Τσολάκογλου το 1941. Στις συνθήκες αλλαγής του πολιτικού συστήματος

στην Ελλάδα, όπου καταργήθηκε ο θεσμός του βασιλιά, η υπογραφή του Έλληνα Πρωθυπουργού το 1997 είναι αρκετή για να θεωρηθεί άκυρος «ο νόμος εμπόλεμου». Από την άλλη, το βασιλικό διάταγμα «εμπόλεμου» είχε αντικείμενο το Ενωμένο Ιταλο-Αλβανικό Βασίλειο. Η πολιτική αυτή πραγματικότητα, έστω και ως επιβληθείσα στον αλβανικό λαό, καταργήθηκε με την συνθηκολόγηση της φασιστικής Ιταλίας το 1943. Αυτό σημαίνει ότι ο συγκεκριμένος στόχος, δέκτης του οποίου ήταν το βασιλικό διάταγμα της Ελλάδας για εμπόλεμη κατάσταση, δεν ισχύει από το 1943. Λοιπόν, από τη στιγμή αυτή είναι άκυρο. Το ίδιο επιχείρημα καταργεί και την ισχύ του Εμπόλεμου νόμου του Αλβανικού φασιστικού νομοθετικού οργάνου της 15<sup>ης</sup> Ιουνίου 1940.

Επίσης, με το διάταγμα 432/22-10-1947, η Ελλάδα σύναψε το Σύμφωνο Ειρήνης με την Ιταλία. Η συγκεκριμένη πράξη αποτελεί την νομική και πρακτική βάση ώστε ανάμεσα στην Ελλάδα και Ιταλία το κεφάλαιο του 'Β Παγκοσμίου Πολέμου να θεωρείται λήξαν και τα δύο κράτη είναι σύμμαχοι σε μια σειρά ευρω-ατλαντικές δομές. Αναλογικά, κατά την αλβανική λογική, που αντιμετωπίζει σε ισχύ το εμπόλεμο της ελληνικής πλευράς, πρέπει και η Ιταλία να τηρήσει την ίδια στάση, εφόσον ο νόμος εμπόλεμου της Ελλάδας απευθύνονταν ταυτόχρονα κατά του Ενωμένου Ιταλο-Αλβανικού Βασιλείου, πράγμα που θα ακούγονταν παράλογο. Αυτό σημαίνει ότι η Αλβανία μπορεί να διατηρούσε τον ισχυρισμό αυτό στο μέγιστο δυνατό μέχρι το 1996 όταν και αυτή υπέγραψε με την Ελλάδα το Σύμφωνο Φιλίας. Το γεγονός ότι το Σύμφωνο αυτό, ως ανώτερη νομική πράξη στις διμερείς σχέσεις ακυρώνει και καταργεί αυτομάτως όλες τις προηγούμενες πράξεις που αντιτίθενται σ' αυτό, μετατρέπει σε άστοχη τη δήλωση του Προέδρου Νισιάνι ότι «το Ελληνικό Εμπόλεμο» αντιτίθεται στο Σύμφωνο, άρα πρέπει (το εμπόλεμο) να καταργηθεί.

Τότε, αναλογικά, και η Ελλάδα θα πρέπει να έχει παρόμοιους ισχυρισμούς προς Ιταλία και Αλβανία και η Ιταλία προς Ελλάδα.(!) Θα ήταν περιττό να αναφερόμαστε στο γεγονός κοινής συμμετοχής στο NATO, στη διπλωματική πραγματικότητα και οικονομική συνεργασία μεταξύ των δύο χωρών όπου η Ελλάδα είναι ο δεύτερος εταίρος της Αλβανίας, ή στην ύπαρξη στην Ελλάδα περισσότερων του μισού εκατομμυρίου Αλβανών μεταναστών, για να υπογραμμιστεί πόσο ανύπαρκτος είναι ο ισχυρισμός για το εμπόλεμο μεταξύ των δύο χωρών, ισχυρισμός που τόσα χρόνια διατηρήθηκε ζωντανός και πόσο επιβλαβή είναι για τις σχέσεις μεταξύ των δύο χωρών η ψευδή και προπαγανδιστική αυτή είδηση.

**Προπαγανδιστική και επιζήμια είναι και η καταχρηστική σύνδεση του ανύπαρκτου αυτού «νόμου» με την κατάσχεση περιουσιών των Τσάμηδων.** Στην Ελλάδα, βάση του νόμου αυτού, ελήφθησαν μια σειρά από άλλες νομικές ρυθμίσεις που έθεταν σε κατάσχεση τις περιουσίες πολιτών των εχθρικών χωρών της Ελλάδας. Οι Τσάμηδες εκείνη την περίοδο ήταν Έλληνες υπήκοοι. Λοιπόν από νομικής και πρακτικής πλευράς, δεν υπάρχει καμιά σχέση μεταξύ των δύο αντικειμένων. Είναι διαφορετικό θέμα εάν στην Ελλάδα υπάρχουν δικαστικές αποφάσεις για ποινικά αδικήματα σε καιρό πολέμου ή όχι, βάση των οποίων κατασχέθηκαν περιουσίες Ελλήνων πολιτών

Αυτό σημαίνει ότι η αναβάθμιση σε επίσημο πολιτικό θέμα του προβλήματος των περιουσιών των πρώην Ελλήνων υπηκόων στην Αλβανία, (μετά το 1955 το αλβανικό κράτος τους αφαίρεσε την ιδιότητα αυτή), ως όρο για καλές σχέσεις μεταξύ των δύο χωρών αποτελεί μειονέκτημα, ένα εμπόδιο χωρίς νομικό επιχείρημα, προσπάθεια για άλλου είδους ωφελιμότητες και τον χειρότερο τρόπο για τους πολίτες αυτής της κατηγορίας που δεν έχουν νομικό ή δικαστικό κώλυμα για να κερδίσουν τα περιουσιακά δικαιώματά τους στην Ελλάδα.

### **Γιατί δεν προσεγγίζουμε τον Ελληνο-ιταλικό Πόλεμο ως δοκιμασία σφρηλάττησης της φιλίας μεταξύ των δύο λαών?**

Από ιστορική πολιτικο-στρατιωτική πλευρά, σύμφωνα με τον τοποτηρητή του Ιταλού Βασιλιά στην Αλβανία, Jacomoni, η επίθεση κατά της Ελλάδας στις 28.10.1940 άρχισε υπό το πρόσχημα ότι η Ελλάδα είχε παραχωρήσει θαλάσσιες και εδαφικές διευκολύνσεις στα Βρετανικά στρατεύματα, είχε συνεχίσει την προκλητική πολιτική κατά των Τσάμιδων και είχε δημιουργήσει αναταραχές στα σύνορά της με το Ιταλο-Αλβανικό Βασίλειο. Στο αλβανικό εσωτερικό, ο Πόλεμος, σύμφωνα με τις ιταλικές υποσχέσεις και τα λεγόμενα του πρωθυπουργού των δοσίλογων Verlaci, γινότανε για την διεύρυνση των ορίων της Βασιλείας προσαρτώντας από την Ελλάδα την Τσαμουριά και τη Νότια Ήπειρο. Αυτός ήταν ο λόγος ώστε, σύμφωνα με τον Jacomoni ("Politika", fq 276,280-281), να ταχτούν στο πλευρό του ιταλικού στρατού 19.039 Αλβανοί στρατιώτες, από τους οποίους 3114 λιποτάχτησαν από την πρώτη στιγμή πολεμικής αντιπαράθεσης. Σύμφωνα με τα επίσημα Αλβανικά στοιχεία της εποχής (Εφημερίδα της Κυβέρνησης 28.10.1949) όλες οι περιφέρειες του Νότου της Αλβανίας, αρχίζοντας από τα Τίρανα, είχαν κηρυχτεί σε κατάσταση εμπολέμου

Όμως, η νίκη της Ελλάδας επί της Ιταλίας σημείωσε την πρώτη νίκη των λαών επί της πιο άγριας πολεμικής μηχανής της εποχής, η οποία νίκη, όχι μόνο ζωογόνησε την ελπίδα για λευτεριά των κατακτημένων λαών, αλλά δημιούργησε προϋποθέσεις στους συμμάχους, ιδιαίτερα στην πρώην Σοβιετική Ένωση, να επωφελούνταν χρόνο πολεμικής προετοιμασίας κατά της ναζιστικής Γερμανίας.

Το πεδίο όπου διεξήχθησαν οι νικηφόρες μάχες του στρατού του ελληνικού λαού κατά της φασιστικής Ιταλίας, δλδ της πρώτης νίκης των λαών του κόσμου επί του φασισμού, ήταν η Νότια Αλβανία. Ο αλβανικός λαός έγινε πραχτικά ο πρώτος βοηθητικός παράγοντας για την νίκη αυτή. Προσέφερε στον ελληνικό στρατό επισιτιστική και ιατρική βοήθεια, ρουχισμό, στέγη, μεταφορική βοήθεια και αναγνώριση εδάφους κλπ, δημιούργησε με τις δομές του ελληνικού στρατού πολύ καλές αδελφικές και φιλικές σχέσεις, που διατηρούνται ζωντανές μέχρι σήμερα. (Δεν συνέβηκε αυτό με τον Ιταλικό στρατό!!) Όμως, γιατί στην αλβανική βιβλιογραφία, σε ανεκδήλωτες πολιτικές θέσεις, ο ελληνικός στρατός σε αυτόν το νικητήριο πόλεμο των λαών θεωρείται κατακτητής και όχι απελευθερωτής από τους φασίστες κατακτητές;! Σε περίπτωση που αποδεχτούμε την αντίληψη «του κατακτητή» για τους Έλληνες, τότε αυτό όχι μόνο αντιτίθεται στην πραγματικότητα και τη βούληση του αλβανικού λαού, αλλά συμερίζεται άμεσα το επιχείρημα ότι η Αλβανία κήρυξε πόλεμο κατά της Ελλάδας.

Γιατί, λοιπόν να μη μετατρέψουμε σε επίσημη πολιτική την απόφαση του αλβανικού λαού εκείνης της περιόδου η οποία είναι τόσο εύγλωττη σήμερα υπέρ των καλών σχέσεων μεταξύ των δύο λαών και μένουμε όμηροι των θέσεων των δοσίλογων υπέρ του Ελληνο-Ιταλικού Πολέμου. !?

### **Η σιωπηλή ειρήνη των οστών των ελλήνων στρατιωτών.**

Σύμφωνα με τα αρχεία του Πολεμικού Επιτελείου του Ιταλικού Στρατού, ο ιταλικός στρατός, σεβόμενος τους κανόνες πολέμου, μετά την απόσυρση του ελληνικού στρατού από το Ελληνο-Ιταλικό μέτωπο, συγκέντρωσε και ταχτοποίησε δίπλα στους τάφους του ιταλικού στρατού 6300 Έλληνες νεκρούς, σημειώνοντας πάνω τους «Εχθροί στον πόλεμο, εν ειρήνη νεκροί». Ο αλβανικός λαός προστάτησε με φανατισμό τους τάφους των Ελλήνων στρατιωτών και όταν οι Ιταλοί απέσυραν τους νεκρούς τους, τόσο που το 1981, η Αλβανική κυβέρνηση ενημέρωσε την ομόλογη ελληνική ότι είχε εντοπίσει περί των 5900 ταφών ελλήνων στρατιωτών. Σήμερα, βάση της συνθήκης

της Χάγης για τους νεκρούς στρατιώτες σε ξένες χώρες, η Ελλάδα, μετά συμφωνίας με το αλβανικό κράτος δεν προτίμησε να αποσύρει τους νεκρούς στρατιώτες στη χώρα της, όπως έκανε ας υποθέσουμε η Ιταλία, αλλά ζητεί να κατασκευάσει στη μνήμη τους δύο στρατιωτικά νεκροταφεία, όπως άλλωστε έχουν κάνει και πολλές άλλες χώρες, (Βρετανία, Γερμανία, Γαλλία) και με αυστηρές διμερείς στρατιωτικές διαδικασίες να εντοπίσει τους τάφους τους και να τους συστηματοποιήσει ώστε να αναπαυτούν εν ειρήνη.

Στην Αλβανία η τάφοι των άλλων στρατών τιμούνται συχνά από τις ανώτατες αλβανικές αρχές και πολύ καλά κάνουν. Όμως, γιατί όλη αυτή η εχθρότητα προς την ειρήνη των Ελλήνων στρατιωτών που έπεσαν σε έναν πόλεμο που τιμάει και τον Αλβανικό λαό!

**Στην ειρήνη τους προκαλούνται τραύματα με ανύπαρκτες αμοιβαιότητες.** Για εσωτερική κατανάλωση και με ερασιτεχνισμό, συχνά τίθενται αιτήματα αμοιβαιότητας για τάφους Αλβανών στην Ελλάδα. Εκείνο που πρέπει να ειπωθεί είναι ότι στον πόλεμο αυτό δεν υπάρχει κανείς Αλβανός στρατιώτης, που να είχε σκοτωθεί σε ελληνικό έδαφος. (Προς ειρωνεία της τύχης υπάρχει μόνο ένας τραυματίας). Ως προς τι τότε γίνεται όλος αυτός ο θόρυβος στην Αλβανία σε αναζήτηση ανύπαρκτης αμοιβαιότητας.....!;;

Ξεκινώντας από την αρχή ότι η ιστορία ποτέ δεν γυρνάει πίσω, αλλά βαδίζει μόνο προς τα μπρος, λαμβάνοντας υπόψη ότι άλλοι ευρωπαϊκοί λαοί αποκατάστησαν διακρατικές σχέσεις χωρίς σύνορα εντοπίζοντας και στις αιώνες εχθρότητες μεταξύ τους εκείνα που τους ενώνουν, δεν υπάρχει λόγος, ώστε εμείς να καταναλώνουμε τόσες πολλές ενέργειες για να προβάλλουμε εμπόδια στις ευρωπαϊκές ευκαιρίες που διανοίγονται μπροστά μας και επιβάλουν οι αιώνες σχέσεις μεταξύ των δύο λαών μας. Σύμφωνα με τον Καζαντζάκη να προσπαθήσουμε να φθάσουμε εκεί που δεν μπορούμε και όχι να καταστρέψουμε και εκείνα που κατάφεραν να φθάσουν οι προγονοί μας.

Δημοσιεύτηκε στην εφημερίδα SHEKULLI των Τιράνων ημερ 10.11.2013.

## **Nga Panajot Barka/Publicist**

<http://shekulli.com.al/38420/>

### **Marrëdhënie në hulli evropiane**

15.01.2014

“Greqia është një pilot me përvojë në drejtimin e Komisionit të BE-së”, -theksoi në Athinë në ditën e marrjes nga Greqia të Presidencës së radhës së BE-së, Presidenti i këtij Komisioni, Barozo. Ai theksoi gjithashtu se Greqia “është përgatitur shumë mirë për këtë Presidencë dhe e vendosur për të patur sukses”.

Kjo është presidenca e pestë e Greqisë në drejtimin e Komisionit të BE-së. Për të dhe për BE-në ka një simbolikë të veçantë. Greqia merr presidencën në kushtet e kapërcimit të krizës më të thellë të shtetit modern grek. Dhe e kapërcen atë në sajë të integritetit të vet evropian. Njëkohësisht konfirmon plotësisht veten si anëtar i denjë e me kontribute në BE.

BE-ja nga ana e vet, në Presidencën greke sfidon plotësisht hipotezat e një viti më parë, se Unioni dhe monedha e vet e përbashkët janë në krizë të pakthyeshme. Greqia, me sakrificat e popullit grek (i cili pranoi rënien më të rëndë të nivelit të mirëqenies së vet që nga Lufta e Dytë Botërore), tregoi se është një popull e një shtet me vlera evropiane, me demokraci funksionale dhe aftësi për t’ia dalë çdo sfidë që vë në rrezik vendin dhe të ardhmen e tij. Logoja greke për këtë presidencë është:

“Evropa është aspirata jonë e përbashkët”. Me këtë logo Athina nuk shpreh thjesht aspiratën e vet në rrugën evropiane, kaq shumë të diskutuar kohët e fundit nga brenda e nga jashtë vendit, por shpreh edhe bindjen e saj se një BE e fortë ekonomikisht e politikisht, me solidaritet të pakushtëzuar midis shteteve të saj, përbën garanci për të ardhmen e popujve të BE-së dhe njëkohësisht, një ndihmesë e garanci për popujt e tjerë evropianë përreth saj, si edhe për stabilitetin, paqen e përparimin në mbarë botën.

Pavarësisht se kalimi rotativ i presidencës evropiane është i shkurtër dhe ushtrohet brenda politikës së përhershme të Komisionit Evropian, secili shtet në kryesimin e vet, kërkon të japë individualitetin e tij, që i jep BE-së atë larmi konkurruese dhe shpërfillëse të rutinës dhe ngërçit.

Në këtë këndvështrim, në paketën drejtuese të Greqisë bën përshtypje synimi i Presidencës greke për nxitje të kontakteve pozitive të qytetarit evropian me institucionin e Bashkimit Evropian, domethënia e të cilit është esenciale, pasi synon në nxitjen e pjesëmarrjes aktive të qytetarit evropian në proceset drejtuese, vendimmarrëse e integruese të vet BE-së; e që në fund të fundit lidhen me thellimin e demokracisë reale në shtetin e aspiruar multietnik evropian, pa të cilën ai do të jetë i pamundur.

Ndër objektivat e tjera të Presidencës së saj, Greqia vë theksin edhe në administrimin e përgjithshëm të problemit të emigrimit të paligjshëm, të zhvillimit të politikave detare dhe bashkë me fuqizimin e përgjithshëm të Unionit edhe zgjerimin e tij.

Në lidhje me këtë të fundit Barozo tha se: “zgjerimi viteve të fundit të Unionit lidhet sërish me drejtimin e presidencës nga Greqia”, - dhe kujtoi për këtë takim të Selanikut të vitit 2003, takim i cili përcaktoi edhe strategjinë e re për zgjerimin me 15 shtete të reja në drejtim të Lindjes e Perëndimit evropian.

Në këtë këndvështrim të politikës evropiane të Greqisë në krye të BE-së duket se gjen veten edhe politika zyrtare e Tiranës. Përsa i përket aspiratës së popullit shqiptar për anëtarësim në BE, me hap konkret, fitimin e statusit të vendit kandidat, Tirana e ka garancinë e plotë të Greqisë për mbështetje maksimale. Mesa duket qershori do të



kurorëzgjë një inkursion të gjatë mbështetës të Greqisë për rrugën evropiane të Shqipërisë.

Kujtojmë se pavarësisht nga ulje-ngritjet në marrëdhëniet midis dy vendeve, Greqia në asnjë moment nuk iu referua problematikës negative në qëndrimet e veta evropiane ndaj Shqipërisë. Madje ajo, e bindur se rruga e përbashkët euroatlantike do të ndihmojë edhe në zgjidhjen dhe sheshimin e çdo problemi tjetër midis dy vendeve, u bë mbështetësi kryesor i aspiratave evropiane të shqiptarëve.

Kujtojmë qëndrimin e Greqisë për anëtarësimin e Shqipërisë në KSBE (sot OSBE), pa rrenë akoma mirë sistemi komunist, kujtojmë përpjekjet e Greqisë për anëtarësimin e Shqipërisë në Këshillin e Evropës, edhe pse Greqia kishte probleme thelbësore në lidhje me të drejtat e minoritetit etnik grek në Shqipëri. Po ashtu pa rezervë që përkrahja e Greqisë për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO etj..

Pra Greqia, në këtë drejtim, ishte dhe është jo thjesht një partner i deklaruar i Shqipërisë, por edhe një punëtor i palodhur për arritjen e aspiratës evropiane të Shqipërisë. Në këtë qëndrim Greqia kishte edhe mirëkuptimin e plotë të minoritetit etnik grek në Shqipëri, i cili, me një emancipim politik të admirueshëm, asnjëherë nuk vuri respektimin e të drejtave të tij, para integritetit Euroatlantik të Shqipërisë.

Kjo politikë e Greqisë ndaj Shqipërisë nuk përbën thjesht një unifikim të qëndrimeve të veta me atë të BE-së, por është mishërim i një tradite të lashtë, që lidhet me misionin ekumenik civilizues të Greqisë si shprehje e ekzistencës së vet.

“Pa kontributin civilizues të Greqisë nuk do kishte civilizim të sotëm evropian”, tha Barozo në Athinë. Në kohët moderne Greqia alternoi ekumenizmin e vet tradicional, ose Helenizmin ekumenik, siç quhet ndryshe, me shtetin helen.

Marrëdhëniet shekullore midis shqiptarëve e grekëve u përcaktuan pikërisht nga këto raporte e që kulmuan në shekullin e 19-të me përpjekjet për ngritjen e stimulimin e lëvizjeve kombëtare analoge, pavarësisht nga kohështrirja e ndryshme e tyre dhe me revolucionin grek të 1821. “Shqiptarizmi, ashtu siç ishte zhvilluar, mbetej shumë i lidhur me helenizmin”, – thotë balkanologia franceze N. Clayer.

Kjo superstrukturë diakronike integruese në politikën greke, e përcaktuar nga tradita, e institucionalizuar në shtetin grek dhe të garantuar nga politika e BE-së dhe institucionet e tjera euroatlantike, përbëjnë aksin e politikës së jashtme të Greqisë. Në këtë kuptim ishte edhe deklarimi për “garantim të sigurisë evropiane”, i Kryeministrit grek Samaras, në momentin e marrjes së Presidencës së radhës.

Këtij mentaliteti politik të Greqisë i janë përgjigjur me konsekuencë dhe këmbëngulje një plejadë e tërë, pjesë e ajkës së intelektualizmit dhe mendimit shqiptar dhe shprehet akoma qartë nga marrëdhëniet shumëplanëshe, pa rezerva dhe pa paragjykime që vendos populli shqiptar me atë grek, edhe pse të ndërgjegjshëm se interesat politike të dyanshme dhe të të tretëve bëhen shpesh pengues të vullnetit të tyre.

E them këtë se kundërvënia ndaj këtij realiteti, (evropianizmi zyrtar grek si mentalitet dhe realitet dhe aspirata evropiane e popullit shqiptar) nga një nacionalizëm arkaik dhe inferior, është në dem të interesave të të dy vendeve, por veçanërisht të Shqipërisë.

Me ndryshimin e qeverisjes në Shqipëri, Greqia tregoi se e ridimensionoi gatishmërinë e përgjegjshme, fqinjësore, historike e evropiane për marrëdhënie shumë të mira me Shqipërinë.

(Domethënës është fakti se dërgoi në Tiranë arsenalin e vet diplomatik e politik më të lartë e më të mirëpritur në Shqipëri. Në Athinë zhvillon një vizitë zyrtare ministria e Mbrojtjes me protokoll pritjeje të një kryetari shteti. Greqia hapi shumë kanale komunikimi për bashkëpunim shumëplanësh dhe për zgjidhjen madje dhe të problemeve praktike etj.).

Gjithmonë në këtë prizëm, në angazhimet e qeverisë greke për Presidencën e vet, përfshihet edhe “zhvillimi i politikave detare”, që u përhëndet nga Barozo.

Kjo do të thotë se Greqia do t’i rikthehet marrëveshjes së detit me Shqipërinë. Problemi mbetet se në kërkesat e veta Tirana do të ketë si pikë referimi ligjërimet nacionaliste, anët teknike dhe proceduriale të brendshme tona, sipas të cilave Gjykata Kushtetuese e quajti marrëveshjen të pavlefshme, apo politikat evropiane dhe interesin e përbashkët që rrjedh nga implementimi i saj.

Pra, në kushtet kur Greqia, me këtë Presidencë, rikonfirmoi dhe konsolidoi pozitën dhe rolin e vet në BE, si anëtar i barabartë dhe i vlerësuar në kontributin e vet, do të ishte e gabuar që gatishmëria saj për marrëdhënie shumë të mira me Shqipërinë, në kuadrin e perspektivës evropiane të Shqipërisë, të provokojë frymën e njohur të dyshimit që imponon tradita negative nacionaliste në Shqipëri, pavarësisht se kuptohet se përkthehet edhe si antievropianizëm.

**Nga Panajot Barka/ publicist**

<http://shekulli.com.al/39628/>

**Kush po e pengon ringritjen e shtetit**

02.02.2014

Situata sot në Shqipëri përjetohet mbi një konflikt kapital. Nga njëra makina e shtetit e dërmuar nga korrupsioni, interesi privat dhe i kapur nga politika; nga ana tjetër ekzekutivi i ri, i cili mori përsipër rimëkëmbjen e tij. Nga njëra anë unifikimi i faktorëve që shembën shtetin në një reagim agresiv në emër të shtetit, por për të mbrojtur interesat e tyre private; nga ana tjetër qeveria që shpreh shumicën dhe aspiratën, me shumicën nguruese, që e çon aspiratën në tkurrje. Shteti siç është, i vënë totalisht në shërbim të politikës dhe të një pushteti të vetëm, atij ekzekutiv.

Nevoja e ruajtjes së këtij pushteti ka instaluar në makinën e shtetit marrëdhënie klienteliste dhe interesa okulte të pafundme. Kjo solli pashmangshmërisht kapjen e shtetit dhe përvetësimin e tij. Solli sisteme krimi në çdo strukturë të shtetit, situatë që reflektohet thellësisht në gjirin e shoqërisë, duke filluar që nga familja. Solli shkatërrimin e të gjitha sistemeve referuese pozitive. Antivlera fitoi pushtet absolut.

Vlera është një minorancë e kthyer në kriptovlerë dhe në shërbim të antivlerës. Vlerat e krijuara nga nënshtetasit dhe të mirë besuara shtetit për administrim dhe interes publik, po shpërdorohen për interes privat nga nëpunësit – përfaqësues të shtetit. Nga mbrojtës i qytetarit, shteti është kundërshtari i egër i tij.

Qeveria e re me të drejtë kishte konstatuar se ishte ekzekutivi ai që shembi shtyllat e shtetit dhe i vuri në shërbim të tij, (legjislativin, drejtësinë, strukturat e tjera të pavarura); që shkërmoqi unitetin komunitar të shtetit; që zëvendësoi kontributin civil të personit me individin që kërkon me çdo çmim një marrëdhënie vetjake me shtetin; që në emër të nënshtimit të shtetit, neuroparalizoi klasën intelektuale, akademikët, marrëdhëniet universitare, produktin shpirtëror e kulturor...historinë, aftësinë ballafaquese me botën; që shndërroi pushtetin e katërt, medien, në graso dhe ingranazh të mekanizmit shtet-shembës.

Stafi politik i qeverisjes së re, në entuziazmin idealist, nuk vuri re se, pavarësisht se shtetin e rrëzoi ekzekutivi, pushteti ekzekutiv është një nga shtyllat e shtetit dhe jo vetë shteti. Pra, ringritja e shtetit nuk mund të jetë ekskluzivitet dhe qëllim në vetvete i qeverisë. Iniciativa e saj kërkon edhe partnerë të tjerë, në radhë të parë pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe levave të saj. Kërkon zgjimin dhe reagimin e vetë strukturave të shembura të shtetit etj.. Në këtë kuptim, qeveria duhet të jetë garanti i një lëvizjeje mbarë shoqërore.

Por fatkeqësisht, në misionin e vështirë që qeveria ka marrë përsipër, i duhet të kapërcejë një serë rrathësh pengues e vrasarë. Një analizë e thjeshtë e vërteton këtë. Në shërbim të qëllimit të vet strategjik, qeverisja zgjodhi të lëvizë në kohë dhe në hapësirë, duke përqsaur në një unitet të kaluarën, si nevojë për të parë thellësinë e shkatërrimit të shtetit, dhe të ardhmen, si mishërim i premtimit për Rilindjen e tij.

Që do të thotë se e ardhmja duhet të çlirohet nga e kaluara dhe çdo e tashme të identifikohet me aspiratën. Një përqsasje e tillë e së kaluarës lidhet me ndëshkimin e pjesës së fajshme të saj. Por ndëshkimi nuk është pjesë e qeverisjes, por e shtetit të kapur, i cili në mënyrë sfiduese e merr atë në mbrojtje. Kështu, ndëshkueshmëria si domosdoshmëri, përkthehet në pandëshkueshmëri si realitet.

**Cilët janë rrathët pengues në misionin shtetformues të qeverisjes.**

Opozita e konsideron meritë të saj kalimin paqësor të pushtetit. Por, çdo ditë që kalon provon se ajo e ka të vështirë të pajtohet me humbjen e pushtetit. Dhe kjo lidhet më

shumë me nevojën për të mbrojtur veten nga fajti në raport me fatin e shtetit. Në emër të këtij qëllimi, opozitës nuk i intereson roli politik i saj, që është kritika konstruktive dhe bashkëpunimi me pozitën, aq e nevojshme për fatet e vendit.

Drejt qëllimit të vet, aksioni politik i opozitës konsiston në disa drejtime. Të gjitha dështimet e veta dhe antishtetin e vet kërkon t'ia faturojë qeverisjes së re. Strukturat e shtetit nën kontrollin e vet, po i përdor në favor të pandëshkueshmërisë së vet. Sa më shumë qeveria ngre zërin për zullumet e pozitës së djeshme, aq më shumë opozita e sotme i vë stërkëmbësia qeverisë dhe ngre zërin se po instalohet shteti policor, po dhunohet opozita etj.. Në përpjekje për ta tërhequr qeverinë në logjikën e vet të diskursit publik, i harxhon asaj shumë energji e kohë dhe shpesh ia del ta ulë atë në nivelin e saj. Në këtë logjikë është ndërtuar edhe qëndrimi i opozitës ndaj individëve përfaqësues të qeverisë. Së pari, opozita lë në heshtje të gjithë ata ministra, që ose nuk paraqesin rrezik në zbulimin e fajit të tyre, ose me dashje apo pa dashje ishin edhe ata pjesë e dështimeve të qeverisjes së djeshme. Dy qëndrime të tjera kanë të bëjnë me sulme pa infinit e moral. Në kategorinë e parë hyjnë ministrat e rrezikshëm për punët e qeverisjes së djeshme, si Tahiri, Kodheli, Veliaj etj..

Kategoria e dytë është kategoria e ministrave, kryesisht femra që paraqesin një nivel të lartë performance, por edhe frymë e parime papajtueshmërie me gjolin e djeshëm qeverisës, si Harito, Nikolla, Gjoshja, Kumbaro. Në rastin e dytë duket hapur se opozita ka shumë frikë nga shtrirja e moralit brenda qeverisë, por veçanërisht në shoqëri. **Rrethi** pengues i radhës është ai institucioneve të pavarura të shtetit, të kapura nga sistemi i djeshëm qeverisës, apo të kontrolluara nga ish-pozita. (Drejtësia, presidenti, SHISH, Prokuroria).

Po provohet se kolonat e shembura të shtetit, jo vetëm se e kishin pranuar me vullnet këtë “fat”, por për ruajtjen e tij, kanë ngritur struktura mbrojtëse legjislative dhe praktika shumë të fuqishme. Vallen e heq drejtësia. Mbrojtjen e antishtetit e siguron në emër të pavarësisë institucionale dhe misionit të shenjtë për drejtësi. Për këtë ka imponuar ligje, korelata esnafore dhe lidhje politike që vërtet i garantojnë një pavarësi të paprekshme, por një pavarësi antishtet, antihumane, antidrejtësi, që përditë mbjell pakënaqësi, revoltë, amplifikon krimin. **Rrethi** që pason janë mediat, pushteti i katërt. Kur dihet misioni dhe fuqia e tij, gjithkush mund të shpresonte që ta shikonte këtë pushtet në pararojë të lëvizjes së iniciuar nga qeveria për ringritjen e shtetit. Por nuk po ndodh. Në rastin më të mirë, mediat, sidomos ato elektronike, janë vënë në garë për të rritur shikueshmërinë dhe suksesin e formateve të reja, duke pasur të ftuar sa më shumë qeveritarë. Dhe ata, përgjithësisht, nuk e humbasin rastin...për të promovuar “do të-në” e tyre dhe për të justifikuar ngadalësimin e ecjes së premtuar me thesin e shpuar dhe me shtetin e rrëzuar. Duke humbur sensin e masës dhe përgjegjësinë para publikut, mediat, si opinion bërësit më të fuqishëm, me dashje ose pa dashje, po amplifikojnë klimën e pasojave të kriminalitetit në vend.

Së fundmi duket qartë se misioni i oponencës së pushtetit të katërt me tre pushtetet e tjera, po njehsohen me opozitën. Shembulli më i keq i mundshëm u shfaq në rastin e analistëve me celularë përballë ministrit Tahiri, ku një kandidat për president republike, nën peshën e sms-ve tregoi se ishte i denjë për sjellje rrugaçërie. **Rrethi** vijues kundër vullnetit të qeverisë për të ngritur shtetin është shoqëria civile e “intelektualëve”. E vura në thonjëza këtë fjalë se intelektualizmi nuk ka të bëjë me diplomat, me inflacionin e titujve e të gradave shkencore.

Por në radhë të parë ka të bëjë me gatishmërinë e këtyre individëve që dijet e tyre, personalitetin, emrin dhe gjithçka tjetër kanë, t'i vënë në shërbim të popullit, atdheut, përparimit e zhvillimit të vendit. Kjo memecëri intelektuale karshi situatave fundamentale që kalon Shqipëria, që nga ngujimet, kriminaliteti, rënia e shtetit,

antimorali i politikës, korrupsioni deri edhe mbi dijen, vrasja e arsimit (që do të thotë vrasja e administrimit të vendit për shekullin e ardhshëm) e deri te perspektiva evropiane e Shqipërisë, tregon se edhe klasa e intelektualëve po noton në batakun e krijuar, e gatshme të përfitojë personalisht nga një lidhje direkte me strukturat e shtetit. Kriza intelektuale që po kalon vendi është sigurisht më e rënda në historinë moderne të Shqipërisë.

Emri i saj po identifikohet me veprën shkatërrimtare të vendit nga politika. Me heshtjen e saj klasa “e intelektualëve” i bën shërbimin më vital antivlerës. Shtetin dhe rilindjen e vendit duhet ta ndërtojmë fillimisht brenda vetës dhe këtë shembull duhet ta japin intelektualët dhe intelektualizmi i çdo shqiptari. **Rrethi** që pason ka të bëjë me mentalitetin shoqëror të instaluar nga politika.

Fjala është për klientelizmin në marrëdhëniet e qytetarëve me shtetin. Ndërkohë që shteti po provon se shpërdoron vlerat, e mirë besuara atij nga shoqëria, një lumë përkrahësish të qeverisë së re, po përpiqen të hapin një vrimë në depozitën e shtetit që të çojë ujë në shtëpinë e tij. Mjet këmbimi për çdo punë në shtet është numri i votave të siguruara për “X” eksponent partiak në pushtet. Para zgjedhjeve të gjithë pajtoheshin me parimin se duhet votuar për shtetin e të gjithëve. Sot secili mendon për shtetin e vet. Sëmundje e vjetër, por e kultivuar në kulm nga qeveria e djeshme. Klimën e bën më imponuese fakti që aleatë në qeverisjen e re e kanë bërë normë klientelizmin duke vënë në pozitë të vështirë parimet e meritokracisë e të konkurrimit. Fakti që politika e klientelizmit ka kthyer aleatë të caktuar të qeverisë në pol të thithjes së votuesve të shumtë dhe deputetëve nga opozita e bën praktikën e klientelizmit me imponuese dhe gjendjen e shtetit më të vështirë.

**Rrethi** i shtatë është ai i politizimit të administratës publike, i fryrjes së saj të tejskajshme për efekte elektorale me partiakë shpesh pa arsimin përkatës, ose pa asnjë lidhje me objektin e punës dhe sot nuk tregojnë asnjë gatishmëri për t’i shërbyer ligjit, por padronit që i dha vendin e punës.

## **Nga Panajot Barka/publicist**

<http://www.shekulli.com.al/43128>

### **Reforma territoriale dhe minoritetet**

23.03.2014

Reforma administrative që pritet të zbatohet së afërmi në vend, është më e thellë dhe më e ndryshme nga ato që janë kryer në vend që nga formimi i shtetit shqiptar. Inicohet në kuadrin e përshtatjes së vendit me kushtet e BE-së. Ajo që vihet re është se reforma e artikuluar deri tani, përmbys të gjithë traditën e deritanishme të organizimit shoqëror të vendit, (organizimi në fise, komunitete të vogla krahinore, nevojën për të patur një strukturë shtetërore në një kuadër sa më lokal etj). Nga ana tjetër reforma e re presupozon edhe zgjidhje adekuate funksionale. Funksionimin perfekt të sistemit shtetëror dhe ekzistencën e një infrastrukture të përsosur administrative. Kjo lidhet me faktin se qytetarët shqiptarë kanë akoma raporte personale të shumta me shtetin: që nga pajisja me dokumente identiteti e deri në raportet me gjykatat, shëndetësinë, pronat e varësi të tjera të cilat në realitetin e BE-së janë zgjidhur me kohë.

Problemi tjetër, me raportin që vendosin minoritetet me këtë strukturë të re dhe sa ajo jep garanci për ruajtjen, respektin dhe zhvillimin e identitetit të tyre komunitar e etnik. Fjala është për ato minoritete që zotërojnë një hapësirë territoriale të caktuar. Në bazë të mentaliteteve dhe realiteteve evropiane ky konstatim do të dukej pak absurd, pasi këto probleme atje janë zgjidhur në favor të individëve dhe të komuniteteve minoritare. Tek në çështja shtrohet si problem i mprehtë për dy arsye shumë të qenësishme. Së pari, qoftë nga ana ligjore, qoftë nga ana praktike, shteti nuk ka zgjidhur në favor të këtyre minoriteteve respektimin e të drejtave të tyre. Së dyti, janë pikërisht reformat administrative që në aspektin historik kanë dëmtuar homogjenitetin etnik dhe kompaktësinë komunitare e territoriale të tyre.

Ndarjet territoriale të vitit 1920, 1924 e në vijim nuk lejuan asnjë krahinë të minoritetit etnik grek në prefekturën e Gjirokastrës të përbëjë njësi administrative me vete. Krahinat me popullsi homogjene minoritare greke iu bashkëngjiten 7 nënprefekturave të kësaj prefekturë me popullsi shqiptare. Qendrat e nënprefekturave u vendosen në njësi me popullsi shqiptare dhe drejtimi tyre iu besua po pjesës shqiptare. P.sh në rrethin e Gjirokastrës, Dropulli i Poshtëm iu bashkua Lazaratit, Gjirokastrës, Kardhiqit etj.. Dropulli i Sipërm, në të njëjtën shtirje gjeografike iu bashkëngjit Libohovës. Sipas kësaj ndarjeje, Himara, që deri para pushtimit të Jugut të vendit nga Italia (1917-1920) përfshihej në zonat me popullsi minoritare, iu veçua prej tyre. Pas çlirimit pushteti komunist ndoqi një taktikë tjetër. Të njëqind fshatrat e minoritetit, duke përjashtuar Himarën, i përfshiu në një prefekturë dhe krijoi njësi administrative pak a shume me popullsi homogjene minoritare greke, por kufizoi në ekstrem komunikimin midis vetë krahinave minoritare. Madje krijoi diferencime të qëllimshme midis popullsisë minoritare greke në rrethet Sarandës e Delvinës me ato në Gjirokastrë. Me eliminimin e prefekturave ky dallim u thellua edhe më. Politika e sistemit komunist u thellua më shumë nga qeveria e parë e PD-së kur me ndarjen territoriale të vitit 1992-93, rrethet me popullsi minoritare në Gjirokastrë, Sarandë, Delvinë e Përmet i ndau në dy prefektura të ndryshme. Pasojat ishin të shumta. Në aspektin politik, minoriteti grek i ndarë në disa zona zgjedhore minimizoi fuqinë e vet elektorale. Probleme u vunë re edhe në aspektet ekonomike, gjyqësore, administrative. Përfaqësimi politik në strukturat e pushtetit vendor dhe ato vendimmarrëse u minimizua në mënyrë mekanike. Lëvizjet për mbrojtjen e të drejtave të minoritetit etnik, siç ishte akoma edhe ai i arsimimit në gjuhën amtare, nuk homogjenizoheshin.

Edhe ndarja e re territoriale në lidhje me minoritetin etnik grek ashtu si edhe me minoritetet e tjera duket se do të ketë probleme. Përsa i përket minoritetit etnik grek duket se veprohet me referenca, të ashtuquajtura zona minoritare greke. Fakt është se që nga periudha e qeverive të para në shtetin shqiptar e deri më sot, nuk ka asnjë dokument zyrtar përcaktues për zona minoritare greke. Statusi arbitrar dhe a priori i tyre u vendos gjatë pushtimit të parë italian, (1917-1919) dhe u zbatua sipas interesave të çdo qeverie. Në këtë këndvështrim, reforma administrative në zonat minoritare duket se do të pasqyrojë, sidomos në rrethet e Sarandës dhe Delvinës, ndryshimet e dukshme demografike që çuan në kufizimin e zonave të njohura arbitrarisht si minoritare greke, e që janë pasojë e politikave të ndjekura deri me sot. Një kufizim me shumë pasoja, të paktën në aspektin ekonomik, duket se do të jetë zgjatja e pretenduar e bashkisë së qytetit të Sarandës përgjatë gjithë bregut Çukë-Pali-Ksamil-Mursi deri në Shkallë e Konispol. Pra heqja e mundësisë së zonave të minoritetit të komunikojnë me detin si alternativë turistike e veprimtari ekonomike, është me pasojë në integritetin e vet si ekonomik ashtu edhe territorial, që sjell në vijim pasoja identitare etnike. Probleme të kësaj natyre ka edhe në zona të tjera si në Delvinë e Gjirokastrë.

Po ashtu respektimi i të drejtave të minoritetit etnik grek në Jug të vendit kërkon që edhe qendra administrative e njësisë më të madhe, Prefekturës, apo qarkut, të jetë në një qendër tradicionale sa më afër tij. Një qendër e tillë është Gjirokastra, e cila tradicionalisht është një qendër administrative nga më të rëndësishmet në rajon pas Janinës.

Në këtë drejtim, është me interes shumë të madh të merret në konsideratë pika 2 e nenit 108 të Kushtetutës, e cili thekson se “ndarjet administrative caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkëta ekonomike dhe të traditës historike dhe se kufijtë e tyre nuk mund të ndryshojnë pa u marrë me parë mendimi i popullsisë që banon në to”. Që do të thotë se respektimi i interesave të krahinave minoritare greke, mund të lejojë përfshirjen në njësitë administrative minoritare edhe të pjesëve me popullsi shqiptare, mjaft që ato të mos tejkalojnë një përqindje limiti që mund të shkaktojë asimilim demografik. Në këtë pikë, nga strukturat përfaqësuese të minoritetit etnik grek manifestohet një sjellje e cila më shumë çudit, se sa krijon terren për diskutim. Qoftë OMONIA, apo PBDNJ e MEGA, nuk shfaqin mendim publik për ndarjen e re administrative. Në fakt edhe një herë nuk dalin në mbrojtje të interesave të këtij minoriteti që lidhen me ndarjen e re administrative. Aq më tepër po të kihet parasysh historia e pasojat që rrodhën në drejtim të ruajtjes dhe respektimit të identitetit etnik.

Nga ndonjë deklaratë e deritanishme duket se këto struktura presin që organet kompetente të qeverisë për reformën administrative, të bëjnë “gabimin” që ato të kenë një argument për të akuzuar qeverinë shqiptare për shkeljen e të drejtave të minoritetit. Kjo është ndoshta pjesë e taktikës për justifikimin e pakënaqësisë ndaj bashkëqeverisjes me socialistët, por që është shumë e dënueshme kur sakrifikohen për interesa kaq të vogla çështje kaq jetike për këtë komunitet. Ashtu siç është i paarsyeshëm pretendimi se duhet t’i thërrasë për mendim qeveria kur e kundërta duhet të ndodh. Organet kompetente të reformës duhet të kishin me kohë mbi tavolinë të gjitha propozimet e mundshme që i interesojnë minoritetit. Po ashtu vihet re se ngurrimi i këtyre strukturave për të dalë me propozime konkrete lidhet me faktin se kanë koncepte të tjera për natyrën dhe shtrirjen e minoritetit etnik grek, siç është p.sh rasti i Himarës, apo të ndonjë zone tjetër. Por këto koncepte i ruajnë për konsum të brendshëm. Megjithatë, në ndarjen e re administrative, shteti, në rastin e minoriteteve duhet të tregojë ekzigjencë maksimale të çliruar nga mentalitete të së kaluarës me pikë referimi respektin e të drejtave të tyre.

**Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/44460/>

## **Kujt i shërben vrasja e Kumes?**

10.04.2014

Vdekja nga dhuna e personelit të burgut të Mallandrinos në Greqi i të dënuarit shqiptar për shumë krime të renda, Ilia Karelit (Kudret Kumës), përveç problemeve të tjera, rishfaqti edhe një herë amplitudën e helmit, që qarqe të caktuara, deri edhe disa politikanë në Shqipëri, përpiqen t'u injektojnë marrëdhëniet Greqi-Shqipëri dhe popullit shqiptar e atij grek. Kuptohet, nuk mund të mos dënohet akti i shëmtuar i personelit të burgut. Bëhet fjalë për një akt që tejkalon shumë çdo kornizë ligjore të komunitetit të BE-së dhe moralit të kohës. Ata nuk i justifikon në asnjë mënyrë as krimi i radhës i Karelit, vrasja pa arsye e gardianit të burgut, kolegut të tyre.

Në Greqi, institucionet zyrtare dhe politika, jo vetëm e denoncuan këtë akt, por morën edhe hapa drastike për dënimin e autorëve. Madje, ky qëndrim shkoi aq larg, sa që u harruan krimet e shumta të viktimës së dhunës. Kjo bëri që në Greqi të frenohej edhe një frymë antishqiptare, që në fund të fundit, mund të justifikohet pas vrasjes mizore të një nëpunësi shteti dhe babait të dy fëmijëve prej të dënuarit Kareli. Ndihej shumë në këtë drejtim edhe fakti, që në opinionin publik grek, ngjarja e rëndë e vrasjes së gardianit kaloi pothuaj në heshtje. Madje, po të kihet parasysh zelli me të cilin mediat greke qëmtuan për të zbuluar shkaqet dhe shkaktarët e vdekjes së të dënuarit shqiptar dhe presionit mbi institucionet e drejtësisë për dënimin e tyre, atëherë mund të flitet për një asimetri qëndrimesh në favor të vdekjes së të dënuarit shqiptar. Në Shqipëri situata e tejkaloi shumë objektivitetin e ngjarjes. U përvijua hapur nevoja për përfitim etnik dhe promovim të antigreqizmit. Arsyeja dhe gjykimi i balancuar iu dorëzuan, pikërisht emocionit të manipuluar nacionalist antihelen. Vetëm fakti se Ilia Kareli humbi jetën nga dhuna e gardianëve grekë, mjaftoi që ai të trajtohej si hero. Mjaftoi kaq gjë që arkivoli i tij të mbështillej me flamurin kombëtar. Varrimi i tij të shoqërohej me ngritjen e dhjetëra flamujve kombëtarë, sikur Kareli po dekorohet për krimet e kryera në Greqi dhe se vdekja e tij duhej kthyer në simbol të antihelenizmit. Në shtypin e shkruar dhe elektronik, fotografitë e Karelit kishin gjithë hijeshinë e një heroi.

Nën peshën e kësaj logjike dolën me deklaratat publike zyrtare shqiptare, që kërkonin dënimin e fajtorëve në Greqi, në një kohë që Greqia vetë e kishte kthyer problemin në çështje dite. Rasti i vdekjes së Karelit u përdor gjerësisht për t'i provuar opinionit publik shqiptar se në Greqi po shkelen të drejtat e të burgosurve shqiptarë. U ndërtuan emisione televizive dhe u bënë analiza në media. Politikanë e analistë morën pozat e institucioneve evropiane për të dënuar gjendjen e burgjeve greke etj. Por, gjithçkaje i mungonte analiza objektive dhe gjykimi i ftohtë. Shumë nga faktet që i serviren opinionit publik vilen nga burime zyrtare dhe mediat greke, që do të thotë se të parët janë ata të shqetësuar për situatat dhe problemet që ekzistojnë në burgjet greke. Në rastin e vrasjes së gardianit nga Kareli u trumbetua shumë si shkak sentimentit i nënës, për të cilën autoritetet e burgut nuk i dhanë leje për ta takuar. Ishte e arsyeshme që Karelit nuk mund t'i jepej leje për të takuar nënën kur zyrtarisht nuk figuron se është nëna e tij, (se ai është me identitet të rremë në Greqi). Aq më keq, nuk mund t'i jepej leje Karelit kur mbi të rendonin akuza të renda deri për vrasje dhe që ishin në proces hetimi e gjykimi. Po ashtu, nuk mund t'i jepej leje për të dalë nga burgu një të dënuari me rrezikshmëri të lartë, kur nga 650 të dënuar shqiptarë që përfituan leje të tilla, 450 prej tyre nuk u kthyen në vendet e vuajtjes së dënimit duke gjetur strehë në Shqipëri. U



fol shumë këto ditë se ka shkelje të të drejtave të njeriut në mënyrë të diferencuar ndaj të burgosurve shqiptarë. Por rezultoi e kundërta. Një i dënuar shqiptar me 17 vjet burg në Greqi për trafik droge, pohoi se asnjë nga sa thuhet nuk qëndrojnë, me përjashtim të mbipopullimit. Mediat në Shqipëri provuan se vet Ilia Kareli, dispononte në qeli telefon privat dhe komunikonte përditë me të afërmit, kishte akses në internet dhe zotëronte edhe “Facebook”.

Po ashtu flitet për mbipopullim në burgjet greke. Të gjithë bëjnë sikur harrojnë se gati 30 % e të dënuarve në burgjet greke janë shqiptarë. 2800 veta ose 50% e numrit të përgjithshëm të të burgosurve në Shqipëri. Të gjithë bëjnë sikur harrojnë se të dhënat e vetë të burgosurve shqiptarë në Greqi flasin se 50% e tyre janë për trafik droge dhe të tjerët për grabitje me dhunë, që nga jurisprudenca ndërkombëtare klasifikohen si krime të renda. Edhe në rastin e Karelit, e drejta e tij për humbjen e jetës në rrahje masive ia la vendin moralit të antihelenizmit. Dhe në këtë proces glorifikimi të tyre, askush nuk u mendua, qoftë edhe pak se veprimet e këtyre të dënuarve kanë për objekt jetën e mijëra të rinjve grekë dhe pasurinë e qindra qytetarëve të tjerë po grekë, se ata kanë shkelur brutalisht të drejtat e të tjerëve në një vend që vajtën me vullnetin e vet dhe të paftuar nga kush. Antihelenizmi si argument për të glorifikuar dhe çdo të dënuar për krime vërtetohet edhe nga një krahasim tjetër i thjeshtë. Në Itali, apo edhe vende të tjera ka shumë të burgosur shqiptarë për krime të njëjta apo edhe të tjera. Edhe për ata ka lajme, shpesh më të renda. Por në një asnjë rast nuk trajtohen në Shqipëri si heronj, siç ndodh me të burgosurit shqiptarë, apo me ata shqiptarë që marrin në dorë vetëgjyqësinë në Greqi. Megjithatë, rasti i Karelit do të ishte ndoshta i parëndësishëm në ardhmërinë e marrëdhënieve të mira me Greqinë e me popullin grek, nëse nuk do të përbënte një tendencë nga e kaluara dhe nëse paralelisht, në arealin e marrëdhënieve shqiptaro-greke nuk do të zinin vend disa faktorë të tjerë më shqetësues. Fjala është për deklaratën e ish kryetarit të SHIK-ut Fatos Klosit në gazetën “Illyria” të SHBA-së, se shteti grek, nëpërmjet kishës ortodokse në Shqipëri, është më i rrezikshëm se ekstremizmi islamik. (Nëse sipas Klosit, shteti grek ka financuar ndërtimin e infrastrukturës së kishës ortodokse shqiptare dhe nëse ai, Klosi, nuk ka asnjë fakt që tregon se pas këtij financimi fshihen qëllime në dëm të Shqipërisë, të popullit shqiptar e të unitetit të tij, atëherë këtu nuk bëhet fjalë për një populizëm rastësor).

Po ashtu, në projektin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes ka teza të cilat venë në dyshim marrëdhëniet e mira të pretenduara midis dy vendeve. Në këto rrethana po bëhet këmbëngulëse një pyetje: Kujt i shërben tensionimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve shqiptaro-greke? Kuptohet që as Shqipërisë e as Greqisë. Nuk i shërben as qindra e mijëra shqiptarëve emigrantë në Greqi. Nuk u shërben as perspektivës Evropiane të Shqipërisë. E sigurt është se një klimë e tillë evidenton përkrahësit e Shqiptarësisë e të patriotizmit shqiptar sipas formulës së stërvjetruar të antihelenizmit dhe të inferioritetit ndaj fqinjëve. Historia e gjatë e bashkëjetesës midis dy popujve tanë prodhoi përgjatë gjithë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, idenë e bashkëjetesës së tyre në konfederatë të përbashkët. Ishte kjo ide që e bënte një popull të shikonte lirinë dhe mbrohtësinë e tjetrit si lirinë dhe përparimin e vet. Interesat e të tretëve mbollën ndarjen dhe provokuan armiqësinë. Sot, kur dihet rruga që duhet zgjedhur, sorollatja nëpër mentalitete konfliktuale të së kaluarës, vetëm sa e vonojnë rrugën dhe bën disa që të ndjehen të pasur.

## **Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/44937/>

### **Të shpëtojmë universitetin!**

16.04.2014

Për shkak të ndikimeve negative me spektër të gjerë shoqëror dhe gjatësi vale prej disa brezash, reforma në arsimin e lartë duhet konsideruar si kryereformë, jo vetëm për qeverinë, por për të gjithë shoqërinë. Po ashtu, reforma në IAL-e (Institucionet e Arsimit të Lartë), ndryshe nga shumë sektorë të tjerë, nuk do të ketë serish rezultate nëse importohet për zbatim një model perëndimor, pa rehabilituar problemet e brendshme të këtij sistemi, që kanë thelluar hendekun me universitetet perëndimore. Pra, duhet një reformë që fillimisht të sigurojë rritjen e cilësisë së studimeve dhe dijeve, dhe shndërrimin e universiteteve në institucione promotore të zhvillimeve sociale, ekonomike dhe politike në vend. Në parim, kjo presupozon riformatimin e marrëdhënieve midis tri palëve: shtetit (i cili përcakton politikën universitare, strategjinë, financimet etj), stafit akademik (i cili ftohet të udhëheqë praktikisht strategjitë shtetërore në IAL-e) dhe studentit (i cili hyn në këto marrëdhënie si objekt dhe subjekt). Në realitetin e sotëm, këto raporte janë shthurur deri në cenimin kapital të misionit të universitetit, duke e kthyer atë në një pjesë aktive të informalitetit të përgjithshëm abuziv.

Aq më tepër kur universitetet, në vetvete, kanë krijuar struktura mbrojtëse shumë rezistente, që konsistojnë në ndërveprimin e faktorit akademik me faktorin politik, mediatik dhe ekonomik. Kjo situatë gjeti terren në mentalitetin shoqëror të përfitimit të produktit universitar nëpërmjet informalitetit të dijeve, si shprehje korrupsioni apo nevojë për mbijetesë të sistemit. Konkretisht, strategjia shtetërore për arsimin e lartë u identifikua me politikën klienteliste dhe populiste të ekzekutivit, sidomos në tetë vitet e fundit. Për përfitime elektorale dhe jo vetëm, u praktikua masivizimi i skajshëm i universitetit në dy forma. Nëpërmjet hapjes së dyerve për të gjithë maturantët, pavarësisht cilësisë dhe perandorisë së pafundme të universiteteve (private). Kjo politikë prodhoi një zinxhir reaksionesh degraduese të universitetit dhe produktit të vet për shoqërinë. Stimulimi i universiteteve private bëri që aseti kombëtar i përgatitjes së kuadrit të lartë, t'i besohej faktorit privat, qëllimi parësor i të cilit është sigurimi i fitimit. Nëpërmjet masivizimit, universiteti, si ai privat dhe ai publik, u kthye në varësinë totale të numrit të studentëve. Për universitetin privat numri i studenteve u lidh me objektivin i tij parësor, fitimin. Por fatkeqësisht, vetëm në pak raste numri i studenteve sigurohej në emër të cilësisë në nivelin e dijeve. Në shumicën dërmuese veçoi mekanizmi i informalitetit të dijës dhe legalizim i saj me diploma fiktive. Mënyra tjetër për thithjen e studenteve ishte ajo e sigurimit të një numri të madh degësh dhe programesh studimi. Për pasojë, u krijua një kaos i vërtetë ku rolet e shtetit si politikbërës dhe përcaktues i strategjisë arsimore u eliminua totalisht. Inflacioni dhe natyra e universiteteve private shembi, edhe strukturat, edhe nivelin e universiteteve publike. Privatët, për nevoja licencimi, por edhe funksionimi praktik, kanë për stafe akademike pothuajse ato të universiteteve publike. Në këto kushte dhe në përshtatje me moralin shoqëror të kohës, fitimit pa skrupuj, stafi akademik është objektivisht i detyruar të braktisë kërkesat cilësore akademike. Si hallka më e braktisur nga kjo histori, del studenti i universitetit publik, duke krijuar kështu terrenin për kompromise në favor të informalitetit dhe të korrupsionit. Në denigrimin e universiteteve publike ndikojnë gjithashtu abuzimi me autonominë dhe sistemi zgjedhor i autoriteteve dhe organeve drejtuese.

Në emër të autonomisë tejkalohen dhe shkelen: kuadri ligjor në administrimin e universiteteve; kuadri ligjor në rekrutimin e stafit akademik; kuadri ligjor në trajtimin e punonjësve. Abuzimi me statusin e autonomisë shtrihet edhe në sistemin zgjedhor. Në emër të fitimit të postit nëpërmjet zgjedhjes dhe me mburojë autonominë, autoriteti i rektorit grumbullon në dorën e vet paketën kontrolluese të kompetencave në drejtimin e çdo hallke të universitetit. Ndodh kështu kur ligji për arsimin e lartë nuk i njeh rektorit asnjë kompetencë konkrete. Abuzivizmi është më kërcënues për jetën akademike dhe universitare, kur pushteti i autoritetit drejtues përdoret për komprometimin e strukturave zgjedhore, që garantojnë vazhdimësinë e postit. Kjo u tregua në zgjedhjet e shkurtit 2012. Për shkak të lejimit nga ligji të mandatit të dytë drejtues, “u zgjodhën”, pa përjashtim të njëjtët rektorë. Për këtë aplikohet skemat e sigurimi të votës nëpërmjet krijimit të privilegjeve për përfitime të pamërituara, dhënies së titujve akademikë dhe kualifikimeve të tjera pa plotësuar kriteret, rekrutimeve në punë me garanci votën, presioneve ndaj kundërshtarëve dhe shkeljeve të parimeve të meritokracisë akademike. Kjo analizë, qoftë edhe e përciptë, lejon formulimin e disa propozimeve për reformën. Ligji duhet të parashikojë që, një autoritet drejtues në mbarim të mandatit të tij, në mandatin pasardhës të mos ketë të drejtë të kandidojë për asnjë post autoriteti drejtues, ose të paktën për njësi kryesore, rektor, të të njëjtit universitet. Një masë e tillë do të instalojë, në praktikë, rregulla demokratike zgjedhore dhe do t’u hapë rrugë forcave të reja me aftësi dhe vizion në drejtim.

Posti i kryetarit të senatit të mos identifikohet me atë të rektorit, por të zgjidhet nga të zgjedhurit në organet drejtuese të universitetit. Në strategjinë shtetërore të IAL-eve, duhet të disiplinohet profilizimi i universiteteve sipas përvojës, kapaciteteve, kualifikimit dhe nivelit të akreditimit të stafit akademik. Në këtë profilizim, shteti duhet të mbështesë dhe të financojë, sipas një koeficienti të përcaktuar nga nevojat kombëtare për kuadro, degët respektive. Për degë të tjera, universiteti (publik) duhet të gjejë paralelisht edhe burime alternative financimi. Me ligj duhet të ndalohet ekzistenca e një universiteti të dytë, apo filiali të një universiteti tjetër në një territor me popullsi rurale me 150-200 mijë banorë. Shteti duhet të përcaktojë kuota të qarta për projektet kërkimore-shkencore. Qartësisht duhet të përcaktohet nocioni i autonomisë së universiteteve publike dhe i raporteve të tyre me ligjin. Në këtë drejtim, rol parësor merr Këshilli i Administrimit, si autoriteti me qasje në ministri, për respektimin e ligjit në administrimin e universiteteve. Rregulla të ashpra duhet të përcaktohen edhe për të luftuar korrupsionin dhe mitmarrjen në këmbim të dijeve. Për stafin akademik, duhet t’i jepet fund dypunësimit të barasvlershëm dhe paralel. Pranimi i studenteve në universitete duhet të bëhet me kritere dhe me një minimum pikësh që i korrespondojnë nivelit mesatar të dijeve në shkollën e mesme. Këtij rregulli duhet t’i përshtatet edhe universiteti privat, përndryshe, të diplomuarit prej tij, duhet t’u hiqet e drejta e të punësuarit në sektorin publik.

## **Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/46117/>

### **Himara s'është Krime!**

30.04.2014

Ditët e fundit, dy eksponentë të lartë të shërbimeve inteligjente shqiptare, përkatësisht ish-kryetari Fatos Klosi dhe ai në detyrë, Visho Ajazi Lika, dolën në publik me deklaratat, që minimalisht shkelin etikën profesionale dhe realisht provokojnë tension në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Greqisë, si edhe në marrëdhëniet e minoritetit etnik grek me shtetin dhe qytetarët shqiptarë. Fjala është për deklaratën e Fatos Klosit në gazetën “Illyria” të SHBA-ve, se shteti grek, nëpërmjet kishës ortodokse në Shqipëri, është më i rrezikshëm se ekstremizmi islamik. Po kështu, fjala është edhe për deklaratën e kryetarit në detyrë të SHISH-it bërë në Komisionin e Sigurisë, se shërbimet inteligjente që ai drejton disponojnë informacione se nëse në ndarjen e re territoriale zona e Himarës do të jetë njësi më vete, atëherë nën ndikimin grek, kjo krahinë mund të ndjekë shembullin e Krimesë. Është më se normale që shërbimet inteligjente të një vendi, në funksion të sigurisë së tij kombëtare, të klasifikojnë impenjimin e tyre ndaj faktorëve të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit. Normale është (dhe kështu ndodh) që raportimet dhe konkluzionet inteligjente nuk janë për konsum publik, veçse për struktura të caktuara. Ndryshe s'ka përse të quhen “sekrete”. Për SHISH-in, historia e tranzicionit provoi se bën përjashtim rasti i raportimeve “sekrete” të tij ndaj Greqisë. Pra, nuk bëhet fjalë vetëm për dy rastet e fundit, por për “një transparencë” dhe konsum vijues nga publiku të sekreteve të SHISH-it që kanë për objekt Greqinë.

Ndodh veçanërisht kur situata politike e brendshme në vend përjeton trazime, ose prag trazimesh; kur forcat e caktuara politike në vend (me ndikim në shërbimet inteligjente) kërkojnë të mënjanojnë përgjegjësitë e veta për situatat e ndërlikuara me “rrezikun” grek ndaj Shqipërisë, ose kur minoriteti etnik grek, brenda kuadrit kushtetues të vendit, ka rastin të përmirësojë statusin e vet në fusha dhe nivele të ndryshme. Mekanizmi është i thjeshtë dhe shumë efektiv. Për vetë natyrën e këtij shërbimi, informacioni “i rrjedhur” prej tij ka një ndikim ekstrem në ndjesitë nacionaliste antigreke të shtresave të opinionit publik shqiptar. Kështu mund të interpretohen edhe dy rastet e fundit. Zoti Klosi e kupton se kumti i informacionit që ia servir publikut shqiptar, edhe në rast se është i saktë, parimisht, ligjërisht, logjikisht dhe nga pikëpamja humane, nuk ka asnjë gjë të keqe. Nuk është në dem të ortodoksisë shqiptare ringritja e një strukture kaq brilante të këtij besimi në Shqipëri, ashtu siç nuk i erdhi asnjë e keqe popullit shqiptar nga vepra sociale dhe humane e kreut të kishës ortodokse. Aq më keq kur, as Klosi e as ndonjë strukturë tjetër shtetërore në vend, apo brenda komunitetit ortodoks ose komuniteteve të tjera fetare, nuk kanë as edhe një rast të vetëm që mund të komprometojnë kreun e kishës ortodokse apo edhe shtetin grek për veprimtari të dënueshme ndaj interesave të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare. Zoti Klosi do të kishte të drejtë nëse do të “vërtetonte” për shembull se, sipas censusit të fundit, zvogëlimi gati tri herë i numrit të ortodokseve shqiptarë ishte “pasojë e reagimit kundërshtues” të besimtarëve ndaj kreut të ortodoksisë. Ose të zbulonte arsyet se përse shteti shqiptar i ka ndezur dritën jeshile braktisjes dhe shkatërrimit të gati 400 objekteve të kultit ortodoks. Pas kësaj, është e lehtë të gjykohet se bëhet një përpjekje e sforcuar për tërheqjen e vëmendjes nga ato raste të ekstremizmit islamik që e komprometojnë rrugën evropiane të vendit tonë.

Rimarrja e kësaj teze të Klosit nga grupet e njohura në Shqipëri, që mbajnë të ngrehur në mënyrë permanente antigreqizmin, duhet të konsiderohet edhe si një demarsh që mbjell dyshim dhe çarje në harmoninë ndërfetare në vend dhe krijon premisa për një kompleks faji dhe inferioriteti të komuniteti ortodoks shqiptar. Akoma, më absurd ishte

“informacioni” i kreut aktual të SHISH-it në Komisionin e Sigurisë në Parlament. Paralelizmi i Himarës me Krimenë dhe i Ruisë dhe Ukrainës me Greqinë dhe Shqipërinë i kalon caqet e çdo fantazie. Kjo do të thotë se në konceptin e SHISH-it, lehtësia për inicime ndryshim kufijsh midis dy vendeve anëtarë të NATO-s ka një domethënie tjetër. Historia e tranzicionit bën të njohur reagimin e minoritetit etnik grek ndaj këtyre “informacioneve” të publikuara të SHISH-it. Provokon frikë të shprehur në formulën se diçka është kurdisur prapa krahëve të tij, që më siguri do të ftohet për ta paguar shumë shtrenjtë ai si komunitet. Kjo përkthehet në frikë kolektive, në deformim karakteri, në mosbesim dhe rezervim ndaj shumicës dhe shtetit. Asnjë prej strukturave legale të minoritetit etnik grek nuk u ngrit për ta dënuar ose kundërshtuar deklaratën e kryetarit të SHISH-it që synon paralelizmin e Himarës me Krimenë dhe Greqinë me Rusinë. Nga ana tjetër, eksponentët e minoritetit grek u bënë më memecë në paraqitjen e projekteve të tyre në lidhje me natyrën e minoritetit etnik grek në ndarjen e re territoriale dhe në lidhje me korrigjimin e gabimeve të historisë.

Përveç kësaj, e njëjta deklaratë synon gjithashtu të mbajë në këmbë një klimë antigreke e cila, sipas projektuesve të saj, mund të ndryshojë sado pak negativisht qëndrimin grek për marrjen e statusit të vendit kandidat të BE-së nga ana e Shqipërisë. Është gjithashtu e sigurt se këto përpjekje do të vazhdojnë edhe pas deklaratave të kryeparlamentarit grek se për Athinën zyrtare marrja e statusit nga ana e Shqipërisë përbën angazhim primar. Nga ana tjetër, historia e fundit më se 20-vjeçare tregon se informacionet e rrjedhura apo të publikuara nga shërbimet inteligjente shqiptare për gjoja veprimtari subversive greke ndaj Shqipërisë, nuk janë vërtetuar asnjëherë, pra kanë qenë një mashtrim, ose një lojë shpesh me protagonistë nga minoriteti etnik grek të kompromentuar nga shërbimet inteligjente shqiptare, që synonin kultivimin e fobisë dhe rezervimit të minoritetit etnik grek në marrëdhëniet me shtetin dhe popullin shqiptar, ose kishin si qëllim tërheqjen e vëmendjes nga problemet e brendshme politike. I takon tanimë historisë së afërme loja “e autonomisë së Vorio Epirit” me projektin e çifteve të një fondacioni privat grek. Për incidentin e Peshkëpisë së 10 prillit 1944, nuk janë marrë akoma përgjigje se kush e urdhëroi shkeljen e ligjeve ushtarake të shtetit shqiptar. P.sh transferimin në kufi të rekruteve para kryerjes së betimit ushtarak, lënies së tyre pa armatim dhe ndërlihdje, zhdukjes së procesverbalit të kryerjes së veprimeve etj. Në gjyqin e të pestëve të OMONIAS mbeti enigmë se përse shërbimet sekrete e zbuluan nëpërmjet shtypit (kur me ndërhyrjen amerikane bëhej gati lirimi i tyre) se tre nga të pestët ishin të rekrutuar nga sigurimi i shtetit. Asgjësues mbetet për variantin e ish-SHIK-ut se shkak i trazirave të 1997-ës ishte plani i lobit grek fakti që në Shqipërinë e Jugut pa shtet, ushtri e qeveri në atë periudhë, nuk pati asnjë përpjekje për ndryshim kufijsh etj. Duke e mbyllur këtë analizë dua të theksoj se ajo ishte e përfunduar kur ambasadori amerikan Arvizu tërhoqi vëmendjen për një kujdes në publikimin e informacioneve të shërbimeve sekrete.

### **Shenim në Gjuhën Greke Σημείωση στα ελληνικά!**

Ο αρχηγός των αλβανικών μυστικών υπηρεσιών Βίσιο Αγιάζι Λίκα, δήλωσε την Τρίτη στην επιτροπή εθνικής ασφάλειας της Αλβανικής Βουλής ότι η υπηρεσία του διαθέτει πληροφορίες πως σε περίπτωση που στη νέα διοικητική διαίρεση η περιοχή της Χιμάρας θα αποτελέσει εκ' νέου ξεχωριστό δήμο, τότε κάτοικοι της, υπό την επιρροή ελληνικών εξτρεμιστικών κύκλων, πολιτικών ή όχι, μπορεί να ζητήσουν την αυτονομία της Χιμάρας υπό το υπόδειγμα της Κριμαίας.

Ο νυν αρχηγός των αλβανικών μυστικών υπηρεσιών, ανήκει στη σχολή του περίφημου αρχηγού των αλβανικών μυστικών υπηρεσιών Γκαζιντέντε της περιόδου 1992-97

που αναγνωρίζεται και ως αρχιτέκτονας του σύγχρονου ανθελληνικού δόγματος στην Αλβανία.

Ο Λίκα δεν έδωσε περισσότερες πληροφορίες και εξηγήσεις. Το γεγονός, από κοινού με την τελευταία 25-χρονη εμπειρία, μαρτυρεί ότι πρόκειται για προσπάθεια χειραγώγησης της αλβανικής κοινής γνώμης.

Είναι γεγονός ότι οι εκπρόσωποι της εθνικής ελληνικής μειονότητας στην Αλβανία δεν εξέφρασαν δημοσίως καμιά επίσημη πρόταση για τη δόμηση των μειονοτικών ζωνών στο νέο χάρτη διοικητικής διαίρεσης της χώρας. Είναι ωστόσο έκδηλη η ανησυχία τους για την ανάγκη σεβασμού των αρχών του αλβανικού συντάγματος, κατά τις οποίες οι δήμοι των μειονοτικών περιοχών θα πρέπει να αποτελούν μονάδες σε μια γεωγραφική περιφέρεια.

Στο σκεπτικό αυτό η δήλωση Λίκα φαίνεται ότι σκοπεύει να οπλίσει τον αλβανικό εθνικισμό και εντός των επίσημων θεσμών, ώστε να επικαλεστούν ύψιστες εθνικές ανάγκες για να μη εφαρμοστεί το ίδιο το αλβανικό σύνταγμα. Όπως είναι γνωστό η περιοχή της Χιμάρας πουλάει αρκετά τα τελευταία χρόνια στη σκακίερα του αλβανικού ενθελληνισμού.

Ταυτόχρονα, μια τέτοια δήλωση σκοπεύει να εκφοβίσει τους Έλληνες ώστε να κάνουν εκπτώσεις στα δίκαια αιτήματά τους. Το ίδιο σενάριο έχει παιχτεί και σε παλιότερες περιπτώσεις όταν οι Έλληνες καλούνταν να διεκδικήσουν και κατοχυρώσουν καίρια εθνικά δικαιώματα, όπως το 1993-94, 1997, 1999 κλπ.

Η δήλωση Λίκα έρχεται επίσης, μερικές μέρες μετά από τη γνωστοποίηση σε πολλά αλβανικά ΜΜΕ των δηλώσεων του πρώην αρχηγού των μυστικών υπηρεσιών της Αλβανίας, Φάτος Κλιόσι, στην αλβανο-αμερικανική εφημερίδα ILLYRIA, ότι η επιρροή του ελληνικού κράτους στην Αυτοκέφαλη Εκκλησία της Αλβανίας, κάνει την τελευταία πιο επικίνδυνη για το αλβανικό κράτος από τη δράση των εξτρεμιστών ισλαμιστών. ΤΕΛΟΣ

## **Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/46732/>

### **Shembja e feudalizmit në universitet**

09.05.2014

Raporti i parë i Komisionit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor, ose i Komisionit Gjonça, i siguroi reformës për arsimin e lartë një draft të plotë dhe të qartë ku mund të mbështetet strukturimi i strategjisë për perspektivën e kësaj fushe thelbësore për ardhmërinë sociale dhe ekonomike të vendit. Dy argumentet bazë të këtij drafti-platformë janë: analiza e gjendjes dhe propozimet për reformim. Analiza e gjendjes së krijuar në arsimin e lartë përbën një skanim të plotë dhe të imët të çdo indi e strukture të tij. Ky proces provoi me argumente të pakundërshtueshme “kënetëzimin” e këtij sistemi, i cili imponon edhe reformimin e thellë të tij. Shkaqet e kënetëzimit të IAL-eve (Institucionet e Arsimit të Lartë) raporti i konstaton në dy drejtime kryesore. Janë produkt i sistemit, si edhe i autoritetit drejtues. Si hallkë ndërlidhëse midis tyre raporti gjen korrupsionin dhe në përgjithësi shpërdorimin e detyrës. Drejtuesit, jo vetëm që u bënë pjesë të sistemit, por edhe kontribuuan në efektshmërinë kënetëzuese të tij. Mangësitë e ligjit u bënë më penguese “nga moszbatimi i tij”. Moszbatimi është rezultat i “shkeljeve njerëzore; dhe më e rëndësishmja, është rezultat i mënyrës jofunksionale të vendimmarrjes dhe mosndarjes së funksioneve. Raporti bëhet edhe më konkret kur thekson se plotfuqishmëria e drejtuesve të lartë ka sjellë arrogancë në drejtim dhe suprimim të të gjitha të drejtave dhe vendimmarrjes në njësinë bazë (departamentin) dhe presionin mbi vendimmarrjen në nivele të ndryshme, si administrative ashtu dhe akademike si, senatet, këshillat e fakulteteve dhe këshillat e Profesorëve. Në mënyrë të qartë, në vend që të drejtojë organizmi, drejton individi. Raporti ngarkon me përgjegjësi të dorës së parë mënyrën e drejtimit nga ana e rektorëve dhe organizmave të tjerë drejtues në IAL-e, të cilët “kanë krijuar, në radhë të parë, mungesë efikasiteti në drejtimin e institucioneve, mundësi për keqpërdorim financiar të fondeve, sie dhe një “kënetëzim” në zhvillimin e universitetit”.

Autoritetet drejtuese në IAL-et publike u bënë pjesë e sistemit kënetor edhe për shkak se ishin pjesë e sistemit politik e qeverisës të vendit. Në dy zgjedhjet e para, brenda sistemit, të organizuara në IAL-e, rektorë fitues dolën njerëz pranë forcës politike qeverisëse. Amendimi i ligjit pak para zgjedhjeve të dyta në IAL-e u dha atyre mundësi të përsëritnin fitoren në shifra absolute. Raporti më të drejtë vë re se “midis të tjerave, kjo vjen edhe sepse drejtuesit kontrollojnë në forma të ndryshme zgjedhjet në këto organizma”. Ajo që nuk e thuhet hapur në raport, por që përbën një realitet, sidomos në universitetet periferike, është se këta drejtues të lartë (rektorët dhe dekanët) kanë ngritur qarqe të mbyllura “të zgjedhurish” për të gjitha nivelet drejtuese, që u sigurojnë atyre kontrollin e plotë dhe autarkik të jetës universitare, si akademike ashtu edhe financiare. Nga ana tjetër, në kësaj sistemesh të mbyllura “drejtuesish”, ka të tillë që kanë projektuar trashëgimin e karrigeve nëpërmjet një rotacioni po brenda sistemit të tyre të mbyllur. Për këtë kanë ngritur edhe një sistem votash, që sipas tyre, ua garantojnë këtë rotacion. Mënyra e krijimit të këtij sistemi “garant” votash mund të cilësohet si përfshirje në një faj kolektiv.

Ky konstatim nuk është thjesht rrjedhim logjik i asaj që konstaton raporti se drejtuesit kanë përgjegjësi primare në “kënetëzimin” e IAL-eve, porse edhe pajtimi i stafeve akademike me këto situata të ujit të ndenjtur është pasojë e krijimit të privilegjeve të pamërituara, në rekrutimin në punë, në marrjen e titujve dhe gradave shkencore, në përfshirje në projekte e borde, diferencime në punën akademike etj. Kjo situatë

përshkruhet kështu në raport: “Kjo mënyre zgjedhjeje, si një politikë populiste, që kënaq të gjithë me shkelje të meritës dhe standardeve akademike, nuk ka në bazë të saj objektivitetin”. Kjo do të thotë se referimet te termi i autonomisë, përbëjnë një abuzim lehtësisht të konstatueshëm në elementë të tillë qenësorë në drejtimin dhe jetën e IAL-eve, siç janë zgjedhjet e përlogaritura (manipuluara), shkeljet e ligjit, lulëzimi i korrupsionit, fiktiviteti i dijeve, braktisja e shkencës, trajtimi arrogant i mendimit ndryshe, stimulimi i mediokritetit dhe shpërftyrimi i meritokracisë dhe deri te trajtimi i IAL-eve si pronë private (gjithmonë në emër të autonomisë). Konstatimet e raportit në lidhje me përgjegjësitë e autoriteteve drejtuese, sidomos rektorë-dekanë (se departamentet janë eliminuar) për situatën e nderë të IAL-eve është e tillë që po të konkretizohet në emra e mbiemra, do të kishim të bënim me ndëshkime shumë të renda. Por çfarë ndodh? Filozofia e raportit i sheh masat për eliminimin e pasojave shumë të renda, që rrjedhin nga përgjegjësia drejtuese, te argumenti i reformës, ose i reformimit të sistemit. Masat e propozuara për eliminimin e aktorëve të instalimit dhe efektivitetit shkatërrues të këtij sistemi, nuk janë të qarta dhe aspak efektive.

Në një masë të dukshme reforma kultivon pandëshkueshmërinë e faktorëve përgjegjës. Kjo do të thotë se të pretendosh ngritjen e një sistemi të ri pa ngulmuar në eliminimin e faktorit përgjegjës për këtë sistem është njësoj sikur të pranosh paraprakisht se efektshmëria e reformës është e rrezikuar në masën mbi 50%. Ose e thënë ndryshe, lejon personat përgjegjës për situatën falimentuese të IAL-eve, të zbatojnë një reformë që bie ndesh me interesat e tyre të deritanishme. Për këtë arsye, është e domosdoshme që të paktën të radikalizohet propozimi në raport për sigurimin e stafit drejtues në IAL-e (publike). Duhet konsideruar i drejtë sistemi i zgjedhjeve sipas profileve (që për drejtuesit akademikë të mos duhet vota e administratës apo e studentit.) Por që të garantohet objektiviteti dhe liria e zgjedhjeve duhet medoemos që një autoritet pas një mandati të caktuar, të mos ketë të drejtë të kandidojë në mandatin pasardhës për asnjë lloj posti drejtues, (veçse për organe drejtuese).

Një masë e tillë heq mundësinë e komprometimit të votës nga ana e autoriteteve drejtuese gjatë ushtrimit të mandatit dhe krijon premisa për ushtrimin e plotë të lirisë akademike nga ana e stafit akademik, si dhe për vendosjen e meritokracisë dhe konkurrencës akademike e shkencore në pozita të shëndosha e stimuluese. Po kështu, një masë e tillë, jo vetëm që në stadin e tanishëm eliminon atë klasë drejtuesish me përgjegjësi të renda morale, akademike e penale, jo vetëm që çliron IAL-et nga ndikimet politike të së shkuarës (apo së ardhmes), jo vetëm që eliminon strukturat rezistuese të interesave (në përgjithësi okulte) në implementimin e reformës së re, por nga ana tjetër, i hap rrugë futjes në drejtim të gjakut të ri dhe riciklimin e forcave të afta sipas meritokracisë. Gjithashtu, për eliminimin e mundësisë së kontrollimit të organeve kolegjiale nga autoritetet drejtuese, duhet të ndahet posti i drejtuesit të organeve kolegjiale (senati akademik, këshilli i fakultetit, departamenti) nga autoritetet drejtuese përkatëse (rektor, dekan, përgjegjës i njësisë bazë). Drejtuesit e organeve kolegjiale duhet të zgjidhen nga anëtarët e zgjedhur të këtyre organeve dhe duhet të kenë kompetenca të caktuara në krye të tyre. Ndërsa autoritete drejtuese duhet të zgjidhen nga stafi përkatës akademik.



## **Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/47099/>

### **PD-ja dhe strategjia e saj e drogëzimit**

15.05.2014

Një fjalë e urtë popullore greke për një fshatar që shkon te piktori për të porositur një ikonë të Krishtit thotë: “Duke dashur i pagdhenduri dhe duke mos dashur piktori, vish edhe ti o Krisht, këpucë të kuqel!”. Logjika e një realiteti të tillë po i imponohet vendit ditët e fundit me sebep avionin e drogës në Divjakë. Elementi “drogë” po instrumentalizohet për ta faktorizuar si argument mbisundues social në vend, për përfitime të njëanshme politike. Mbi këtë parim interesat reale të vendit e të shoqërisë mbeten edhe një herë jetimë, madje para momenteve të një rëndësie historike në marrëdhëniet e vendit me botën e qytetëruar. Pra, përfitimi i ngushtë politik promovohet mbi çdo gjë tjetër.

Nga ana tjetër, ky sebep lejoj leximin e skemës se si funksionojnë këto interesa dhe qëllimet e tyre. PD-ja, nën presionin e situatës së brendshme në parti, të humbjes së shumë privilegjeve, të frikës së ndëshkushmërisë për përgjegjësi personale faji ndaj shtetit, xhelozisë nga sukcesi i mundshëm i qeverisë etj, e detyroi atë që të hedhë në fushë betejë të gjitha arsenalet e veta, të motivuara në qëllimin ekstrem të dorëheqjes së qeverisë. Opozita e di mirë pamundësinë e arritjes së këtij qëllimi. E kupton gjithashtu se po humbet edhe atë përfitim të pakët politik që i solli rastësia e avionit të Divjakës.

Megjithatë, ajo këmbëngul. Por cilat do të ishin disa nga arsyet dhe objektivat e këtij aksioni nga ana e flamurbajtëses opozitë. Së pari, lidhshipi i opozitës kërkon të eksportojë krizën e vet të brendshme dhe të arrijë një unitet të brendshëm në radhët e opozitës. Në lidhje me këtë krizë po provohet se edhe vetë Berisha në opozitë, nuk do të mund të mbante të bashkuar PD-në. Berishizmi si mentalitet dhe praktikë është bërë mënyrë e të bërit politikë nga shumë eksponentë në gjirin e kësaj partie. Ata as mund të preken, as mund të imponohen dhe s’mund t’u kërkohej kontribut jashtë interesave të tyre. Aq më tepër kur ndjehen më të fuqishëm se kreu aktual i PD-së. Lidhshipi i PD-së mendon se duke e tërhequr opozitën në një lëvizje ekstreme antiqeveri, do të mund të krijojë pas vetes në një lëvizje uniteti gjithë opozitën.

Mirëpo, fakt është që kjo lëvizje e nisur para disa javësh, po mbetet pronë e një numri fare të vogël eksponentësh rreth udhëheqjes së re të PD-së. Pjesa tjetër është në hije. Duket se ndjek situatën nga larg dhe pret të përfitojë po për vete. Të njëjtën gjë bëjnë edhe partitë aleate në opozitë. Kjo lidhet edhe me faktin se instrumentet e zgjedhura nuk investojnë në zgjidhje konstruktive demokratike, por gjenerojnë mentalitete penguese, izoluese që çojnë domosdo në rrugëdalje destruktive. Ata që mund të tërheqë pas vetës udhëheqja e PD-së në këtë aksion, janë militantë të thjeshtë të saj, por në përmasa të tkurrura. Shumë prej tyre janë akoma pjesë e administratës publike. Të tjerë janë nën ndikimin e eksponentëve të distancuar brenda në PD. Ata që kanë probleme me drejtësinë zgjedhin distancimin.

Shumë e kuptojnë se qëllimi i shpallur në këtë lëvizje është një iluzion, ose fsheh diçka tjetër që nuk lidhet me interesat e tyre apo të partisë që militojnë etj. Së dyti, opozita nëpërmjet këtij aksioni politik kërkon të krijojë një barrierë mbrojtëse të interesave të veta të djeshme. Kjo barrierë ka të bëjë me neutralizimin e ndëshkushmërisë ndaj eksponentëve të vet me penalitete të ndryshme nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, ruajtjen e pozitave të saj në strukturat e shtetit. Deri tani kjo ka funksionuar, madje shumë mirë. Ky konstatim ka të bëjë edhe me objektin konkret, drogën. Opozita është e ndërgjegjshme se aksioni i saj antidrogë nuk lidhet me deklarinë e fajësisë së qeverisë,

sesa me përpjekjen për të pafajësuar vetën. Opozita është gjithashtu e ndërgjegjshme se fenomeni drogë në Shqipëri do të jetë i pranishëm për një kohë të gjatë, ndaj ajo kërkon të ruajë pozitën e saj në kontrollin e tij.

Ajo i njeh shumë mirë përmasat e këtij fenomeni, përderisa nën tolerimin dhe stimulimin e saj, fitoi përmasa që vërtet e shqetësojnë Evropën. Ajo e ktheu fenomenin në një instrument zbutjeje të problemit social të krizës ekonomike. Shfrytëzoi për këtë futjen në kanalet e tregut të parave të pista, ndërsa në aspektin shoqëror, lejoi punësimin në këtë sektor të mijëra njerëzve. Imponimi i qeverisë për të luftuar fenomenin drogë, i jep pse jo, shpresë opozitës se do të sjellë vështirësi ekonomike dhe sociale, gjë që i hap asaj terren veprimi politik. Por, sado kontradiktore të duket, opozita tregon se ajo ka filluar të trembet nga çmontimi i strukturave të veta në këtë fushë. Dihet se brenda pozitës ka klane që funksionojnë sipas mentalitetit të opozitës së sotme, atë të nënshtrimit të shtetit për përfitim personal. Kjo krijon terren akoma më të përshtatshëm që strukturat e krimit të organizuar të ndryshojnë lehtësisht, e të kërkojnë garanci veprimi të pushtetarët e rinj. Aq më tepër, që një pjesë e strukturave të pushtetit të djeshëm të opozitës së sotme kalojë me pozitën e tanishme. Përvoja ka treguar se kjo përbën momentin më delikat dhe më të rrezikshëm.

Ndërrimi i duarve në trafikun e armëve me Kosovën e Maqedoninë në vitet 97-99 u shoqërua me një përgjakje të llahtarshme dhe me një gjakmarrje politike ende të hapur. Kriminaliteti i rritur së fundmi në vend duhet konsideruar si pasojë e këtij tranzicioni, gjë që kthen në domosdoshmëri gatishmërinë e strukturave adekuatë shtetërore për parandalimin e zgjerimit të mundshëm të fenomenit. Lufta e opozitës me armë heshtën e vet të drogës i drejtohet qeverisë për të krijuar në radhët e saj pështjellim të mundshëm. Sado të duket që ky sulm shkaktonte pozita fenomenin e llogores e të kazermës, duket se mërmërimave të pakënaqësisë në PS po u shtohet edhe fërkimi i duarve. Ndërsa te masa e gjerë e mbështetësve të PS-së vihet re një tolerancë jo dhe aq ngushëlluese në lidhje me premtimet e qeverisë ndaj votës së tyre. Drogëzimi i jetës shoqërore e politike në vend synon gjithashtu të prishë procesin e finalizimit të marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE, por duke e njollosur imazhin e vendit.

Në këtë pështjellim, opozita parapëlqen një çarje të mundshme midis Ramës e Metës dhe jo thjesht për të dobësuar aleancën qeverisëse, por edhe për t'i prerë hovin një rryme të paprerë të njerëzve të saj drejt politikës së Metës. Ajo që duhet shënuar së fundmi, është fakti se kalimi i ditëve po ftoh arsyen, e cila po mund emocionet faktorët e ndryshëm që u bënë pjesë e fenomenit të drogëzimit të jetës publike në vend. Ata po bëhen më të mençur e më të arsyeshëm. Kryeministri Rama në deklaratimet e veta publike mbajti serish linjën emotive e të sinqeritetit personal si mënyrën më e mirë për të treguar, jo thjesht se ai vetë dhe stafi që drejton nuk ka asnjë lidhje me fenomenin drogë, por edhe vendosmërinë e luftës kundër saj. Faktori ndërkombëtar gjithmonë e më shumë tregon një angazhim duke theksuar se amplifikimi i ngjarjes me avionin e drogës dhe helmimi i jetës shoqërore e politike në vend është i padenjës. E gjithë kjo situatë po i heq çdo mbështetje aksionit politik të opozitës. Mirëpo, këmbëngulja e saj në këtë kauzë pa mbështetje kultivon premisa që ajo të ndjekë rrugëzgjdhje radikale, gjë që do të ishte një skenar i keq si për të ashtu edhe për vendin.

**Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/47678/>

**Protestë për të provuar ekzistencën**

24.05.2014

Pse harxhon kaq shumë energji opozita? Nëse ajo do të ishte e ndërgjegjshme se përbën një aset kombëtar, vështirë se do të konsumohej aq negativisht, për vete në veçanti dhe për vendin në përgjithësi. Nuk bëhet fjalë për harxhime monetare apo për vënien në provë të pasuesve, por për harxhime energjish që e nxjerrin atë nga misioni politik opozitar, e shmangin nga roli institucional duke e devijuar në rrugë, zbehin dhe konsumojnë moralin politik brenda saj. Një analizë e thjeshtë faktesh është shumë bindëse për këtë konstatim. Lideri i PD-së, Basha deklaroi më se një herë se qëllimi politik i lëvizjes antidrogë është largimi i Ramës si kryeministër. Mirëpo, për këtë zgjedh një rrugë joinstitucionale. Që Rama të largohet nga posti i kryeministrit, institucionalisht duhet shprehur Parlamenti me shumicë votash.

Opozita është e ndërgjegjshme që kjo është e paarritshme në parlament. Atëherë, gjeti një kauzë për të kërkuar dorëheqjen e Ramës për përgjegjësi të karakterit moral. Për këtë klasifikoi problemet e drogës dhe të krimit të organizuar si çështje kombëtare, si pretekste për të mobilizuar njerëzit e vet nga i gjithë vendi në shesh. Por, nuk ka arsye për ta bërë këtë zhurmë, pasi Rama ia hodhi opozitës dorashkën në Parlament. I kërkoi asaj që të nxjerrë një fakt të vetëm të përfshirjes së tij me trafikun e drogës dhe nëse kjo gjendet e vërtetohet, ai do të japë dorëheqjen, madje do të largohet jo vetëm nga politika, por edhe nga vendi. Nëse opozita është kaq e bindur në kërkesën e saj për largimin e Ramës me pretekstin e fajit të tij për drogën, nuk është nevoja të konsumojë kaq energji apo të bëjë kaq shumë zhurmë, por të faktojë qoftë edhe një nga pretendimet e saj. Pas kësaj ka të drejtën morale të kërkojë, edhe me protesta, edhe me greva, edhe me mjete të tjera demokratike, dorëheqjen e Ramës.

Së dyti, Basha e etiketoi lëvizjen antidrogë si një çështje kombëtare. Të gjithë jemi dakord që droga dhe krimi i organizuar janë fenomene shkatërruese dhe mbytëse për cilëndo shoqëri. Por, a ka të drejtën morale opozita e sotme të marrë flamurin e kësaj beteje? Përgjigja është negative, përderisa ajo nuk nxjerr, nuk dënon, nuk lufton përgjegjësit, fajtorët dhe faktorët brenda saj, të pleksur në mënyrë shumë të trashë me këto fenomene. Ajo tregon se zotëron informacion shumë më të detajuar se qeveria për këtë fenomen dhe nuk ia jep qeverisë për të venë në provë gatishmërinë e saj për të luftuar këtë lloj krimi të rrezikshëm. Por në mënyrë ironike i thotë: “Po ti a e ke këtë informacion që kam unë?”. Përderisa deri tani nuk propozon asnjë masë konkrete apo bashkëveprim për ta luftuar krimin e organizuar, tregon vetëm se kërkon një përfitim politik të pamoralshëm.

Pas kësaj, është shumë e padenjë që ta etiketosh këtë lëvizje si kombëtare, mbarëkombëtare apo panevropiane!

Para dy muajsh, Shqipëria u mbush me protesta popullore kundër qeverisë për armët kimike të Sirisë. Ishte hera e parë që Shqipëria provonte demonstrata paqësore me një pjesëmarrje tepër të gjerë, edhe të përkrahësve më të sertë të qeverisë. Por, më kryesorja ka të bëjë me faktin se ishte protesta e parë jashtë partive politike. Kjo lëvizje jashtëqiti edhe përpjekjen e opozitës së sotme për ta venë nën krahët e veta. Pavarësisht sa e drejtë ishte kjo lëvizje, ajo kishte një kauzë dhe ia doli. Ishte rasti i parë në historinë pluraliste shqiptare që një lëvizje të fitonte në kauzën e vet dhe kjo falë gjithëpërfshirjes pa ngjyrimë politike, nga njëra anë dhe falë ndjeshmërisë së qeverisë nga ana tjetër. Por

ajo nuk u quajt lëvizje kombëtare, edhe pse kishte në themel një problem kombëtar me ndikim edhe në vendet fqinje.

Pra, sa mund të quhet kombëtare një protestë e organizuar me mjetet dhe mundësitë e një partie politike, e cila më së shumti pranon dhe provohet se është e fajshme ndaj asaj që fton pasuesit e saj për të protestuar. Aq me keq kur protestat “kombëtare” kanë në thelb një kërkesë antikombëtare siç është ajo e largimit të një kryeministri të ligjshëm të zgjedhur me zgjedhjet më demokratike (sipas opozitës) të zhvilluara këto 20 vitet e fundit dhe kur vetë opozita nuk bashkëpunon në asnjë nivel për një angazhim kundër krimit të organizuar.

Së treti, dihet se në politikë nuk e hedh një hap pa e ditur hapin tjetër. Për çudinë e të gjithëve, lideri i PD-së thotë vetëm gjysmën e qëllimit të vet të përmbledhur në fjalët: “Rama ik!”. Ai nuk ka përgjigje për hapin e mëtejshëm se kush do ta zëvendësojë Ramën. Aq më shumë demotivohet kauza e opozitës kur e anatemon qeverinë si shumë të rrezikshme kombëtarisht, por nuk pranon të kërkojë zgjedhje të reja, ose nuk ofron asnjë zgjidhje tjetër, që realisht do të thotë se parapëlqen kaosin. Pra, evidentohet fare qartë se qëllimi i opozitës nuk është ai që deklamohet. E kuptuan edhe ata pasues që morën pjesë në protestën e së premtes. Praninë e tyre në shesh e lidhën me kohën e fjalës së kryetarit të tyre, me mundësinë për të regjistruar praninë e tyre aty dhe me nxitimin për t’u larguar menjëherë pas fjalës së kryetarit, ose në vend që të tregonin entuziazëm, kërkonin një hije dhe në pamundësi për hije natyrale përdorën parullat për t’i bërë hije vetës.

Përvoja e gjatë e historisë njerëzore provon se zhurma që përdor në momente të caktuara, qoftë individ, qoftë grupi, qoftë turma, kanë në themel evidentimin e ekzistencës, ose përballë rrezikut e frikës, ose për të mobilizuar energji përballë ndryshimit të një situatë. Në protestën e opozitës ndodh vetëm gjysma e të parës. Lideri i opozitës tregon frikë dhe kërkon turmën për të bërë zhurmë se kështu do të provojë ekzistencën e vet, me shpresën se turma e pasuesve do të mund të injektojë pafajësinë e liderit.

## **Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/48589/>

### **Ana e errët e debatit për arsimin e lartë**

07.06.2014

Përballë predispozicionit pozitiv të qeverisë për rishqyrtimin e draftit të reformës në Arsimin e Lartë, palët e interesit të evidentuara në debat tregojnë në përgjithësi se po i referohen reformës, ose për rezistence, ose për kompromis, me emërues të përbashkët, mbrojtjen dhe konsolidimin e interesave të ngushta të grupit. Thënë ndryshe palët e interesit nuk tregojnë predispozicion, as për evidentimin e shkaqeve që sollën këtë situatë, as për masat efektive reformuese për të ardhmen. Një konstatim i tillë pohon se klasa “intelektuale” në vend ka devijuar nga misioni i vet në mjedisin më të spikatur për të dhe fatkeqësisht është e identifikuar me procesin deformues të rregullave të lojës të shoqërisë në tregun e lirë. Së pari, debati i deritanishëm për reformën në arsimin e lartë nuk i korrespondon, as situatës dhe as rëndësisë shoqërore të saj. Pjesëmarrja në të është e reduktuar pothuaj te pala e interesit, universitet publik, dhe te disa faktorë të tjerë, kryesisht mediatikë. Në këtë debat nuk u përfshi as klasa politike që fshihet pas kësaj shtate të rendë, as studentët, as “avangarda” tjetër e shoqërisë. Së dyti, drafti i reformës përmban disa pika kryesore: atë të analizës së gjendjes së krijuar në universitete, analizën e kërkesës për rritjen e nivelit akademik (cilësia e dijeve për studentët), përfshirjen e këtyre institucioneve në procesin e kërkimit shkencor, riorganizimin e drejtimit, mënyrën e financimit etj. Debatu nuk e preku thuajse fare problemin më kardinal të reformës, atë që kërkon shndërrimin e studentit nga objekt dhe subjekt shfrytëzimi ekonomik në objekt dhe subjekt dijeshe dhe kërkimi shkencor. Referenca e bërë se tregu i punës do të provokojë rritjen e cilësisë së dijeve, është një abuzim me realitetin. Kjo pasi tregu i punës, sidomos ai i sektorit publik, tregon se po kthehet në mekanizëm të legalizimit të informalitetit të dijeve dhe të korrupsionit me dijet në universitete (private e publike), pasi të njëjta mjete që përdoren në sanksionimin e informalitetit të dijeve, po përdoren nga bartësit e tyre për të fituar supremaci edhe “në tregun e punës”. Të gjithë e kuptojmë, por nuk e thonë, se universiteti nuk është destinacion i të gjithëve maturantëve, as i atyre që kanë para. Por është i atyre që kanë aftësinë dhe mundësinë. (Ata që kanë para mund të provojnë fatin në IAL- e private, por diploma e tyre të jetë e destinuar vetëm për sektorin privatë të tregut të punës). Masivizimi i skajshëm nuk provoi vetëm se universitetet u bënë piramidat e dijeshe, por edhe një mekanizëm për të ulur në mënyrë fiktive papunësinë e moshës 19-25 vjet (së fundi statistikisht treguan se numri i të papunëve me diplomë u rrit mbi 3%). Pra, pranimi i studenteve me kriteret cilësore në universitete, do të çojë në zvogëlimin e numrit të tyre, që do të sjellë automatikisht edhe rritjen e sasisë së parave të investuar për çdo student. Kjo masë do të bëjë që studentët e mirë të mos jenë pengje të studenteve me nivel të ulët dijeshe, por pjesë e konkurrencës për nivel sa më të lartë dijeshe. Shpërndarja e studenteve sipas profileve dhe sipas nivelit akademik të universiteteve në të gjithë gjeografinë e universiteteve në vend, siguron atë numër studentesh, që heq në parim kompromisin negativ pedagog-student, sipas të cilit pedagogu toleron për të ruajtur numrin e studenteve që i siguron në fund të fundit vendin e punës. Ndërsa studenti abuzon me dijen se e ka të garantuar marrjen e diplomës. Shqipëria është vendi i vetëm në botë ku kalueshmeria në universitete është pothuajse 100% dhe në kohë optimale, ku nota mesatare e universitetit është pothuajse më e lartë se ajo e shkollës së mesme! Lufta kundër korrupsionit me dijet në universitete as që preket fare në këtë debat. Ky është tregues që reforma duhet për performancë të jashtme,

por jo për të shpëtuar gjendjen në universitete. Ndodh kështu, sa për shkak të fajit kolektiv në radhët e stafit akademik që vjen nga korrupsioni, aq edhe për shkak se korrupsioni po ndërkall “inteligjencën” tonë në bashkësinë e përcaktuar sipas konceptit të fitimit pa skrupuj, që po kthehet mbisundues në shoqërinë tonë. Në debat nuk u zu fare në gojë, se çfarë do të ndodhë me fenomenin me negativ në Evropë dhe në Botë: me numrin disa herë me të madh të universiteteve për frymë të popullsisë në Shqipëri, në krahasim me vendet e tjera. Shumë nga këto universitete, private, e kanë marrë licencën në shkelje të ligjit. Shumë syresh nuk plotësojnë kriteret në drejtim të stafit akademik. Shumë prej tyre shquhen për inflacion diplomash dhe titujsh akademik të dhënë në kohë rekord etj. Të tjerë nuk kanë asnjë pavarësi akademike, në kuptimin që ose i shërbejnë një krahu të caktuar politik, ose janë pronë politikanësh. Në debat nuk u artikulua asgjë për reformimin e sistemit që siguron autoritetin dhe organet drejtuese në IAL-e. Madje u anashkalua edhe propozimi i bërë në draft-reforme. Në çdo propozim në grup për reformën dukej imponimi i mendimit dhe i interesave të drejtuesve aktualë. Jo vetëm kaq, por në terren po vihet re një angazhim i përsheptuar nga ana e këtyre drejtuesve për përgatitjen që tani të strukturave zgjedhore që do t’u sigurojnë atyre rizgjedhjen në postet e dëshiruara. Ajo që u diskutua me shumicë në debat është mënyra e financimit të IAL-ve. U vunë re dy linja bazë. E para që IAL-et private të mos bëhen pjesë e sistemit të financimit nga shteti, shoqëruar me propozimin që IAL-et publike duhet të sigurojnë tërësisht financimin nga shteti. E dyta, u propozua që të ardhurat nga shërbimet e universitetit ndaj të tretëve, sidomos nga kërkimi shkencor, të mos konsiderohen pjesë e financimit të IAL-ve. Financimet e shtetit për punë kërkimore shkencore të administrohen nga vet universitetet, madje duke minimizuar edhe kontrollin e shtetit. Pavarësisht nga fakti se disa mendim-propozime, siç është rasti i mosfinancimit të IAL-ve private nga shteti, janë të drejta, përsëri në propozimet e profilizuara në këtë drejtim pikaset lehtësisht rezistenca e grupeve të interesit me qëllim fshehjen e realitetit. Fjala është p.sh në drejtim të punës kërkimore shkencore. Në këtë drejtim ka dy realitete. I pari, që justifikon deri në një farë mase pretendimet në debat. Zhvillimet ekonomiko-sociale në vend nuk janë të tilla që të mund të kërkojnë përparësinë e studimit shkencor për të orientuar zhvillimin. Ky realitet është përcaktues në një masë të madhe nga pasiviteti i universiteteve për të lidhur veprimtarinë e tyre me realitetin ekonomiko – shoqëror të vendit. Ajo që e bën këtë realitet më është fakti se në universitete nuk është grumbulluar ajka e forcave të afta për ndërmarrje punësh kërkimoreshkencore.

Një fakt i tillë vë në dukje informalitetin e stafit akademik nëpër universitete. Parë kjo në inflacionin e titujve dhe gradave shkencore, mund të ngrihet problemi i dëmit ekonomik shkaktuar shtetit për kompensimin me paga të këtyre titujve të pamërituar. Mund të diskutohet fakti që prishja e ekuilibrit midis titujve të merituar dhe atyre të pamërituar, në favor të të dytëve, ka shuar sensin e konkurrencës akademike dhe ka zvogëluar në maksimum mundësinë e ndërmarrjes së punës kërkimore shkencore.

## **Nga Panajot Barka**

<http://www.arkivalajmeve.com/Antishqiptare-nuk-eshte-ortodoksia.1047597982/>

<http://shekulli.com.al/48825/>

### **Antishqiptare nuk është ortodoksia...**

11.06.2014

Zhvillimet mediatike që pasuan inaugurimin e katedrales ortodokse në Tiranë me praninë e primatit të ortodoksisë botërore, konfirmuan në ekstremitet konstatimin e Kadaresë te diskursi “letrar”, “Mosmarrëveshja, mbi raportet e Shqipërisë me vetveten”. Antishqiptarizmi i këtij segmenti të rëndësishëm për çdo shoqëri të emancipuar në dukje është në mbrojtje të ortodoksisë në emër të kombëtarisë. Në esencë është kundër ortodoksisë, për shkak të përparimit të saj. Duke iu referuar logjikës së Kadaresë, “furtuna” mediatike kundër ortodoksisë nga ekstraortodoksë, ishte në thelb një tregues “i ndjesisë këmbëngulëse kundër Evropës”. Madje, u përdorën mjete që komprometuan keqas moralin intelektual. Një analizë krahasuese, çon në fatin e Voskopojës dhe simetrinë e kontradiktave të fundit të shekullit të 19-të, dhe fillimshkullit të 20-të, në lidhje me Shqipërinë, ku aktorë ishin faktorët me interesa gjeostrategjike të njohura historikisht.

Qëllimi është krijimi i ndjesisë së fajit dhe inferioritetit të komunitetit ortodoks ndaj “përfaqësuesve të kombëtarësisë”. Para disa kohësh dukej sikur këto qarqe e dëshironin veprën primatit të KOASH-it, Kryepeshkopit Anastas, për ringjalljen e Kishës Ortodokse Shqiptare, por duke e mohuar atë personalisht. Reagimet e fundit treguan se më shumë kanë frikë nga kjo ringjallje e kishës ortodokse. Pra nuk duan as Kryepeshkopin dhe as veprën e tij. Një situatë e tillë, ka provokuar midis ortodokseve shqiptarë autocensurën, e manifestuar nëpërmjet heshtjes dhe e keqinterpretuar si përkrahje e këtyre qarqeve, ose si tolerancë. Ortodokset nuk reagueshin as kur akuzuan besimin e tyre si më të rrezikshëm se fundamentalizmi islamik. Në thelb, këto qarqe bëjnë sikur harrojnë se duke provokuar tolerancën e vërtetë të vendosur midis besimtarëve të feve të ndryshëm në shekuj, tolerancë e cila ka si thelb të shëndoshë, origjinën e përbashkët fetare, mund t’i shndërrojë komunitetet fetare në Shqipëri në pllaka sizmike në veprim.

Më 1, në Tiranë dhe në Shqipëri shkruhej një faqe në historinë e saj, që linte pas rëndësinë e inaugurimit të katedrales si monument. U mblodh gjithë primati i ortodoksisë botërore, i cili kishte shekuj të terë që nuk mblidhej. Takimin, qoftë edhe ceremonial, e kryesonte Patriarku Ekoumenik i Kostandinopojës, i cilin vjen i dyti pas Papës. Në kushtet e krizës globale, ky takim shënjon nevojën e bashkëpunimit e të mirëkuptimit në plan ndërkombëtar. Dhe ky fakt historikë ndodhi në Tiranë disa javë para se Evropa të vendosë r statusin e vendit kandidat. Kisha Ortodokse dha një mesazh të pashembullt drejt kësaj asprate të popullit shqiptar. Për këto qarqe, eklipsuan peshën historike të pranisë së primatit botëror të ortodoksisë me prezencën e një njeriu me veladon, i njohur me emrin Nikoll Marku. U promovua si shpëtimtar i ortodoksisë shqiptare nga primati i ortodoksisë botërore, një njeri të cilin rregullat kanunore të ortodoksisë nuk e njohin për prift. U promovua një njeri që mban të uzurpuar një kishë pronë të KOASH-it. Nikollë Marku i ka humbur të gjitha gjyqet për pronësinë mbi të, megjithatë nuk pranon ta dorëzojë kishën. Argumenti se ai për këtë veprimtari ka marrë leje nga shteti, në rastin e hierarkisë fetare ortodokse është i pavlerë, se bëhet fjalë për një OJQ. Ana tjetër e kësaj përbaltjeje të ortodoksisë nga këto qarqe lidhen me ngatërresën e qëllimshëm midis autoqefalisë dhe puritanizmit (shqiptar).

Në emër të traditës kishtare shqiptare pretendohet për një shkëputje puritane nga tradita kishtare ortodokse në përgjithësi. Sebepe kësaj here u gjet te përdorimi i greqishtes nga drejtuesi i meshës, Patriarku Ekumenik Bartholemeu. Primati Ekumenik mësoi në gjuhën zyrtare të traditës së kishës bizantine, që është gjuha greke. Por u respektua edhe parimi “një besim shumë gjuhë” i zbatuar në perandorinë me jetëgjatë në botë, për të ruajtur harmoninë dhe tolerancën ndërkomunitare të saj. Ndaj, bashkë me greqishten u dëgjua edhe shqipja edhe mbi 10 gjuhë të tjera. Nga ana tjetër, asnjë nga popujt ortodoksë të ish-perandorisë bizantine dhe asaj otomane, pavarësisht nga marrëdhëniet e vendosura me Patriarkanën në momentin e pavarësimit të kishës së tyre, nuk mohuan në vijim tharmin grek. Në raport me Shqiptarinë. Sipas Nathalie Clayer, shqiptarizmi në vitet '70-të të shekullit 19-të ishte “produkt i helenizmit ose si identifikim ose si reagim”. Konkluzioni i ballkanologes franceze, përbën faktikisht edhe thelbin e marrëdhënieve midis helenizmit dhe shqiptarizmit në formim. Në vitet '30-të të shekullit të 19-të, kur Shoqëria Biblike i kërkoi leje Patriarkanës për përkthimin e librave të shenjta në gjuhën shqipe, kjo e fundit e pranoi, pasi besonte se ishte një mundësi që elementi shqiptar, nga më të devotshmit në krah të Perandorisë Otomane, të rikthehej te besimi i krishterë. Në atë kohë, me përjashtim të Greqisë, ajo që përvijohet te popujt ballkanas ishte lufta kundër Perandorisë Otomane. Në këtë drejtim çonte ujë edhe përpjekja e shën Kozmait për të ruajtur ortodoksinë nëpërmjet gjuhës së saj zyrtare –greqishtes, ndaj rrezikut të përhapjes së mëtejshme të islamit në tokat e perandorisë otomane. Iluminizmi i tij shkonte përkrah idesë së Riga Fereut për bashkimin e të gjithë popujve të Ballkanit kundër Perandorisë. Po kësaj ideologjie i shërbente dhe Voskopoja, e cila në bashkimin e popujve të krishterë kundër Perandorisë Otomane nuk mund të mos vinte re elementin shqiptar dhe si të tillë nuk mund të mos stimulonte gjuhën e tij, ashtu siç bëri edhe për popujt e tjerë, duke botuar libra e fjalorë me bazë greqishten. Mirëpo, duhet venë re se, nëse Ali Pasha e dogji Voskopojeën se konkurronte Janinën, shkatërruesit e mëvonshëm të saj, të shpallur heronj, nuk kishin argument tjetër veçse rrezatimin e saj multietnik ortodoks, zhvillim që trembte shumë Perandorinë Otomane. Duhet thënë a se themeluesit e shqiptarizmit në shekullin e 19-të ishin kryesisht ortodoksë. Aktivizimi i tyre për dekada të tera, solli promovimin e krishterimit ortodoks shqiptar dhe në vijim promovimin e gjuhës shqipe si element bazë të identifikimit kombëtar. Pra, në periudhën e gjatë deri në ditën tona të krishterimit ortodoks, tharmi grek është i pamohueshëm. Nëpërmjet Bizantit iu injektua Perëndimit dhe Lindjes dhe qëndron në themelet e ortodoksive të kombeve e shteteve. Ortodokset shqiptarë, pavarësisht nga arsyet, u treguan punëtorët më të mëdhenj në shërbim të kombit të tyre. Në këtë aksion të gjatë historik ata asnjëherë nuk i pengoi as të qenit ortodoksë e as të pasurit lidhje me traditën helene. Ahmet Zogu u mbështet pikërisht te ata për të ndërtuar shtetin e parë shqiptar. Të njëjtën gjë bëri edhe sistemi komunist. Hoxha, kur i duhej të identifikonte Shqipërinë me Perëndimin, i tregonte asaj pikërisht kulturën ortodokse shqiptare. Sot, kisha ortodokse e ka përparimin e saj të padiskutueshëm. Qarqet që i prodhojnë të njëjta shkaqe historike, janë shfaqur dhe veprojnë kundër saj. Veprimi i parë ka të bëjë me lejimin e shkatërrimit përfundimtar të traditës shekullore të kulturës ortodokse në vend. Veprimi i dytë ka të bëjë me pengesën, diskriminimin dhe zhvlerësimin si antishqiptare të arritjeve të sotme të Kishës Autoqefale Shqiptare.



Reagim nga Arben Llalla

<http://shekulli.com.al/48923/>

**Z. Barka, ju rrëfej “ortodoksët”**

12.06.2014

Më 11 qershor, profesori i katedrës së gjuhës greke në Universitetin e Gjirokastrës, prof. dr. Panajot Barka, në gazetën Shekulli, botoi një shkrim me titull “Antishqiptare nuk është Ortodoksia...”. Ai ngre shqetësimet e tij për zërat kundër pranisë së përvetshme të kryepeshkopit të Shqipërisë, Hirësisë së tij, Anastasit dhe deklaratave antishqiptare të Patriarkut serb, Irinej. Z. Barka, që në fillim të shkrimit të tij, e nis me titullin provokues sikur ortodoksinë shqiptarët e kanë kuptuar si antishqiptare, por në të vërtetë i rikujtoj z. Barka se shqiptarët janë ata që e sollën ortodoksinë në Ballkan, te grekët, serbët dhe bullgarët. Shenjtorët e parë të ortodoksisë ishin shqiptarë, por është gjë tjetër që Greqia dhe Serbia i përvetësuan këta shenjtorë. A është ortodoksia antishqiptare? Mendoj që pyetja nuk duhet shtrohet a është ortodoksia antishqiptare, por a janë ortodoksit sllavë dhe grekë antishqiptarë? A e keqpërdorin sllavët dhe grekët ortodoksinë për interesat e tyre shtetërore? Nëse do t’i referohemi historisë së kombit tonë, ushtritë greke e sllave me kryqin në dorë dhe në emër të kishës ortodokse kanë kryer masakra mbi popullsinë e pambrojtur shqiptare, qoftë muhamedane apo të krishterë. Kujtesën e kemi të freskët për luftën në Kosovë dhe masakrat e ushtarëve serbë që i bënë në kryqin ortodoks, pa folur për ato vrasjet e shekujve 19-20. Profesori Panajot Barka, në opinionin e tij tenton të na ringjallë të vdekurit e mëdhenj grekë, që t’i shfrytëzojë për nevojat e veta kombëtare, duke i rrëfyer në versione në të cilat nuk kanë qenë kurrë. Ju, z. Panajot Barka, në shkrimin tuaj përmendni Riga Fereun, i cili në poemën e tij i bën thirrje popujve të Ballkanit që të ngrihen kundër Perandorisë Osmane. A e dini ju z. Barka se Riga Fereu nuk e përmend asnjëherë fjalën grek apo helen dhe shqiptarët i quan arvanitas? Përse? Ju në shkrimin tuaj më tej shkruani se në Tiranë dhe në Shqipëri u shkrua një faqe në historinë e saj, që linte pas rëndësinë e inaugurimit të katedrales si monument dhe se u mblodh gjithë primati i ortodoksisë botërore, i cili kishte shekuj të terë që nuk mblidhej. Z. Barka lëroni përrallat për studentët tuaj që diplomohen duke ngrohur karriget nëpër kafene, sepse e vërteta është krejt ndryshe. Po ju sjellë disa fakte ku është mbledhur Primati Botëror i Ortodoksisë. Ai është mbledhur më 19 nëntor në Serbi, me rastin e vdekjes së Patriarkut Pavlo. Më 5 tetor 2013, në Beograd u mbajt mesha me rastin e 1700-vjetorit të nënshkrimit të Ediktit të Milanos, 313. Kjo meshë u festua në katedralen e Kryeengjëllit Mihal me nisjen e lutjeve nga Patriarku i Stambollit, Bartholomeu. Më 6 tetor 2013, për në qytetin e Nishit, në vendlindjen e Kostandinit të Madh ata u mblodhën sërish. Falja e ditës u krye në kishën e saponërtuar të Shën Kostandinit dhe Elenës. Pas ritualeve fetare, Patriarku i Serbisë, Irinej u ndau medalje të arta të akorduara nga Sinodi i Shenjtë i Kishës së Serbisë, “Perandori Kostandin”, drejtuesve të kishave ortodokse botërore, midis tyre dhe kryepeshkopit të Shqipërisë, hirësisë së tij, Anastas Janullatosit. Më 7 tetor 2013, krerët ortodoksë si, Patriarku i Stambollit Bartholomeu, Patriarku i Jerusalemit, Theofili III, Patriarku i Rusisë, Kirili, Patriarku i Serbisë, Irineji, Kryepeshkopi i Qipros, Krisostomos, Kryepeshkopi i Shqipërisë, Anastasi, Kryepeshkopi i Vrashavës, Sava, vazhduan turneun për në kryeqytetin e Malit të Zi, Podgoricës, ku mbajtën meshën në katedralen e “Ngjalljes së Shën Sotirit”. Mund t’ju sillja edhe fakte të tjera për takimet e Primitit Botëror të Ortodoksisë, por mjaftojnë këto të kohëve të fundit. Më tej, z.Barka na amnistion Shën Kozmain, ku sipas tij, ai përhapte ortodoksinë në gjuhën zyrtare greke ndaj rrezikut të përhapjes së mëtejshme

të islamit në tokat e perandorisë otomane. Ky nuk është argument për ta amnistuar Shën Kozmain të shqiptarët, sepse e dimë fare mirë misionin e tij. Shën Kozmai është babai i përhapjes së greqizmit për asimilimin e shqiptarëve (arvanitasve) dhe për asimilimin e shqiptarëve në Shqipëri. Këtë na e dëshmojnë shumë dokumente historike, si edhe shkrimtari grek, Thoma Paskidhus. Shën Kozmai përhapi gjuhën greke nga Suli i Çamërisë e deri në Krudhën e Skënderbeut. Një dokument për Shën Kozmain i prof. Delvinës botuar në një të përditshme shkruante: “Dërgojini fëmijët tuaj të mësojnë greqisht për arsye se kisha jonë është greke. Dhe ti, vëllai im, po nuk mësove greqisht, nuk mund të kuptosh ato që thotë kisha jonë. Më mirë, vëllai im, të kesh shkollë greke në vendin tënd, se sa të kesh burime dhe lumenj. Cilido i krishterë, burrë apo grua, që më premtan se brenda në shtëpi nuk do flasë shqip, le të ngrihet në këmbë dhe të ma thotë këtu. Unë do t’i marr atij të gjitha mëkatet në qafën time, që nga dita e lindjes së tij deri sot, do t’i porosis të gjithë të krishterët që t’i flasin dhe do t’ia shlyej të gjitha mëkatet. Ai nuk do ta gjente këtë rast sikur të jepte para me mijëra”. (Predikimi 7 drejtuar shqiptarëve të Epirit). Një dokument tjetër për greqizmin e fshatrave shqiptare të bërë nga propaganda e Shën Kozmait janë Frashtani dhe Lugari në Dropull. Frashtani dhe Lugari banohen nga shqiptarë ortodoksë dhe kur kaloi andej Shën Kozmai, deklaroi që këto fshatra duheshin të greqizuar. Ju, profesor Barka në tërë opinionin tuaj nuk përmendët faktin e provokimit të Patriarkut serb Irinej dhe ngritjen e flamurit serb brenda territorit të Katedrales “Ringjallja e Krishtit”, kuu përfaqësuesit e kombeve të tjera që ishin të ftuar nuk e ngritën flamurin e tyre kombëtar atë ditë, duke respektuar mikpritjen shqiptare. Ne, shqiptarët që mendojmë dhe veprojmë me zemër e mendje shqip, nuk kemi frikë nga ringjallja e ortodoksisë shqiptare, por kemi frikë nga asimilimi i ëmbël i ortodoksëve shqiptarë në ortodoksë grekë dhe sllavë. Në përfundim z. Braka, ju rikujtoj që ju nuk e keni të drejtën të diskutoni për ortodoksinë shqiptare sepse s’jeni me kombësi shqiptare. Për ortodoksinë shqiptare lërimi të diskutojnë vetëm shqiptarët sepse ne kemi figura të ndritura që na kanë lënë disa amanete si: “Ne vërtetë kemi bajram dhe pashkë, por Shqipërinë e kemi bashkë”. Prandaj, nuk kemi nevojë për këshilla nga ata që s’ia duan të mirë Shqipërisë dhe shqiptarëve, ku bëni pjesë edhe ju, këtë jua dëshmoj me fakte. Ç’ju lidh juve z. Barka me drejtuesit e disa organizatave ekstremiste greke që luftojnë për aneksimin e jugut të Shqipërisë? Në çfarë cilësie merrni pjesë në festimet për shpalljen e Autonomisë së Vorio Epirit, ku ndodhni në podium në këtë foto me ekstremistin Harrallambos–Babis Karathanos, deputetin Virona G. Polidhoras? Për çfarë qëllimi z. Barka i keni dërguar raport mbi gjendjen e minoritetit grek Institucioneve Ndërkombëtare në vitin 2003, ku përmendni edhe autonominë e Vorio Epirit? Ky raport është përgatitur nga ju, ekstremisti grek Babis Karathanos, A. Soku dhe K. Saferatis.

**Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/48994/>

**Mitologjia s'mund të jetë histori! (përgjigje z. Llalla)**

13.06.2014

Dje shpenzova kohë të çmuar për të vendosur nëse duhet t'i përgjigjesha replikës ndaj një shkrimi në gazetën "Shekulli". Dilema nisej nga fakti se artikullshkruesi i takon niveleve të ulëta në artikullimin e fjalës së lirë, apo dialogut publik. Abuzimin e tij me gjithçka e vë në shërbim të atij lloji "patriotizmi", që si zakonisht, ka për argument të vetëm antihelenizmin. Nga ana tjetër, ajo që serviret si replikë, përbën një vërtetim të atyre që parashtroja në shkrimin tim. Sipas konceptit të artikullshkruesit, ortodoksia shqiptare është grigja që ka për çoban qarqet që artikullshkruesi përfaqëson, ose bën denjësisht pjesë.

Sipas tyre, ata e ruajnë grigjën nga ujqër që ekzistojnë vetëm në fantazinë e tyre, ndërsa grigja duhet të prodhojë qumesht e të sillet kokulur sipas shkopit të tyre. Në shkrimin tim nuk tregova ndonjë interes për Kryepeshkopin, Hirësinë e tij, Anastasit, por iu referova fakteve historike, sesi kur ortodoksia përparon, konsiderohet e rrezikshme. Dhe solla për këtë shembullin e Voskopojës. Po ashtu, me krahasimin midis Patriarkut Bartoleme dhe Nikolla Markut, desha të tregoja se mentaliteti i të paligjshmes dhe i prapambetjes, tenton përfaqësimin tonë, ashtu si me titullin e shkrimit desha të theksoja se antishqiptarë nuk janë ortodoksët, por ata që i duan ata pa identitet aktiv ose gojëmbyllur duke i identifikuar me Greqinë. Artikullshkruesit e tipit Llalla duhet të mësojë, së pari etikën morale që kur bën një replikë publike, duhet t'u referohesh fakteve dhe analizave të artikullit që kundërshton. Nuk u referohesh fakteve që ti ke në mendje apo që të interesojnë për qëllimet e tua. Duhet të mësojë, së dyti, se historia nuk shkruhet e as gjykohet duke filluar nga e tashmja dhe nga interesat e ditës për të shkuar tek e shkuara, por është një proces i kundërt. Në këtë kuptim, historia nuk mund të përdoret si fiksim permanent që të mbajnë të lidhur me anët e saj negative në të shkuarën. Historia është histori. Si një diçka që ndodhi atë duhet ta përdosh në pozitivizmin e saj për të ecur përpara. Në këtë drejtim, popujt e civilizuar i kanë lenë historisë hapësirën e traditës dhe kulturës, të miteve, legjendave, baladave, që i shërbejnë çdo populli për t'u vetëorientuar në aspiratën e perspektivës së tij. Vetëm ata që nuk mund të shikojnë e të shkojnë përpara, përdorin anët negative të historisë për të provuar thjesht ekzistencën e tyre. Pa dashur t'i mësojë askujt historinë, aq më tepër atë fetare, dua të risjell në kujtesë teologun gjerman Adolf von Harnack, sipas të cilit kisha ortodokse, në përgjithësi, është besimi fetar i Greqisë së lashtë, i përshtatur sipas përmbajtjes së Ungjillit. Bizanti, teksa shpëtonte nga vandalët traditën klasike helene, njëkohësisht e adoptonte atë në ngrehinën e saj, për t'ia rikthyer shekuj me vonë Perëndimit, që ky i fundit të realizonte mbi këto arritje Rilindjen. Kjo e vërtetë duhet parë edhe në korrelacionet historike midis helenëve dhe shqiptarëve dhe jo çdo gjë greke duhet parë si antishqiptare, ose dhe me keq, të propagandohet sikur grekët kanë grabitur kulturën shqiptare. Në periudhën e hershme postbizantine, Perandoria Otomane, e cila, ashtu si në shumë drejtime e tjera edhe në organizimin shoqëror "u pushtua" nga perandoria bizantine, për të ruajtur koherencën dhe tolerancën multikomunitare, e ndau atë në "miletë". Rum-mileti, ishin ortodoksët, të cilët, për shkak të traditës, identifikoheshin me grekët. Kjo edhe për faktin, që siç thotë edhe Çabej, grekët që me eposin Dhijenis Akritas, kishin filluar të kristalizonin etnosin e tyre, sipas kuptimit modern të fjalës. Në fundin e shekullit të 18-të, ku vepruan eksponentë të tillë si Shën Kozmai apo Riga Feraios, përplasja brenda Perandorisë Otomane, kishte për bazë arsyet fetare, midis fesë zyrtare, islamit dhe krishterimit, të

përfaqësuar nga rum-mileti. Në atë kohë, po sipas Çabejit, sapo kishte filluar të përdorej emri “shqiptar” për të cilësuar shqiptarët e sotëm. Shqipja ishte një gjuhë që nuk shkruhej. Shqiptarët, ashtu siç përcakton edhe Kadareja, apo studiues si Oliver Schmitt, etj. u bënë shtylla kurrizore e Perandorisë Otomane, aq sa, që në atë kohë, Porta e Lartë i shikonte si trashëgimtarë të interesave të saj në Ballkan. Në këto kushte, një martir i krishterimit, siç ishte Shën Kozmai, përveç greqishtes, nuk mund të përdorte asnjë gjuhë tjetër për të mbrojtur fenë e krishterë.

Shqipja do të fillonte të bëhej gjuhë e fesë disa dhjetëvjeçarë më pas dhe 130-150 vjet më vonë do të bëhej gjuhë e liturgjisë kishtare ortodokse. Përderisa bartësit e shqipes së atëhershme, për karrierë ushtarake dhe privilegje ekonomike dhe politike shndërroheshin në myslimanë, si do të gjykoheshin nga martiri i ortodoksisë që armën e vetme të kauzës së vet kishte gjuhën greke?! Në këtë këndvështrim, pretendimi i sotëm midis kalemxhinjsh që ngjyjnë akoma penën në oturakun e propagandës komuniste, se çdo gjë greke nëpër shekuj ishte antishqiptare, është absurde, ose përdoret, sipas Kadaresë për të fshehur mëkatet tona. Nga ky këndvështrim, përsëri është absurd fakti që fshatra të tilla si Lugari apo Frashtani, që nxorën patriarkë në Kostandinopojë, apo vojvodë në Moldovllahi, shumë shekuj para se shqiptarët të quheshin shqiptarë, që gjuha e tyre ishte greke dhe vepra e tyre e lidhur me Greqinë, të konsiderohen sot e kësaj dite si fshatra shqiptare. Është e vërtetë që shumë banorë të krahinave që myslymanizoheshin, për të mbrojtur besimin e tyre të krishterë, lëvizën drejt zonave ku ortodoksia ishte e garantuar. Dropulli ishte një zonë e tillë. Të ardhurit këtu morën me vete dhe përdorën si mbiemra të tyre emrat e krahinave apo të fshatrave nga vinin. Vendet e origjinës së tyre i përkasin sot kombësisë shqiptare, pasardhësit e tyre në Dropull vazhdojnë të jenë me kombësi grekë. Në Dropull këndohet një këngë. Vargjet e saj, në greqisht, i drejtohen gruas dropullite, nga jodropullitë, që ajo, ditën e Pashkës, të falet në kishë edhe për ata që u detyruan të myslymanizohen me dhunë. Dropulli është konsideruar një mal i shenjtë me manastire e kisha të rrezuara. Asnjë shenjë shqiptarësie nuk gjen në to, ashtu si asnjë nga pretenduesit se dropullitët erdhën këtu diku nga shekulli 18-të-19-të nuk kanë asnjë argument për të treguar se kush ka banuar para dropulliteve në këtë krahinë të mbushur me monumente kulture që nga lashtësia para mikenase. Që në shekullin e 16-të kishte piktorët e vet dhe shkolla piktore ku flitej e mësohej greqisht. Është vërtetuar se dropullitët e sotëm, ashtu si banorë të krahinave të tjerë të Epirit, janë trashëgimtarë të drejtpërdrejtë të trashëgimisë së civilizimit të Dodonës, ashtu siç janë edhe bartës të miteve që tregojnë kalimin, nga kultura e lashtë greke në atë të krishterë. Kohët e fundit, në hullinë e gjykimit të historisë nga e tashmja dhe subjektiviteti nacionalist, dëgjohen teza të tilla që mbijetesa në formën më aktive të polifonisë, përdoret si argument për provuar pronësinë shqiptare mbi mitologjinë dhe kulturën e lashtë greke, mbi Dodonën dhe heronjtë mitikë grekë. Ndoshta, kjo mund t'i shërbejë një konsumi vulgar, por që dëmton, si shkencën shoqërore shqiptare, ashtu dhe të ushqyerit prej këtyre tezave. Përjasjet e Kadaresë në këtë drejtim shumë pak vihen re edhe nga ata që gjithë ditën mburren me artin e tij. Shpëtimi nga kjo grackë është këshilla që jep Schmitt: të çmitizojmë historinë dhe ta shikojmë racionalizmin iluminist të së ardhmes, të çliruar nga emocioni nacionalist.

## **Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/49450/>

### **Lazarati: 200 vjet përdorje politike**

20.06.2014

Krahu politik i drejtuesve ndërkombëtarë për situatën në Shqipëri në vitin e mbrapshtë 1997, qarkulloi në publik idenë se nëse nuk do të ekzistonte dëshira për të bërë shtet të së drejtës, e ardhmja e Shqipërisë do të kishte tri rrugë. Ose një protektorat, (dmth. vazhdimi në forma më të buta i protektoratit të instaluar atëherë), ose të kthehej në një republikë bananesh, ose të zbrazej nga popullsia e tepërt që të mund të jetonin mirë ata që do të mbeteshin këtu. Pak muaj më vonë, pas një vizite të bëftë në Itali, kryeministri i qeverisë së sapodalë nga zgjedhjet e 1997-ës, Fatos Nano, deklaroi në publik këto teza duke provokuar një reagim shumë të ashpër në vend. U konsiderua se ato teza fyenin dhe cenonin rendë integritetin kombëtar. “Zyrtarisht” nuk u zbatua asnjëra nga ato, por në realitet që të tria u vunë në zbatim. Fatos Nano, edhe pse kishte mundësi të instalonte shtetin ligjor në vend, pasi e mori atë nga një pikë fillestare, nuk e bëri. E keqja e mosbërjes së shtetit u bë aq e madhe sa që pas 8 vjetësh, votuesit shqiptarë e harruan vitin e mbrapshtë dhe votuan përsëri Sali Berishën, duke evidentuar njëkohësisht në praktikë se që nga 1991-92-shi, midis Berishës dhe Nanos, me ndërmjetësi ndërkombëtare kishte një komunikim permanent në ndarjen e pushtetit. Në mesin e mandatit të dytë të socialistëve pas vitit 1997 dhe pas “përpjekjeve të dështuara” për hyrjen në Lazarat, Nano bëri “një profeci”:

“Lazarati do të kthehet në Kolumbi dhe Shqipëria në Lazarat”. Sot, pas pak më shumë se 10 vjetësh, profecia e tij është një realitet. Kuptohet, që republika e banave nuk mund të lidhet vetëm me drogën dhe as nuk mund të shihet e veçuar nga “Cossa Nostra” në drejtësi dhe nga rënia e shtetit në përgjithësi. Dhe ky realitet u rrit në një mjedis protektorati, ku politika dhe institucionet e rëndësishme të vendit ishin nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, ku vendi u bë anëtar i NATO-s dhe që tani aspiron integrimin në BE. Ky realitet ka mbetur dhe akoma shqiptarët kërkojnë një orë e më parë të ikin nga vendi. Lazarati, kuptohet, është rasti më provokues. Një analizë më e thelluar në lidhje me Lazaratin tregon se nuk kemi të bëjmë me një rastësi, por me një përsëritje të historisë së keqe të tij. Që kur pashai turk i Gjirokastrës, aty nga fundi i shekullit të 18-të, mori vendimin për të dëbuar masivisht lazaratat e vërtetë, dhe deri në ditët e kronikave të fundit televizive, ky fshat vazhdon të përdoret nga politika. Vetëm në periudhën e Zogut pati një qetësi, por pa qenë vetvetja. Enver Hoxha e përdori për t’i treguar pjesës tjetër të popullsisë fatin e atyre që e kundërshtojnë dhe e shndërroi në njollë të zezë për të siguruar një kontrast më të mirë për ngjyrën “e bardhë” të pushtetit të tij. Pas rënies së komunizmit, politikanët e rinj i këmbyen vuajtjet e komunizmit të banorëve të Lazaratit me një liri të tepruar, për të cilën ata nuk ishin të përgatitur. Në këtë kuptim, politika e përdori sërish Lazaratin, kësaj here duke e shtyrë drejt një faji kolektiv. Më 1994-95, Lazarati u përzgjodh si vendi ku do të aplikohet suksesshëm thirrja e numrit një të shtetit për të kultivuar “bimë industriale” me fitim shumë herë më të madh se bimët tradicionale (!). Fitimi përrallor dhe pushteti i pamasë i parasë ishin kësaj here mjetet e komprometimit të tyre. Politika po kthehej në garanci për ta, por në një garanci që mund t’u siguronte privilegjet vetëm duke i izoluar në paprekshmërinë gjeografike si shtet brenda shtetit. Kuptohet, duhet dalluar fshati nga ai grup pas të cilit rri politika dhe për të qenë skafandër sa më e mirë e politikës, ky grup po përdorte fshatin si mburojë. Wshtë pikërisht kjo lidhje që e bën problemin e Lazaratit një gur prove, jo vetëm për policinë, por edhe për vetë shtetin. Deklaratën e vet në Gjirokastër në ditën e tretë të

ballafaqimit të policisë me banorë të Lazaratit, ministri Tahiri, nuk e nisi me vendosmërinë e policisë për të mbyllur një herë e mirë kapitullin e atyre që guxojnë të qëllonjë kundër saj. Por ai tha se sot po priten fijet e lidhjeve të krimit në Lazarat me politikën në Parlament dhe jashtë tij. Ai shkoi edhe më tutje duke akuzuar drejtpërdrejt ish-qeverinë. Kjo do të thotë se Lazarati është një problem i thellë politik, që ka të bëjë me vet shtetin ligjor. Ai është pjesa që duket i gangrenës së shtetit. Është peta e lakrorit që politikanët nëse do t'u duhet, do të përpiqen ta djegin për të shpëtuar vetveten. Këtë të vërtetë fsheh edhe deklarata e kryetarit të opozitës, se ishte presioni i saj që e detyroi qeverinë të hapte frontin e gjerë të antidrogës. Këtu qëndron edhe tragjedia e banorëve të Lazaratit. Dhe kur kryetari i opozitës tha se betejën e parë e fituam, kjo do të thotë se me Lazaratin ata i lanë duart. Gjithçka erdhi pasi edhe përpjekja për ta ftuar fshatin në konflikt gjaku me shtetin dhe me policinë, dështoi, dhe kjo falë taktikës dhe profesionalizmit të policisë dhe pjekurisë së treguar nga fshati. Qeveria e hodhi dorashkën. Për qeverinë nuk ka kthim prapa. Çdo kthim prapa është i barabartë me fundin e saj dhe humbjen e shpresës për të patur shtet ligjor. Lazarati, edhe pse i konsumon kaq shumë energji shtetit, është vetëm pasoja. Por duke u nisur nga pasoja mund të gjykohen përmasat e shkakut, për të dalë në konkluzionin sesa i kapur është shteti nga krimi i organizuar. Policia do t'ia dalë me Lazaratin. Kapitulli më i vështirë për t'u asgjësuar është shkak: politikanët dhe dënimi i fajtorëve nga drejtësia, vetë fijet e tjera të krimit të organizuar. Vetëm kështu duhet kuptuar edhe rezistenca ndaj policisë në Lazarat. Vetëm kështu duhet kuptuar thirrja e ministrit dhe e qeverisë për të mbështetur veprën e policisë, e cila me përkushtimin dhe maturinë e saj në Lazarat po tregon se morali i zbatimit të ligjit është i mundshëm. Rasti i Lazaratit është një rast i mirë që shteti të tregojë se është i gatshëm të braktisë praktikën e deritanishme antisociale e antiligjore të tij, që fare thjesht mund të cilësohet si instrument për të legalizuar shkelësit e ligjit (ata që ndërtojnë pa leje, ata që nuk paguajnë detyrimet ndaj shtetit, ata që imponojnë amnisti fiskale, ata që politika i nxjerr nga burgu, etj.). Kryeministri Rama, tregon me këtë rast se nuk mund të tolerojë planet e kthimit të Shqipërisë në një republikë bananesh, pavarësisht se gatuesit e këtyre skenarëve mund të fshehin interesa shume të fuqishme. Dhe kjo, në fund të fundit, është detyrë patriotike. Me frontin e hapur kundër drogës dhe krimit të organizuar, kryeministri Rama eliminon reaksionin negativ të opozitës dhe të kundërshtarëve të vet politikë brenda kampit qeverisës. Kuptohet se para nisjes së betejës, rreth vetës kishte këshilltarë që i thanë të kundërtën. Rama guxoi duke marrë parasysh se behet fjalë për rrathë viciozë dhe koka hidrash të fshehura pas kollaresh e jakash të bardha në politikë, e në drejtësi, në administratë publike dhe në interesa ndërkombëtare. Dhe duhet të jetë i kënaqur, se paralelisht po vë re se iniciativa e tij po përkrahet nga shumë struktura të tjera të shtetit dhe të jetës civile, me të parën policinë, që deri dje kishte lidhje me krimin.

## **Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/50188/>

### **Përse rrëmohet në kanalet e së shkuarës?!**

03.07.2014

Akuzat ndaj Greqisë për gjenocid në Tiranë, në ditën e marrjes nga vendi ynë të statusit të vendit kandidat për në BE, më kujtuan fabulën bretkosës me sfurkun të një kolegu grek, të përdorur për të personifikuar marrëdhëniet midis Greqisë dhe Shqipërisë. Sipas kësaj fabule, teksa bretkosa nxirrte ne bregun e përtëjmë të një lumi sfurkun, ky i fundit e pickoi atë. Dihet se në procesin e finalizimit të aspiratës për statusin e vendit kandidat, Shqipërisë i ra fati që kryesimin e BE-së ta kishte fqinja saj, Greqia, e cila veç këtij roli, kontribuoi sinqerisht dhe me seriozitetin maksimal për arritjen e këtij qëllimi. Normale do të ishte që të ndjehej, si zyrtarisht ashtu dhe në opinionin publik, një falënderim ndaj Greqisë dhe veçanërisht, për njerëz të veçantë të saj, që sfiduan edhe rezervat më konsistente në politikën kombëtare greke. Si zakonisht ndodhi e kundërta. Ditën e kurorëzimit të përpjekjeve për këtë ngjarje historike, Greqia, mu në mes të Tiranës, dhe me amplifikim mediatik të jashtëzakonshëm, u përball me akuzën ekstreme të gjenocidit. Në gjuhën diplomatike kjo do të thotë marrëdhënie zero midis dy vendeve. Aq më tepër që një akuzë e tillë bëhet me pjesëmarrjen dhe mbështetjen, qoftë edhe të heshtur, të segmenteve të politikës zyrtare. Aq më tepër që akuza nuk ka asnjë të vërtetë e nuk mbështetet në asnjë instrument politik-juridik dhe historik. Kjo për faktin se viktimat e një konflikti civil ndërkomunitar në një luftë ndërkombëtare, nuk kanë asnjë lidhje me gjenocidin. Aq më tepër që u kundërvihet të gjitha akteve ndërkombëtare dhe atyre midis dy vendeve që rregullojnë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe të bashkëpunimit reciprok. Po ashtu, i kundërvihet vet aktit të marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE. Dhe kjo nuk është një rastësi. Në këta 23 vjet tranzicioni në Shqipëri, Athina zyrtare (nuk flasim për qarqe) ndoqi në mënyrë permanente dhe konsekuente politikën e integritit të Shqipërisë në strukturat euroatlantike, si mënyrën më efektive për zgjidhjen e problemeve të të gjitha natyrave midis dy vendeve dhe për ndërtimin e marrëdhënieve evropiane të fqinjësisë dhe të bashkëpunimit në të ardhmen. Me këto parime, Athina zyrtare neutralizoi edhe rezervat, që kishin përfaqësues të minoritetit etnik grek në Shqipëri në lidhje me respektimin e të drejtave të këtij minoriteti. Kujtojmë se që në vitet 1990-1991, Athina mori përsipër përkrahjen e drejtpërdrejtë të atyre forcave politike në Shqipëri që premtonin vendosjen e rendit demokratik në vend. Përkrahu aktivisht Shqipërinë në anëtarësimin në OSBE, në Këshillin e Evropës, në NATO dhe së fundmi në marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE. Greqia dhe grekët kanë hapur portat e tyre për më shumë se një milion shqiptarë, që për vite me radhë përbënin burimin më të madh të të ardhurave për Shqipërinë. Mbi 400 ndërmarrje ekonomike greke veprojnë në Shqipëri, duke zbutur varfërinë ekonomike të vendit. Greqia është ndër partnerët tregtarë dhe ekonomikë më të rëndësishëm të Shqipërisë. Për këtë Greqi, në mjedise zyrtare dhe sidomos në ato publike, nuk evidentohet një frymë mirëkuptimi, apo vlerësimi pozitiv.

Përkundrazi, evidentohet më shumë kultivimi i një klime dyshimi deri në armiqësi ndaj Greqisë. Bëhet fjalë për një nacionalizëm të tejkaluar, pjellë e ideologjisë komuniste të shartuar mbi nacionalizmat e fillimit të shekullit të kaluar, që frymëzonin interesat gjeostrategjike të fuqive të ndryshme në Ballkan. Ata që e kultivojnë dhe e ushqejnë këtë klimë e kuptojnë shumë mirë që vepra e tyre shkon ndesh me frymën dhe aspiratën euroatlantike të vendit dhe është i patolerueshëm nga institucionet e tyre përfaqësuese. U provua qartësisht gjatë shfryrjeve delirante nacionaliste në prag të 100-vjetorit të pavarësisë dhe të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013. Reagimi i Evropës dhe i

Amerikës ishte i tillë sa që u kthye në shkak kryesor për mosmarrjen e statusit të vendit kandidat në atë periudhë. Pra ajo që vihet re është se politikbërja dhe opiononbërja në Shqipëri, të ndodhura shpesh në të njëjtën llogore, për konsum të brendshëm, apo për përfitime politike të çastit, ose në pamundësi të krijimit të standardëve për një mirëqenie ekonomike, sociale, kulturore e politike europiane, i drejtohen arketipit të nacionalizmit primitiv të armiqve permanentë, arketip, i cili dha efekte maksimale për izolimin e Shqipërisë në periudhën komuniste. Paaftësia e klasës politike dhe intelektuale në vend për të dalë nga klishetë nacionaliste të sistemit totalitar, pasqyrohet dukshëm edhe në rilevimin e sistemeve të identifikimit etnik apo kombëtar. Vazhdon të jetë mbizotëruese paaftësia për t'u mbështetur në vlerat e brendshme pozitive të traditës për të krijuar një sistem referimi vlerash të perspektivës sipas standardeve të kulturës dhe historisë kombëtare të vendeve europiane. Ky boshllëk në vetëpërcaktimin kombëtar po plotësohet me modelin e ballafaqimit me të tretët. Pasi armiqtë e tjerë, ose u zhbënë, ose u kthyen në aleatë besnikë e miq për kokë, Greqia, fatkeqësisht, përbën “armikun” e fundit dhe po kthehet në etalon ballafaqimi për vetëpërcaktimin etnik, sidomos për ata shqiptarë që nuk kanë asnjë lidhje me Greqinë, ose që e njohin me syzat e sistemit komunist dhe nacionalizmit anakronik. Nuk ka zhvillim pozitiv apo negativ, të cilësdo natyre në Shqipëri (zgjedhje politike, bërje kushtetute, trazira si ato të 1997-98, marrëveshje ekonomike apo politike, censuse, reforma territoriale apo arsimore, diskutime mbi etnitë, etj.), ku edhe Greqia të mos jetë sistem referimi apo reagimi negativ nationalist. Shpenzohen energji kolosale, ekonomike, politike propagandistike për t'u mbrojtur nga “armiq” që nuk kanë asnjë pikë kontakti me realitetin e aspiruar europian. Me qëllim, manifestohet një kompleks frike pa objekt dhe me inferioritet të paimponuar nga askush. Shpesh kjo e ka burimin të sforcimi për të deformuar realitetin aktual dhe më shumë atë historik. Madje, shpesh vihen re përpjekje që përmes këtij deformimi, të përvetësohet deri ato gjera që e dallojnë Greqinë, siç është kultura, arti dhe mitologjia e lashtë greke. Dhe gjithçka bëhet për të armatosur atë nacionalizëm të vjetruar por edhe të rrezikshëm për atë që e manifeston; për t'iu kundërvënë të vërtetës së realitetit historik dhe të bashkëjetesës shekullore të grekëve dhe shqiptarëve, pa kufij dhe pavarësisht nga nënshtrati i tyre dhe nga arsyet politike që e imponuan atë. Është e vërtetë se Greqia është një fuqi euroatlantike në Ballkan dhe Shqipëria është vend i privilegjuar në marrëdhëniet me Greqinë. Dallimi qëndron se, ndërsa Greqia e ndërgjegjshme për misionin e vet, mundohet dhe mbyll të gjitha kanalet e historisë që helmojnë të tashmen dhe të ardhmen, ashtu siç kanë bërë shumë vende europiane, (ashtu si Evropa përpiqet t'u imponohet Serbisë dhe Kosovës), në Shqipëri ndodh e kundërta. Mbahet hapur komunikimi me të gjitha kanalet e së shkuarës duke bllokuar kanalet e së ardhmes nëpërmjet identifikimit të së tashmes më të shkuarën, që interpretohet si e helmatisur.



## **Nga Panajot Barka**

<http://shekulli.com.al/51249/>

### **Përse i trembet drejtësisë opozita?!**

17.07.2014

Deklaratat e ditëve të fundit në Parlament, të kryetarit të grupit parlamentar të PD-së për skenarë destabilizues të ngjashëm me ata të verë-vjeshtës së vitit 1998, zbulojnë thelbin “e çudisë” në këta 24 vjet tranzicion: rotacionin paqësor dhe pa kontestime të pushtetit. Ky thelb, në konstatimet e SHBA-ve dhe BE-së, lidhet me faktin se Shqipëria konsiderohet si vend me sistem të instaluar të krimit të organizuar. Njëkohësisht, BE-ja dhe SHBA-të, kanë deklaruar se po nuk u godit ky sistem, demokracia mund të falimentojë. Deklaratat e eksponentëve të opozitës lidhen me këto përcaktime për faktin se, opozita, me referencë parimet demokratike, reagon në mbrojtje të sistemit që realisht rrezikon rendin demokratik, në një kohë kur qeveria e përkrahur nga partnerët ndërkombëtarë, po shfaq vendosmëri për të luftuar krimin e organizuar që ka asfiksuar totalisht shtetin. Sa më shumë ajo ushtron presionin e vet në këtë drejtim, aq me shumë opozita u referohet skenarëve destabilizues.

Kjo dinamikë në skenën politike të vendit po vërteton, pikësepari se sistemi i inkriminuar u trashëgua në realitetin e qeverisjes së re. Pasi ishte lejuar, kultivuar dhe stimuluar për vite me radhë në 8-vjeçarin e fundit, duke kapur çdo ind të shtetit.

Kalimi paqësor i pushtetit në zgjedhjet e 2013-ës, konsiston te fakti se korrupsioni dhe krimi i organizuar kishin siguruar paraprakisht garanci paprekshmërie nëpërmjet sistemit të institucioneve shtetërore kushtetuese përgjegjëse në vend. Duket se garanci ka siguruar edhe rrethi i ngushtë i ish-kryeministrit.

Nuk ka dyshim se mekanizmi i ngritjes së sistemit të kapjes së shtetit ose ai i kundërvënies së shtetit ndaj interesave të qytetarëve, u ngrit mbi parimin e njohur të baltovinës, ose të “lugës së çorbës të prishur”, ose të mafies shtetërore. Aleancat, marrëdhëniet, marrëveshjet politike, ekonomike, morale, etj. arriheshin dhe realizoheshin mbi këto parime, të baltosjes ose të thirrjes dhe promovimit politik-shoqëror e shtetëror të njerëzve nga baltovina e krimit. Aktet ligjore dhe strukturat e tjera shtetërore funksiononin në favor të legalizimit të informalitetit ekonomik dhe politik. Parimi i lirisë dhe i demokracisë zbërthej sipas formulës: korruptohu sa të mundesh, por në dijeninë e strukturave të kontrolluara nga kreu i piramidës, për të krijuar dosjen e baltosjes. Pasi realizohej kjo fazë, vendosej disiplina e kupolës për t'i shërbyer demokracisë formale. Që do të thotë, ose do t'i shërbesh kauzës së baltovinës dhe do të vazhdosh të hash sipas vendit dhe pozicionit në makinën shtetërore apo në kanalet e pista, ose do të jashtëqitesh i likuiduar duke u akuzuar për inkriminim dhe shpërdorim detyre. Mbi këtë bazë të pushtetit të oligarkisë së gjithëpushtetshme, u ngritën komunitetet “politike”, “ideologjike”, “shoqërore”, si edhe uniteti dhe forca partiake. Duke qenë se zullumi kapërceu çdo masë dhe çdo kufi, paralelisht me polin qendror, ose me kreun e piramidës, u krijuan edhe disa pole të tjera, (nënpiramide) dytësore, por të fuqishme. Forcimin e tyre, ata ia dedikojnë pikërisht aplikimit të së njëjtës monedhë ndaj kupolës qendrore. Sigurimi i mëvetësisë dhe njëkohësisht i mbrojtjes nga kupola qendrore u arrit po mbi rregullat dhe parimet e baltovinës. “Merita” e tyre ishte se poqën brenda vetës guxim për t'i thënë majës: “Po më ngacmove do të përdor faktet komprometuese që të shkatërrojnë”.

Sipas kësaj formule çdo njeri apo faktor i akuzuar për inkriminim, nxjerr nga arkivi i tij fakte komprometuese për kundërshtarit akuzues.

Nga ana tjetër, duke qenë se politika qeverisëse u bë shtrati i ngrohtë i lulëzimit të këtij sistemi oligarkësh të inkriminuar, shumë syresh, kur ua donte nevoja, kalonin pa hezitim ylberin politik për te klani fitues që pasonte. Kjo ndikohej edhe nga fakti se sistemi politik nën thundrën e tyre kërkonte paratë për te qenë njëra apo tjetra palë fituese. Ky lloj “renegatizmi” u përdor dhe përdorët për diversion dhe akuza ndaj kundërshtarëve për futjen në politikë të të inkriminuarve. Një sjellje e tillë fitoi status moral politik dhe shoqëror deri te niveli me i ulët i demokracisë, asaj me votë të blerë. Në themel të këtij sistemi “politik”, u vendos stimuli që përbën edhe natyrën e veçantë të shqiptarit: fitimi i shpejtë, pa kufij dhe pa mund e djersë, me pasojë shndërrimin e tij në mentalitet shoqëror. Kundërvënia ndaj këtij realiteti kërcënues për demokracinë, po provokon reaksionin e opozitës dhe të faktorit të inkriminuar, kudo qoftë ai. I ekspozuar ekstremisht mbetet klani rreth ish-kupolës së piramidës. Kryeministri i vendit, Edi Rama, ndryshe nga paraardhësit e tij që deklarorin në fushata elektorale se do të ishin qeveri e shërbesave popullore dhe e duarve të pastra, por ne fakt ktheheshin në oligarkë për t’i bërë duart më të pista se paraardhësit, tregohet i vendosur për të goditur këtë sistem të korruptuar e të inkriminuar. Institucionet shtetërore, pas të cilave krimi i organizuar ndihet i garantuar, drejtohen nga njerëz që i përzgjedhi si garantë opozita e sotme. Ndaj, në çdo hap të qeverisë në rrugën kundër krimit dhe reformimit të institucioneve, apo futjes në veprim të institucioneve të tjera (rasti i Byrosë së Hetimit) has në rezistencën mbrojtëse të faktorit të inkriminuar, i përfaqësuar fatkeqësisht prej opozitës. Kulmi që provokoi edhe deklaratën e kryetarit të grupit parlamentar të PD-së ishte përballja me sistemin e drejtësisë. Kjo pasi mbrojtja e tij garanton pandëshkushmërinë e krimit, pra mbijetesën e tij.

Do të ishte në nderin e opozitës po t’i bashkohej luftës së shpallur krimit nga ana e qeverisë. Kjo do ta ndihmonte maksimalisht për të pastruar dhe rehabilituar politikisht e moralisht vetveten. Por, me sa duket, fryma e shëndoshë brenda opozitës është në minorancë dhe e marginalizuar. Në këtë kuptim, opozita shpenzon energji të pafundme për të krijuar imazhin e gabuar, se krimi i organizuar u bë pemë që s’pritet kollaj brenda 300 ditëve të qeverisjes së të majtëve. Në taktikën e vet për të maskuar përgjegjësitë për kapjen e shtetit nga krimi i organizuar, dallohen disa elementë kryesorë. I pari ka të bëjë me përpjekjen e opozitës për të mbrojtur institucionet e akuzuara edhe prej saj si të korruptuara, në emër të ligjit kushtetues dhe parimeve të demokracisë. Ajo kundërshton me të gjitha format demokratike ligjin për KLD-në, duke deklaruar bojkot të parlamentit. I dyti ka të bëjë me përpjekjet për ta identifikuar krimin me qeverisjen e re. Opozita nëpërmjet kësaj linje përpiqet, që nga njëra anë, të mbrojë pjesën e vet të inkriminuar dhe nga ana tjetër të sigurojë një unitet të brendshëm si produkt të përballjes me qeverinë që kërkon t’ua heqë privilegjet e paligjshme. Me shembjen e mitit të Lazaratit, qeveria ka tanimë, një aset të fortë për ta vazhduar rrugën e nisur. Por, kjo rrugë duhet të vazhdojë përmes moralit të ngritur dhe përkrahjes së shoqërisë. Por ngadalësia në veprim, riciklimi i fenomeneve të ngjashme në qeverisjen e re dhe përvoja e së kaluarës e lëkund besimin dhe përkrahjen civile në këtë aksion dhe ndërmarrje të pazakontë.

**Nga Panajot Barka**

**Çfarë e vërtete fshihet pas reformës territoriale në bregdet?!**

25.07.2014

**Shebim**

**Ky shkrim nuk u botua dhe shenoi fundin e bashkepunimit me gazetën**

**“Shekulli” Redaksia me kumtoi se nuk përputhet me linjen e saj editorial.**

**Dmth, shkon ndesh me interesat e K. Kokodhimës, akoma afër Ramës**

**Ndërprerja e ketij bashkepunimi shenonn fillimin e bashkepunimit me gazetën  
TemA**

Në finishin e vet reforma administrative në Jug të vendit derivoi, nga një akt administrativ, në një kokolepsie dhe përplasje etno-politike dhe nacionaliste me përfshirje të faktorëve të ndryshëm. Në qëndër të vemendjës u vunë perseri interesat dhe të drejtat e minoritetit etnik grek, i cili gjatë gjithë procesit të reformës tregoi maturi dhe besim tek strukturat drejtuese të saj dhe të qeverisë për realizimin e hartës së re administrative të vendit.

Gjithshka u vu në dyshim dhe u përmbys me pjesëmarrjen në strukturat vendimarrëse të reformës të PDIU-së. Hapësira e lëjuar për të ndodhur përmbysja lidhet me faktin se PDIU u trajtua me tagrin e përfaqësimit të opozitës në strukturat e reformës, pjesëmarrjen e së cilës e kishin venë si kusht të pashkruar perendimorët. Në dosjen e vet, PDIU-ja kishte dy kategori propozimesh, por me “spekter patriotik”. E para kishte të bënte me nëvojën e krijimit të komunës së Konispolit. Një kërkesë gjithësesi e drejtë dhe e justifikuar për forcën kongrete politike propozuese.

Patriotizmi i kategorisë së dytë lidhej në nivel të parë me rikonfigurimin e hartës së bashkisë së minoritetit etnik grek në Sarandë e Delvinë. Në nivel të dytë me rrezimin e propozimit të faktorëve politikë minoritarë dhe jo vetëm, sipas të cilit bashkia e tanishme e Himarës të bashkohej vetëm me komunën e Lukovës.

Në rastin e Himarës, ndërsa flitet gjithë ditën dhe në të gjitha nivelet se Himara është shqiptare dhe nuk është minoritet grek, inspiruesit “e patriotizmit” shikojnë bashkëngjitjen me Vranishtin si domosdoshmëri garantuese e identitetit shqiptar të saj. (Argumenti se pa Vranishtin, Bashkia Himarë-Lukovë do të jetë e vogël, bie pasi ajo është më e madhe se Bashkia Konispol, apo Bashkia Delvinë dhe me resurse ekonomike shumë herë më të medha se të dyja së bashku.)

Rikonfigurimi i hartës së bashkisë së minoritetit etnik grek, presupozon qethjen e fshatrave të veçantë minoritarë grek ose jo të tillë në kufijtë skajorë të komunave egzistuese minoritare në këto dy rrethe. Qëllimi patriotik, sipas argumentimit të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar të lidërshiptit të PDIU-së, lidhet me faktin e nëvojës së “çlirimit” nga komunat minoritare greke të disa fshatrave shqipfolës ose biling. Dhe për këtë “çlirim administrativ” të tyre, disa fshatra minoritarë greke, si Vagalati, Çuka, Kardhikaqi, Mavropullo, Lefterohori, Kakodhiqi etj t’u bashkohen bashkive me popullsi shqiptare.

Në rastin më të mirë përkrahja e një propozimi të tillë, përbën shkelje të të drejtave të pakicave kombëtare, të Kushtetutës. Shkelen haptas parimet bazë të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, (neni 16) që kërkojnë respektimin nga shteti dhe shumica të integritetit administrativ, kulturor, gjuhësor e ekonomik të pakicave kombëtare. Po ashtu shkelen dhe parimet e vet qeverisë për të

operuar në realizimin e reformës administrative. Sipas tyre bashkitë e reja do të formohen nga bashkime komunash e bashkish pa ndryshuar kufijt e egzistuese të administrative të tyre si pjesë përbërës. Dhe fatkeqësisht ky parim nuk zbatohet vetëm në rastin e bashkisë së minoritetit etnik grek, në Delvinë e Sarandë. Pra, duket qartë se kemi të bëjmë me qëndrime diskriminuese e asimiluese.

Në rastin më të keq ky qëndrim përbën një provokim ndaj disa faktorëve. Autorësia e këtij propozimi, të pranuar deri tani nga strukturat zyrtare përgjegjëse të reformës administrative, i përket PDIU-së. Dihet që përgjatë gjithë viteve të tranzicionit, komuniteti i minoritetit etnik grek në Shqipëri, mbajti një qëndrim të prerë e të qartë ndaj eksponentit politik që përfaqëson komunitetin çam dhe ndaj vet këtij komuniteti. Me komunitetin tradicional çam ruajti dhe ruan raporte bashkëpunimi, miqësie e tolerance të sinqertë. Ndërsa është distancuar prerazi nga qëndrimet e eksponenteve politikë të këtij komuniteti, si qëndrime që nuk kanë asnjë lidhje apo paralele të drejtëpërdrejtë me të. Referimet patriotike të lidërshiptit të PDIU-së, për të marrë përsipër organizimin administrativ të minoritetit etnik grek, si tutor i patriotizmit shqiptar, por duke shkelur aktet ndërkombëtare, kushtetuten e vendit dhe të kaluarën tradicionale, me të drejtë nuk mund të tolerohet nga strukturat e minoritetit. Gjuha e këtij lidërshipti në komisionin parlamentar se ata (grekët), na kanë vrarë e na kanë prerë, por ne nuk do të sillemi me të njëjtën monedhë, është një insinuatë tëpër e rendë dhe e papranueshme.

Në këtë prizëm kjo përbën edhe një provokim në marrëdhëniet e minoritetit etnik grek me qeverinë shqiptare dhe realitetin shqiptar. Ky minoritet i çliruar nga paragjykimet nacionaliste tregon gadishmeri maksimale për t'u integruar në shoqërinë shqiptare. Ashtu siç tregon i vendosur se në këtë integrim do të ruaj identitetin e vet kulturor, fetar dhe etnik. Fakti që përfaqësuesit e tij politikë bëjnë pjesë në të gjithë spektrin politik pluralist të vendit, por që unifikuan qëndrimet e tyre në lidhje me reformën administrative në komunitetin e tyre, është një tregues i qartë për këtë. Njëkohësisht përbën edhe një përgjigje për të gjithë ata faktorë që kërkojnë t'i imponojnë këtij minoriteti qëndrime të tjera.

Është gjithashtu një provokim në marrëdhëniet midis dy vendeve. E them këtë më shumë në aspektin se ditët e fundit, me definicionin e reformës administrative në lidhje me minoritetin etnik grek në Shqipëri, krahu që mbështet kërkesa për qëndrime radikale dhe nacionaliste të Athinës ndaj Shqipërisë, manifestoi epersi dhe bëri përgjegjëse qeverinë greke dhe gjithë ata që kërkojnë dhe zbatojnë relata evropianiste në marrëdhëniet me Shqipërinë. Flet qart për këtë edhe qëndrimi aspak fleksibël i Venizellos dhe i qeverisë greke.

Është së fundi, një sfidë për realitetin në emër të prapësive historike. Dihet se në asnjë akt ligjor apo nomrativ të shtetit shqiptar, që nga themelimi i tij, nuk përcaktohen të ashtuquajtuara zona të pastra minoritare me 100 apo 110 fshatra. Sipas përfaqësuesit shqiptar në gjyqin e Hagës me 1935 për problemin e shkollave në gjuhën amtare për minoritetin grek në Shqipëri, këtë realitet, - të një territori të ngushtë afër kufirit greko-shqiptar me fshatra greke, e krijoi Italia në pushtimin e saj të parë 1917-1920 dhe e trashëguan de facto qeveritë e Zogut e ato komuniste e post komuniste. Po ashtu dihen masat asimiluese shumëformshme të tyre. Në epiqendër, sidomos të pushtetit komunist, ishte komuniteti grek i rrethëve të Delvinës dhe Sarandës, ku përveç të tjerave, ndërsa asimiloheshin fshatra minoritarë grekë, në gjeografinë e këtij minoriteti shtoheshin fshatra me popullsi shqiptare apo mikse ku sot banohen kryesisht nga popullsi shqiptare. E gjithë kjo periudhë e gjatë historike ka krijuar nyje të pakëpërxyeshme për kujtesën kolektive të minoritetit grek, të shprehura apo të pashprehura.

Në kuadrin e platformës së Shqipërisë Evropiane dhe në realitetin e shekullit të drejtave të njeriut dhe të pakicave, unë besoj se nuk do të lejohet riciklimi apo shtimi i këtyre gromave të errëta historike. Përndryshe, me dashje apo pa dashje do të hapet një cikël i ri krizash, përplasjesh, dyshimesh, ankesash e konfrontimesh dypalëshe e shumëpalëshe.

Po ashtu, askush nuk duhet të harrojë se frika e shumicës nga pakica nuk është në nder të shumicës, e as i përgjigjet frymës civilizuese evropiane. Nga ana tjetër, një realitet Evropian po kristalizohet në këtë pjesë të vendit tonë. Me mijra qytetarë shqiptarë, me kombësi greke dhe shqiptare, po bëhen nënshtetas të Evropës së Bashkuar duke i paraprirë kështu endrrës së gjithë popullit shqiptar. Në këto rrethana barrierat nacionaliste të shekullit të kaluar u shërbëjnë thjeshtë interesave të çastit. Unë besoj se në këtë rast edhe qeveria e parlamenti nuk do të bien ne gracka pazaresh, apo presionesh, individesh, politikanesh apo qarqesh nga cilado anë qofshin por që krijojnë njolla të errëta historike. **FUND**